AUDITIMI PUBLIK

KLSH

AUDITIMI PUBLIK

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

100 Vjet Pararësi

REVISTË 4 - MUJORE

Nr.1

2012

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË 4 - MUJORE

2012

1

Tiranë, 2012

seria : botime KLSH- 03/2012

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE

kërkimore-shkencore-informative

Shqip- Anglisht

Nr. 1/2012, Tiranë
Janar- Prill

ISBN 978-9928-159-03-4

Seria : botime KLSH 03/2012

Tiranë, 2012

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION -ALSAI

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

QUARTERLY MAGAZINE

of research, science and information
in Albanian and in English

No. 1/2012, Tirana
January- April

ISBN 978-9928-159-03-4

Series: Publications ALSAI 03/2012

Tiranë, 2012

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSh	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT) (Kryeredaktor)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Anëtar i Gjykatës së Lartë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi, Përgjegjës i Departamentit të Financës FE (UT)	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Managing Partner,nH EuroConsult sh.p.k.	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof.As.Dr. Manjola Naço, Profesore, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Gjon Ndreja Ekspert	Anëtar

SEKRETARIATI

1. Fatos Çoçoli	Koordinator
2. Dr. Adriatik Kotorri	Sekretar Kolegjiumi
3. Dr. Reinald Muça	Redaktor
4. Ermal Yzeiraj	Redaktor
5. Dr. Edvin Stefani	Redaktor

I NDERUAR LEXUES !

Njëhemi të nderuar që ju ofrojmë këtë revistë shkencore të cilin e gjykojmë dhe besojmë se do t'i përgjigjet interesit Tuaj në fushën e auditimit. Me iniciativën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, revista "AUDITIMI PUBLIK" do të ofrohet si një periodike 4-mujore në fushën e kërkimit, shkencës dhe informacionit. Kjo revistë (materialet e së cilës do të jenë në Shqip dhe Anglisht) synon të mbledhë idetë dhe opinionet në fushën e, auditimit, kontabilitetit dhe financës publike në përgjithësi.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes publik bazuar në moton e INTOSAI "Experentia mutua omnibus prodest"

Duke ju uruar lexim të këndshëm, bordi editorial i revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit të kësaj iniciative me qëllim shndërrimin e saj në një arenë reale dhe profesionale të debatit ekonomik.

Me respekt
Bordi i Revistës

Adresa e redaksisë
Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al,
E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al , bleskaj@klsh.org.al

Shtypur: "Mirgeeralb", Tiranë

PËRMBAJTJA

Titulli	AUTORI	FAQE
Editorial	**Prof. Dr. Omer Stringa** Fakulteti i Ekonomisë (UT)	**1**
Reforma e raportimit financiar: sfida dhe probleme	**Prof. Dr. Jorgji Bollano** Kryetar i Këshillit kombëtar të Kontabilistëve	**5**
Të njohim parimet bazë ku mbështetet puna e Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit	**Prof.Asoc.Dr. Hysen Çela** Managing Partner nH EuroConsult shpk	**11**
Sfidat drejt një Institucioni modern të auditimit të jashtëm publik.	**Dr. Bujar Leskaj** Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit	**19**
Vlera e kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	**Dr. Rezarta Perri** Fakulteti i Ekonomisë (UT) **Msc.Linda Çepani** Fakulteti i Ekonomisë (UT)	**33**
Performanca e auditimit në sektorin publik	**Kasem Seferi** Këshilltar për Ekonominë pranë Presidentit të Republikës	**43**
Auditimi si një faktor në rritjen ekonomike	**Dr. Edvin Stefani** Kontrolli i Lartë i Shtetit	**53**
Roli i auditimit të brendshëm për një qeverisje të mirë publike	**Dr. Hysen Muceku** Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm, Ministria e Financave	**65**
Kontrolli i cilësisë në auditim	**Luljeta Nano** Kontrolli i Lartë i Shtetit	**71**

Korrupsioni dhe Mashtrimi: Roli i Audituesit	**Sali Agaj** Kontrolli i Lartë i Shtetit	**77**
Mbivendosja e auditimit- kosto shtesë	**Gjon Ndreja** Ekspert i Jashtëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit	**89**
Për një ndjeshmëri më të lartë mbi performancën e auditimit	**Peter van der Knaap** Gjykata e Auditimit e Holandës	**97**
Aktivitete të KLSH	Info vendi	**103**
INTOSAI -Organizmi ndërkombëtar i institucioneve të auditimit publik	Profil	**113**
EUROSAI - Organizmi Europian i institucioneve të auditimit publik	Profil	**118**
Gjykata e auditimit e Republikës së Sllovenisë	Profil	**127**
Zyra e lartë e auditimit në Poloni, NIK	Profil	**131**

Content of the English version

Title	Author	Page
Editorial	**Prof. Dr. Omer Stringa** Economic Faculty (TU)	**139**
Financial reporting reform: challenges and problems	**Prof. Dr. Jorgji Bollano** Chairman Of The National Council Of Accountants	**143**
To know the basic principles that the work of the Independent Audit Regulators is based on	**Prof. Asoc. Dr. Hysen Çela** Managing Partner nH EuroConsult shpk	**147**
Challenges toward a modern institution of public external audit.	**Dr. Bujar Leskaj** Chairman of the Supreme State Audit	**151**

Internal control value for small and medium enterprises	**Dr. Rezarta Perri** Economic Faculty (TU) **Msc.Linda Çepani** Economic Faculty (TU)	**163**
The performance of the audit in the public sector	**Kasem Seferi** Economic Adviser to the President of the Republic	**167**
Audit as a factor in economic growth	**Dr. Edvin Stefani** State Supreme Audit	**171**
The role of internal audit for a good public governance	**Dr. Hysen Muceku** General Director of Internal Audit, Ministry of Finance	**175**
Quality control in audit	**Luljeta Nano** State Supreme Audit	**179**
Corruption and Fraud: The Role of Auditors	**Sali Agaj** State Supreme Audit	**183**
Overlapping audit additional cost	**Gjon Ndreja** External expert, State Supreme Audit	**187**
For a higher sensitivity in the performance of an audit	**Peter van der Knaap** Court of Audit of the Netherlands	**191**
Info AL-SAI		**197**
INTOSAI- The international organization of the Supreme Audit Institutions		**201**
EUROSAI- The European Organizations of the Supreme Audit Institutions	Profile	**206**
The Court of Audit of Slovenia	Profile	**213**
The Supreme Audit Office in Poland, NIK	Profile	**217**

Editorial

PROF. DR. OMER STRINGA

Qëllimi i një auditimi është të vlerësojë bazuar mbi procedura testimi një organizatë, sistem, proces, produkt a projekt. Auditimi i referohet procedurave të kryera për të dhënë një vlerësim mbi efikasitetin në ndërtim dhe operim të kontrolleve mbi performancën ekonomike, paraqitjen e drejtë të të dhënave financiare të një organizate kundrejt standardeve që aplikon, dhe performancën ekonomike të një organizate. Planifikimi dhe ekzekutimi cilësor i auditëve duhet të jetë fokusi primar i aktivitetit të një shoqërie auditimi ose Kontrollit të Lart të Shtetit në mënyrë që puna jonë të krijojë vlerë për organizatën nën auditim, ekonominë dhe shoqërinë në tërësi.

Ndërtimi dhe zbatimi i një metodologjie të qartë dhe të askesueshme është themeli për të garantuar që auditimet e kryera të arrijnë qëllimet e tyre. Metodologjia duhet të ndërtohet dhe të rishikohet vazhdimisht, në mënyrë të atillë që të jetë në përputhje me standardet zyrtare të auditimit, të cilat duhen respektuar rigorozisht. Zbatimi i metodologjisë në auditim mundëson që të gjitha fazat dhe hapat e nevojshme të kryhen për të arritur në një vlerësim të drejtë në një auditim. Ndër të tjera, implementimi i një metodologjie krijon bazat mbi të cilat mund të vlerësohet një auditim dhe si rrjedhojë, lejon një shoqëri auditimi ose Kontrollin e Lart të Shtetit të monitorojë në mënyrë më efikase cilësinë e auditimeve të kryera.

Në praktikën bashkëkohore, auditimet ndërtohen në bazë të rrezikut që shfaq organizata nën auditim, në raport me atë se cili është qëllimi i auditimit. Këto lloje auditimesh, nëse implementohen dhe ekzekutohen në mënyrën e duhur, besohet të jenë më të përshtatshmit për të arritur në mënyrë efiçente dhe efikase qëllimet e një auditimi. Niveli i rrezikut kushtëzon zgjedhjen e kohës, natyrës dhe thellësisë së procedurave të testimit që duhen kryer për të realizuar qëllimin e auditimit. Me pak fjalë, sa më i madh rreziku, aq më shumë procedura testimi duhen kryer për të garantuar që kemi arritur me sukses qëllimin e auditimit. Nëse audituesi nuk e vlerëson drejt rrezikun, atëherë kjo krijon mundësinë që procedurat e testimit, të planifikuara dhe të kryera, të jenë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për të arritur qëllimin e auditimit.

Për të garantuar që të kemi një vlerësim të drejtë të rrezikut, së pari duhet një metodologji e përshtatshme. Më tej kërkohet që audituesit të kuptojnë dhe vlerësojnë mirë organizatën (p.sh. 1. sektorin, fushën në të cilën operon, 2. strukturën, 3. përgatitjen, eksperiencën dhe karakterin e drejtuesve dhe punonjësve kyç, 4. proceset kryesore, 5. kontrollet e brendshme, 6. incentivat që kushtëzojnë sjelljen brenda organizatës, 7. kodin e etikës dhe rregulloret e brendshme, 8. rolin e teknologjisë së informacionit, si dhe 9. matësit e performancës së organizatës që po auditohet). Gjithashtu, audituesit duhet të konsiderojnë eksperiencën e tyre me këtë organizatë në vitet paraardhëse. Siç mund të kuptohet, është e domosdoshme që audituesit të kenë përgatitjen dhe trajnimin e nevojshëm që kërkohet për të parë përtej numrave dhe për të kuptuar ambientin dhe realitetin ekonomiko - operacionale të një organizate.

Gjatë viteve të fundit, roli dhe varësia e organizatave ndaj teknologjive të informacionit është rritur ndjeshëm. Roli dhe varësia ndaj teknologjive të informacionit do bëhet gjithnjë e më e madhe në vitet në vazhdim. Një nga prioritete kryesore për audituesit në Shqipëri do të jetë zhvillimi i aftësive të përshtatshme për të vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit, funksionimin e kësaj teknologjie, dhe impakti që ka në nivelin e rrezikut në një organizatë.

Vetëm pasi rreziqet që shoqërojnë operimin e një organizate janë identifikuar dhe dokumentuar, mund të kalohet në fazën tjetër që ka të bëjë me identifikimin dhe vlerësimin e efikasitetit të kontrolleve të brendshme, për t'iu përgjigjur rreziqeve operacionale. Në këtë fazë, audituesi identifikon dhe vlerëson procedurat e kontrollit të ndërtuara nga organizata për t'ju përgjigjur rreziqeve të identifikuara. Këto kontrolle mund të grupohen në dy lloje: parandaluese dhe zbuluese. Vlerësimi i parë që duhet bërë në këtë fazë është nëse ka kontrolle të mjaftueshme për t'ju përgjigjur të gjitha rreziqeve të identifikuara. Vlerësimi i dyte që duhet bërë është nëse kontrollet e identifikuara janë ndërtuar (dizenjuar) në mënyrë efikase, për t'ju përgjigjur rreziqeve. Së treti, duhet vlerësuar me anë të testimeve nëse kontrollet e ndërtuara në mënyrë efikase operojnë vërtetë në mënyrë efikase. Këtu audituesi mund të krijojë vërtetë vlerë të shtuar për vetë organizatën që është duke audituar, duke i paraqitur rezultat e testimeve të bëra, mangësitë ose dobësitë e vëna re, si dhe rekomandimet se si mund të përmirësohet puna dhe drejtimi i organizatës në të ardhmen.

Pasi të kemi vlerësuar rreziqet dhe efikasitetin e kontrolleve brenda një organizate për t'ju përgjigjur këtyre rreziqeve, mund të kalojmë në ndërtimin dhe implementim e procedurave të testimit që janë të mjaftueshme për të na lejuar të vlerësojmë nëse të dhënat financiare paraqesin drejt realitetin ekonomik të një organizate. Rezultatet e këtyre procedurave duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe, nëse është e nevojshme të modifikohen ose rishikohen në varësi të zbulimeve që audituesit bëjnë përgjatë auditimit.

Për të shprehur një opinion mbi performancën e një organizate kërkohet të identifikohen drejt proceset kryesore, matësit që duhen përdorur, si dhe cilësia e të dhënave mbi të cilat bazohet matja. Ekzekutimi në mënyrë efiçente i fazave dhe hapave të paraqitura më sipër gjatë auditit e pozicionin shoqërinë e auditimit ose Kontrollin e Lart të Shtetit në një avantazh konkurrues për të krijuar vlerë për organizatën duke dhënë një opinion të drejtë mbi performancën e saj kundrejt qëllimeve për të cilat ajo është krijuar. Duke ofruar një këndvështrim të pavarur bazuar në procedurat e kryera dhe rezultatet e këtyre procedurave, shoqëritë e auditimit ose Kontrolli i Lart i Shtetit mund të ndihmojnë organizatën të përmirësojë performancën dhe efiçencën operacionale. Ne aspektin financiar, shoqëritë e auditimit ose Kontrolli i Lart i Shtetit mund të identifikoj iniciativat në fushën e mirëmenaxhimin të fondeve dhe përmirësimit të kostove për të ndihmuar organizatën, dhe si rrjedhojë ekonominë dhe shoqërinë në tërësi, në arritjen e qëllimeve strategjike.

Prof. Dr. Omer Stringa është profesor në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Raportimi financiar

Reformimi i sistemit të raportimit në Shqipëri

REFORMA E RAPORTIMIT FINANCIAR: SFIDA DHE PROBLEME

Reforma në fushën e raportimit financiar në Shqipëri i ka fillimet e veta me ndryshimet e sistemit politik dhe ekonomik, në vitet ’90. Këto ndryshime kërkuan krijimin e një infrastrukture të re ligjore dhe institucionale në fushën e kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Krijimi dhe zhvillimi i tyre u realizua duke pasur parasysh kryesisht legjislacionin e vendeve të zhvilluara perëndimore dhe deri diku të atyre lindore, të cilat ishin në tranzicion, duke mos neglizhuar edhe përvojën tonë.

PROF. DR. JORGJI BOLLANO

Pak histori për rrugën e zhvillimit të reformës në kuadrin e raportimit financiar

Mjedisi ligjor dhe rregullimet kontabël të arritura, janë fryt i një pune shumë vjeçare të institucioneve të specializuara që merren posaçërisht me këtë fushë pa përjashtuar këtu edhe kontributin e grupeve të tjera të interesit.

Në vitin 1993, u miratua Ligji nr 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”, i cili përcaktonte detyrimet e përgjithshme si dhe parimet e rregullat kryesore për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e paraqitjen e pasqyrave financiare. Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare ishte e domosdoshme për vetë drejtimin e njësisë ekonomike dhe përdoruesve të

tjerë jashtë njësisë ekonomike, për marrjen e vendimeve të drejta.

Për të realizuar normalizimin e kontabilitetit sipas këtij ligji, si dhe për të siguruar një udhëheqje metodologjike të vijueshme, u krijua Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Mbështetur në ligjin e mësipërm, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit hartoi Planin Kontabël të Përgjithshëm, që u miratua me VKM nr 334, datë 09.07.1993. Legjislacioni i hartuar në këtë periudhë hodhi themelet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar për një ekonomi që bazohet në parimet e tregut.

Zhvillimet ekonomiko – shoqërore të vendit, bërja më komplekse dhe rigoroze e raportimit financiar dhe auditimit ndërkombëtar, angazhimi i qeverisë shqiptare për të nënshkruar marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE, të gjitha këto bënë që kërkesat e deriatëhershme të raportimit financiar të konsideroheshin të pamjaftueshme. Ishin këto arsyet që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mori iniciativën për hartimin e Ligjit nr 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Ligji trajton më thjesht, në mënyrë më koncize, pa teprime dhe larg trajtimeve teknike e hollësirave kontabël, zgjidhjen e kërkesave dhe problemeve të ndryshme nëpërmjet standardeve të kontabilitetit. Ligji ka përcaktuar llojet e standardeve kontabël (kombëtare apo ndërkombëtare) që do të aplikohen nga njësitë ekonomike.

Një pjesë të rëndësishme të këtij ligji e zë statusi, përbërja, organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Sipas këtij Ligji Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) krijohet si organizëm profesional, publik, i pavarur dhe që gëzon personalitet juridik. KKK është i vetmi organizëm që harton standardet kombëtare të kontabilitetit në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ky organizëm përcakton rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, listat e llogarive dhe përdorimin e tyre si dhe formatet e pasqyrave financiare. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e detyrave të KKK është mbikëqyrja e zbatimit të këtyre standardeve nga njësitë ekonomike. KKK është anëtar i Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS Foundation) dhe është në lidhje të vazhdueshme me këtë institucion për të azhornuar çdo ndryshim të standardeve ekzistuese ndërkombëtare apo hartimin e standardeve të reja ndërkombëtare.

Zbatimi me korrektësi i ligjit "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Legjislacioni kontabël dhe standardet kontabël kanë rëndësinë e tyre në realizimin me sukses të misionit që kanë profesionistët kontabël dhe audituesit e brendshëm apo audituesit e pavarur. Njohja sa më e mirë e këtyre dy komponentëve do të bëjë të mundur mbajtjen e një kontabilitetit të rregullt e të sinqertë. Në kompleksitetin e administrimit të njësive ekonomike një kontabilitet i rregullt dhe i sinqertë përbën një tablo të domosdoshme në instrumentet e tij të matjes i cili sjell:

1. *Siguri juridike* – që do të thotë se:

- Njësia ekonomike është në rregull me ligjin; tabloja e saj është e plotë, në gjendje funksionale dhe e mbrojtur nga të gjitha gjobat dhe penalitete;
- Njësia ekonomike është e pajisur me një instrument prove. Kontabiliteti regjistron të gjitha flukset, do të thotë të gjitha veprimet ekonomike të realizuara me partnerët. Kjo kujtesë është e rëndësishme, sidomos në rastet kur çështjet përfundojnë në gjyq;

2. *Siguri fiskale* – që do të thotë se:

- Shumë nga tatimet llogariten mbi bazën e të dhënave të kontabilitetit, si p.sh. shifra e afarizmit për llogaritjen e TVSH-së, tatim fitimit, etj.
- Kontrollet tatimore mbi njësinë ekonomike janë një verifikim i kontabilitetit të saj. Nëse kontabiliteti nuk është i rregullt dhe i sinqertë, ai kthehet për njësinë ekonomike në një katastrofë në kushtet e përballjes me organet tatimore.

3. *Një siguri në administrim* – që do të thotë: Do të ishte papërgjegjshmëri të administroje një njësi ekonomike pa instrumente matjeje (të cilët lejojnë të arrihet në një pikë të caktuar). Kontabiliteti është një busull për drejtimin e njësisë ekonomike, sepse tregon gjendjen ku njësia ekonomike ndodhet dhe i jep mundësinë të analizojë dhe të orientohet në të ardhmen.

Zbatimi i plotë dhe me korrektësi i Ligjit "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe i standardeve kontabël që rrjedhin prej tij, kërkon një angazhim në vazhdimësi jo vetëm të njësive ekonomike që do t'i zbatojnë ato por dhe të organizatave profesionale apo organizmave të tjera shtetërore, përfshirë këtu Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, etj. Secili prej këtyre organizmave apo institucioneve duhet të përcaktojë këndvështrimin e vet dhe mjetet për arritjen e tij.

Arritjet dhe mangësitë në rrugën e implementimit të standardeve

Hartimin dhe implementimin e Standardeve Kontabël e kemi menduar dhe perceptuar jo si diçka të menjëhershme dhe të pandryshueshme por si një proces në vazhdimësi, proces i cili do kohën e vet dhe që ka të bëjë me sigurimin e infrastrukturës materiale dhe kapaciteteve profesionale, si dhe me reflektimin e kërkesave të dala nga praktika për ndryshime të nevojshme me synim modernizimin dhe thjeshtësimin e tyre.

Përvoja katërvjeçare e implementimit të standardeve ka nxjerrë në dukje arritje dhe mangësi.

Arritjet

Arritja më e madhe është që Shqipëria duke filluar nga viti 2008, zbaton një sistem kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të hartuara në koherencë të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Nga anketimet por dhe nga investigimet e bëra rezulton se përgjithësisht, përgatitja e pasqyrave financiare është bërë duke u bazuar në standarde.

Theksojmë, përgatitja e pasqyrave financiare është e tillë dhe jo mbajtja e kontabilitetit, sepse shumë nga njësitë ekonomike në vitet e para nuk bënë ndryshime në mbajtjen e kontabilitetit por u mjaftuan me përshtatje gjatë kohës së përgatitjes së pasqyrave. Në dy vitet e fundit është rritur interesi i njësive ekonomike që ta organizojnë kontabilitetin mbi bazën e standardeve duke i pasur si mbështetje në hartimin e pasqyrave financiare.

Nisur nga sa trajtuam më sipër arrijmë në përfundimin se Shqipëria është në rrugën e implementimit të standardeve kontabël ndërkombëtare dhe kombëtare që janë koherencë me të parat. Një arritje e tillë ka gjetur vend në raport progresin e Komisionit Europian për vitin 2001, ku thuhet shprehimisht se ka zhvillime shumë pozitive në fushën e kontabilitetit por duhen rritur kapacitet inspektuese të KKK lidhur me cilësinë e zbatimit të standardeve të kontabilitetit. Po ashtu edhe për sa i përket standardeve ndërkombëtare të auditimit janë bërë përparime në këtë rrugë. Një kontribut të rëndësishëm në këto arritje ka dhënë Ministria e Financave dhe Qeveria të cilat kanë qenë të gatshme për t'i dhënë zgjidhje çdo propozimi të bërë nga organizmat profesionale lidhur me thjeshtimin dhe modernizimin e informacionit kontabël. Gjithashtu një ndihmë jo më pak të rëndësishme na kanë dhënë organizmat ndërkombëtare profesionalë duke na azhornuar me materiale, si dhe duke na ftuar në konferenca dhe videokonferenca që organizohen herë pas here me qëllim rritje të aftësive profesionale në drejtim të raportimit dhe auditimit financiar.

Ne jemi pjesëmarrës të përhershëm në Konferencat që organizon Fondacioni i SNRF në Londër; Jemi pjesëmarrës të rregullt në konferencën që organizon Organizata e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin në Gjenevë, e cila trajton reformat në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar; Jemi pjesëmarrës në konferencat që organizon REPAIRS (Program për reformat në fushën e kontabilitetit dhe fuqizimin e institucioneve me qendër në Bankën Botërore në Vjenë). në kemi një bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar, bashkëpunim i cili është zyrtarizuar me Memorandumin e Bashkëpunimit në fushën e kontabilitetit në datën 08.06.2010.

Për të arritur në implementimin korrekt dhe të plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK)/ Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) jam i mendimit të parashtroj si më poshtë:

1. Nën procesin e edukimit, të mësuarit e profesionit duhet të jetë një proces i cili fillon në shkollë dhe vazhdon pambarim gjatë ushtrimit të tij. Me këtë duhet të kuptojmë që arsimi universitar duhet të japë bazat teorike të profesionistëve të ardhshëm kontabël apo audit dhe për këtë duhen riparë kurrikulat dhe programet përkatëse.

2. Organizatat profesionale dhe organizma të tjerë shtetërorë, duhet ta konsiderojnë si parësore në punën e tyre trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të hartuesve dhe audituesve të pasqyrave financiare,

duke i azhornuar programet me ndryshimet që bëhen në trajtimin e standardeve nga organizmat përgjegjëse përkatëse si dhe duke reflektuar në to probleme të dala nga praktika dhe që kërkojnë zgjidhje.

3. Të nxiten dhe të stimulohen punimet individuale apo me bashkautorësi të edukatorëve kontabël dhe profesionistëve si dhe të organizmave dhe të organizatave të ndryshme profesionale.

4. T'i jepet një rëndësi e veçantë sensibilizimit të mjedisit të biznesit lidhur me rëndësinë e zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit.

- Komuniteti i biznesit, e sidomos drejtimi i lartë i tyre duhet të kuptojë se pasqyrat financiare nuk hartohen vetëm për zyrën e tatimeve, por edhe për shumë përdorues të tjerë. Zbatimi me korrektësi i standardeve të kontabilitetit dhe auditimit nënkupton trajtimin në tërësi dhe jo disa prej tyre.
- Në këtë kontekst në mendojmë se një zgjidhje shumë më efikase drejt ndërgjegjësimit të biznesit për zbatimin e detyrueshëm të standardeve të kontabilitetit do të ishte edhe një ndryshim shtesë në Ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" që ka të bëjë me vendosjen e penaliteteve përkatëse në raste shkelje të tij. Fryma liberale e zbatimit të ligjit nuk ndihmon në këtë rast në procesin e integrimit pasi mungesa e penaliteteve është një nga arsye pse standardet nuk kanë gjetur zbatim në një pjesë të njësive ekonomike.

5. Të ngrihen dhe të funksionojnë strukturat e nevojshme profesionalisht të afta për t'i dhënë zgjidhje problemeve që kanë të bëjnë me vlerësime dhe rivlerësime të aktiveve ashtu siç e kërkojnë standardet.

6. Të rriten kufijtë për klasifikimin e njësive ekonomike duke bërë ndryshimin në ligjin përkatës për afrimin e tyre me ato të vendeve të tjera të rajonit, çka do të sjellë një ulje të kostos së informacionit për biznesin. Aktualisht këto për sa i përket kriterit të shifrës së afarizmit, në i kemi disa herë më të ulta se vendet e rajonit, ndërsa me ato të BE i kemi më shumë.

7. Të zgjerohet dhe të intensifikohet më tej bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës me organizmat homologe të rajonit në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Realizimi i objektivave të sipër përmendur duhet shoqëruar dhe me fondet e nevojshme financiare, fonde të cilat mund të sigurohen nga shteti ose nga organizma ndërkombëtare siç është REPARIS. Duhet të theksojmë se ky organizëm ka parashikuar fonde për fusha të ndryshme përfshirë dhe kontabilitetin por akoma deri më tani nuk ka i ka bërë efektive.

Tashmë jetojmë në një kohë ku duhet ndryshuar kultura jonë e të menduarit e të vepruarit, për përgatitjen e pasqyrave të raportimit financiar dhe auditimit të tyre. Sot në jemi shumë afër marrjes së statusit të vendit kandidat për të hyrë në BE dhe duhet të mendojmë e të veprojmë si të tillë. Hapja e tregjeve të kapitalit, firmosja e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, firmosja e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë dhe Evropianizimi i Ekonomisë Shqiptare kërkon transparencë dhe

gjuhë të njëjtë kontabël. Plotësimi edhe i këtyre kushteve do të lehtësonte edhe problemet e integrimit të Shqipërisë në BE. Shpreh besimin që armata e kontabilistëve dhe audituesve të vendit tonë do të dijë të vlerësojë dhe të shfrytëzojë të gjitha mundësitë për të ecur me kërkesat e kohës duke mos e lënë veten të ngelet prapa.

Prof. Dr. Jorgji Bollano është Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve (KKK)

LITERATURA

- Compatabilite generale de l'entreprise
- V. 1993. Jean Pier CASMIR, Bernard CASPAL, Maurice COZIAN.
- Ligji nr. 7661, datë 19.01.1993 "Për Kontabilitetin".
- Plani Kontabël i Përgjithshëm, v. 1993.
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar me ligjin 9477, datë 09.02.2006.
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, v. 2009.
- International Accounting Standard Board. International Financial Reporting Standard (IFRS) v. 2008.
- Ligji "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit Ekspert Kontabël të Regjistruar dhe Kotnabilist të miratuar, nr. 1009, datë 5.3.2009.

Rregullatorët e auditimit

Parimet e mbikëqyrjes së kujdesshme

TË NJOHIM PARIMET BAZË KU MBËSHTETET PUNA E RREGULLATORËVE TË PAVARUR TË AUDITIMIT

Duke qene së vendi ynë së shpejti do të marre statusin e vendit kandidat për t`u anëtarësuar në BE, ai ka obligimin që të përafroje legjislacionin e tij me *Aki Communttaire*. Në fushën e auditimit, ky përafrimi nënkupton pajtueshmërinë me Direktivat ndërkombëtare të auditimit, ku njëri nga aspektet është edhe krijimi dhe forcimi i sistemit të mbikëqyrjes publike. Në zbatim të ligjit 10091 datë 5.03.2009, që nga muaji Shtator 2009, Shqipëria ka ngritur Bordin e Mbikëqyrjes publike të Audituesve, veprimtaria e të cilit është e fokusuar në aspektet mbikëqyrëse dhe rregullatore të fushës profesionale të kontabilitetit dhe auditimit.

PROF. AS. DR. HYSEN ÇELA

Me 30 Korrik 2002 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u miratua ligji i njohur me emrin "Sarbanes-Oxley Act" ose shkurt SOX-i, i cili zyrtarisht u emërtua si Ligji i Reformës Kontabël në Kompanitë Publike dhe i Mbrojtjes së Investitorëve. Në mënyrë informale ligji mori emrin Sarbanes- Oxley, për nder të atyre që e propozuan (Paul Sarbanes dhe Michael G. Oxley).

Aprovimi i këtij ligj u be kryesisht për shkak të skandaleve financiare të gjigantëve të korporatave amerikane, siç ishin Enron, WorldCom, Tyco, etj. Qëllimi kryesori tij ishte trajtimi dhe rikonsiderimi i përgjegjshmërisë, përgjegjësisë dhe transparencës në lidhje me raportimin e situatës financiare të kompanive. në funksion të këtij qëllimi, ligji i hapi rrugën krijimit të

sistemeve të mbikëqyrjes publike për kontabilitetin e kompanive publike dhe për mbikëqyrjen e rregullimin më të mirë të pavarësisë së audituesve, përgjegjësisë së korporatave, si edhe përmirësimit të sasisë dhe cilësisë së informacioneve që duhet të jepen në pasqyrat financiare të kompanive.

I njëjti zhvillim ndodhi edhe në Europe, me modernizimin e Direktivës së tete ose ndryshe direktivës së auditimit ligjor (Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council of 17 May 2006 - On statutory audits of annual accounts and consolidated accounts"), e cila i kushtohet tërësisht rregullimit të profesionit të audituesit ligjor dhe të procesit të auditimit në vendet e BE-se.

Duke qene së vendi ynë së shpejti do të marre statusin e vendit kandidat për t`u anëtarësuar në BE, ai ka obligimin që të përafroje legjislacionin e tij me Aki Communttaire. Në fushën e auditimit, ky përafrimi nënkupton pajtueshmërinë me Direktivën e auditimit të sipërpërmendur, ku njeri nga aspektet është edhe krijimi dhe forcimi i sistemit të mbikëqyrjes publike. Në zbatim të ligjit 10091 date 5.03.2009, që nga muaji Shtator 2009, Shqipëria ka ngritur Bordin e Mbikëqyrjes publike të Audituesve, veprimtaria e të cilit është e fokusuar në aspektet mbikëqyrëse dhe rregullatore të fushës profesionale të kontabilitetit dhe auditimit.

Ne vijim në këtë shkrim do të trajtojmë shkurtimisht disa nga parimet e mbikëqyrjes së kujdesshme, të cilat janë dhe mbeten objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të përmirësimit të rolit dhe të aktivitetit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike në vendin tonë.

Një sistem i mbikëqyrjes dhe rregullimit të auditimit mund të jetë efikas kur ai paraprakisht përmbush disa kushte të caktuara; që do të thotë së ai ekziston brenda një mjedisi të jashtëm të përshtatshëm. Parakushte të tilla, të cilat ndonëse shpesh janë jashtë kontrollit të sistemit të mbikëqyrjes kombëtare të auditimit, në praktikë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin e vetë këtij sistemi. Parakushti kryesor është ekzistenca e një kuadri ligjor të mirëzhvilluar dhe një kuadri të mirë qeverisjes së korporatave, të cilët bëjnë të mundur të sigurohet mbështetja e nevojshme për të pasur një auditim të një cilësie të lartë. Elementet e këtij kuadri duhet të trajtojnë:

- Parimet dhe standardet e mirëpërcaktuara gjithëpërfshirëse dhe përgjithësisht të pranuara të kontabilitetit dhe auditimit;
- Kërkesat ligjore për përgatitjen dhe publikimin e pasqyrave financiare në përputhje me këto parime dhe standarde;
- Një sistem që detyron përgatitësit e pasqyrave financiare për zbatimin e standardeve me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria me to (p.sh. vendosja e dënimeve, të drejtat e aksionarëve për të vendosur dënime për menaxherët përgjegjës kur ka papajtueshmëri me kërkesat, etj.);
- Marrëveshjet dhe praktikat e qeverisjes së korporatave që mbështetin raportimin me cilësi të lartë të korporatave dhe praktikat cilësorë të auditimit; dhe

• Marrëveshjet efektive të edukimit dhe trajnimit për kontabilistët dhe audituesit.

Në rastin e të metave, rregullatorët e auditimit duhet të ndërgjegjësojnë organet e qeverisë apo edhe organet e tjera vendimmarrëse në lidhje me këto çështje dhe për ndikimet e tyre të mundshme në cilësinë e auditimit ose në funksionimin e një sistemi të mbikëqyrjes efektive të auditimit. Rregullatorët e auditimit, duhet ta kenë pjesë të aktiviteteve të tyre normale, punën për zbutjen e efekteve të të metave të tilla mbi efikasitetin e tyre të mbikëqyrjes, rregullimit dhe inspektimit. Parimet bazë të mbikëqyrjes publike janë përpunuar nga IFIAR[1], mbulojnë aspekte e organizimit strukturor të rregullatorëve, çështjet e veprimtarive të tyre operacionale dhe kryerjen e inspektimeve. Këto parime janë dhëne shkurtimisht me poshtë:

1. *Përgjegjësitë dhe kompetencat e rregullatorëve të auditimit duhet t`i shërbejnë interesit publik dhe të jenë qartësisht dhe objektivisht të përcaktuara në ligj.*
Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një mandat për të punuar në interes të publikut dhe për të mbrojtur investitorët përmes kërkesës për të përmirësuar cilësinë e auditimit. Përgjegjësitë dhe kompetencat e rregullatorëve të auditimit duhet, të paktën, të kërkojnë të bëhet mbikëqyrja e pavarur e auditimit të entiteteve me interes publik.
Kuadri ligjor për mbikëqyrjen e auditimit duhet të përcaktojë mandatin dhe përgjegjësitë që duhet të kenë rregullatorët e auditimit dhe t`u japë rregullatorëve kompetencat dhe autoritetin e duhur, të cilat bëjnë të mundur kryerjen prej tyre të detyrave të mbikëqyrjes së auditimit, duke përfshirë kompetencat për të adresuar, me anë të inspektimit dhe detyrimit për zbatim, kërkesat për autorizimin/ regjistrimin e audituesve/firmave të auditimit dhe kërkesat për pajtueshmërinë me standardet e auditimit, standardet profesionale dhe të pavarësisë.

2. *Rregullatorët e Auditimit duhet të jenë të pavarur në funksionimin e tyre.*
Pavarësia do të thotë aftësi për të kryer aktivitete me natyrë rregullatore dhe për të marrë e zbatuar vendime pa ndërhyrje të jashtme nga ata që janë subjekt i rregullimit. Nga pikëpamja operacionale Rregullatori i auditimit duhet të jetë i pavarur nga ndërhyrjet e jashtme politike dhe nga interesat tregtare, apo nga interesa të tjera sektoriale, kur ai ushtron funksionet dhe kompetencat e tij, duke përfshirë edhe faktin që ai nuk duhet të jetë i kontrolluar në qeverisjen e tij nga individët që e ushtrojnë profesionin e audituesit në praktike. Rregullatori i auditimit duhet të ketë një burim të qëndrueshëm të financimit, i cili është i sigurtë dhe nuk ndikohet nga audituesit dhe firmat audituese, i cili është i mjaftueshëm për ekzekutimin e kompetencave dhe të përgjegjësive.

3. *Rregullatorët e Auditimit duhet të jenë transparentë dhe të përgjegjshëm.*

[1] IFIAR – Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (The International Forum of Independent Audit Regulators)

Rregullatori i auditimit duhet të ketë përgjegjësi publike në përdorimin e kompetencave të tij dhe të burimeve, me qëllim që të sigurojë së ai ka integritetin dhe besueshmërinë. Përveç kësaj, vendimet dhe veprimet e rregullatorit të auditimit duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të përshtatshëm, duke përfshirë edhe të drejtën e apelimit në një autoritet më të lartë së ai. Transparenca duhet të përfshijë publikimin e planeve vjetore të punës dhe raporteve të veprimtarisë, duke përfshirë rezultatet e inspektimeve ose në total ose për çdo firmë të kontrolluar.

4. *Rregullatorët e Auditimit duhet të kenë kompetenca të plota për të detyruar zbatimin*, të cilat përfshijnë aftësinë për të siguruar që rezultatet e tyre të inspektimit ose rekomandimet adresohen në mënyrën e duhur. Këto kompetenca të zbatimit duhet të përfshijnë aftësinë për të vendosur një sërë sanksionesh duke përfshirë, për shembull, gjobat dhe heqjen e një licence të auditimit dhe/ose të regjistrimit.

Rregullatorët e auditimit duhet të paktën të jenë përgjegjës për sistemin dhe kryerjen e përsëritur të inspektimit të firmave të auditimit që ndërmarrin kryerjen e auditimeve të entiteteve me interes publik. Rregullatorët e auditimit duhet të kenë autoritetin dhe aftësinë për të zbatuar rezultatet e inspektimit dhe rekomandimet. Rregullatori i auditimit duhet të ketë marrëveshje të plotë të zbatimit për çështje të tilla si gjobat, pezullimet dhe heqja e licencës apo çregjistrimi i audituesit apo firmës audituese. Rregullatorët e auditimit duhet të kenë mekanizma adekuate dhe të përshtatshme për të mundësuar që informacioni të vijë në vëmendjen e tyre nga palët e treta dhe më pas për t`u marrë me këtë informacion, nëpërmjet procedurave të ankesave ose nëpërmjet marrëveshjeve që synojnë parandalimin. Këto mekanizma duhet të veprojnë në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive dhe rezultatet e tyre duhet të pasohen nga një sistem i përshtatshëm i investigimeve dhe dënimeve në lidhje me rastet e kryerjeve të papërshtatshme ose në papajtueshmëri të auditimit.

5. *Rregullatorët e Auditimit duhet të sigurojnë që personeli i tyre është i pavarur nga profesioni dhe së ata kanë personel të mjaftueshëm me kompetencat e duhura.*

Rregullatorët e auditimit duhet të kenë marrëveshje që sigurojnë së anëtarët e stafit të inspektimit janë të pavarur nga profesioni. Këto marrëveshje, duhet të paktën të garantojnë që anëtarët e personelit të tyre nuk e ushtrojnë profesionin e audituesit dhe as janë të punësuar apo të lidhur me një firmë të auditimit, dhe së marrëveshjet nuk janë të kontrolluara në asnjë formë nga një organizëm profesional. Në mënyrë që rregullatorët e auditimit të jenë efikas, është parakusht që ato të kenë staf të mjaftueshëm me kompetencën e duhur. Personat që kryejnë rishikime të sistemeve të sigurisë të cilësisë të firmave të auditimit duhet të kenë trajnimin e duhur profesional dhe përvojën përkatëse në auditim dhe raportimin financiar, dhe trajnim për rishikimet rregullatore të sigurimit të cilësisë. Kjo gjithashtu do të thotë së

ekzistojnë marrëveshje të përshtatshme për konsultim dhe diskutim mes inspektorëve. Inspektorët e rinj duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe trajnimit të duhur.

6. *Rregullatorët e auditimit duhet të jenë objektivë, të mos kenë konflikt interesi dhe të mbajnë konfidencialitetin e duhur.*
Rregullatorët e auditimit duhet të mbajnë standardet më të larta të sjelljes etike për t'i dhënë publikut besim në objektivitetin e vendimeve të tyre. Ata duhet të zbatojnë dispozita të cilat shmangin konfliktin e interesit si nga organet e tyre të drejtimit e të qeverisjes, ashtu edhe nga personeli i tyre, gjithashtu, prej tyre duhet të zbatohen edhe dispozita e marrëveshje të përshtatshme që garantojnë mbajtjen e konfidencialitetit dhe mos shpërndarjen publike të informacioneve konfidenciale.

7. *Rregullatorët e Auditimit duhet të hartojnë dhe të zbatojnë marrëveshjet e duhura për të siguruar bashkëpunimin me rregullatorë të tjerë të auditimit dhe kur është nevoja edhe me palët e treta.*
Duke pasur parasysh natyrën globale të tregjeve financiare, për të përmirësuar cilësinë e auditimit është e nevojshme dhe e rëndësishme bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me rregullatorët e tjerë të auditimit dhe me palët e treta, duke përfshirë edhe rregullatorët e tregut financiar. Rregullatorët e auditimit duhet të ofrojnë ndihmë për njëri-tjetrin në kohën e duhur dhe brenda kufijve të arsyeshëm. Për këtë duhet të vihen në jetë marrëveshjet që ndihmojnë për shkëmbimin e informacionit mes rregullatorëve të auditimit dhe rregullatorëve të tjerë (ose ndërmjet pjesëve të sistemit të mbikëqyrjes së auditimit nëse ai përfshin më shumë së një organizëm), dhe për të mbrojtur konfidencialitetin e këtij informacioni.

8. *Rregullatorët e Auditimit duhet të paktën, të kryejnë inspektime periodike të firmave audituese që kryejnë auditime të entiteteve me interes publik* për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me standardet profesionale të zbatueshme dhe me kërkesat, ligjet dhe rregullat e pavarësisë.
Inspektimet periodike duhet të bëhen në bazë të një procesi që përfshin përzgjedhjen e firmave të auditimit që do ti nënshtrohen inspektimit, emërimin e një grupi inspektimi me ekspertizën dhe kompetencën e duhur, njoftimin e firmës së auditimit, kërkimin paraprak të dokumentacionit, njoftimin për angazhimet e auditimit të përzgjedhura për rishikim, takimet me drejtimin dhe marrëveshjet për inspektimet në terren.
Procesi i inspektimit duhet t`i nënshtrohet një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm të cilësisë që funksionon brenda rregullatorit të auditimit për të siguruar cilësi të lartë dhe qëndrueshmëri.

9. *Rregullatorët e Auditimit duhet të garantojnë së ata zbatojnë një program inspektimi të bazuar në rrezik.*
Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një proces për vlerësimin e rreziqeve në mjedisin e auditimit dhe rreziqeve të auditimit në firmat individuale të rregulluara dhe të angazhimeve të tyre të auditimit. Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një proces për marrjen në konsiderate të vlerësimit të rrezikut kur ata bëjnë shpërndarjen e burimeve

të tyre të inspektimit dhe në përcaktimin e metodave të inspektimit. Këto procese duhet të jenë proporcionale me madhësinë dhe kompleksitetin e firmave të auditimit dhe klientët e tyre. Ata duhet të vendosin një cikël minimal në lidhje me shpeshtësinë e inspektimeve.

10. *Rregullatorët e Auditimit duhet të sigurojnë që inspektimet përfshijnë procedura të efektshme si për rishikimin e firmës së auditimit ashtu edhe të dosjeve të tyre të angazhimit.*
Metoda e inspektimit e bazuar në rrezik duhet të reflektohet si në rishikimin e firmës (procedurave) ashtu edhe në procedurat e inspektimit të dosjeve të auditimit. Procedurat që kanë të bëjnë me rishikimin e firmës duhet të trajtojnë sistemet e kontrollit të cilësisë të firmës së auditimit, që gjen pasqyrim në politikat procedurat dhe organizimin e firmës së auditimit. SNKC 1 ose standarde të tjera të ngjashme, duhet të përdoren si një pikë referimi në kryerjen e procedurave të inspektimit të firmës së auditimit. Procesi i inspektimit duhet të përfshijë edhe testimin e dosjeve të auditimit të zgjedhura në mënyrë që të vlerësojë efikasitetin e sistemit të kontrollit të cilësisë të firmës dhe për të vlerësuar pajtueshmërinë e saj me ligjet, rregullat dhe standardet profesionale të zbatueshme.

11. *Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një mekanizëm për raportimin e fakteve të gjetura nga* inspektimet e firmave të auditimit dhe për të garantuar që firmat e auditimit bëjnë korrigjimet e duhura.

Rregullatorët e auditimit duhet të kenë një proces që siguron së kritikat ose mangësitë e mundshme në një sistem të kontrollit të cilësisë të firmës së auditimit dhe çështjet që lidhen me performancën e auditimit të një firme të auditimit, të cilat janë identifikuar gjatë një inspektimi, i janë raportuar firmës së auditimit. Proceset e raportimit duhet të përfshijë përgatitjen dhe lëshimin e një projekt raporti të inspektimit, një proces që garanton së firma e auditimit do të përgjigjet, dhe përgatitjen dhe lëshimin e një raporti të inspektimit përfundimtar. Përveç kësaj, rregullatorët e auditimit duhet të kenë një proces që garanton së firmat audituese i trajtojnë në mënyrë të kënaqshme faktet e gjetura nga inspektimi, të cilat kanë qenë raportuar për firmën e auditimit nga rregullatori i auditimit.

Sipas statutit të IFIAR, Parimet Themelore të trajtuara me sipër kanë për qëllim të promovojnë një mbikëqyrje të pavarur dhe efektive në nivel global, duke kontribuar në këtë mënyrë, në përmbushjen e objektivit të anëtarëve të vet që nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së auditimit, t`i shërbejnë më mirë mbrojtjes së interesit publik dhe të investitorëve.

Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela është menaxher i Managing Partner nH EuroConsult sh.p.k.

LITERATURA

- Sarbanes–Oxley act of 2002 (pub.l. 107-204, 116 stat. 745, enacted july 29, 2002), also known as the 'Public Company Accounting Reform and Investor Protection act'.
- FEE discussion paper “European coordination of public oversight” september 2003
- Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council of 17 may 2006 on statutory audits of annual accounts and consolidated accounts, amending council directives 78/ 660/EEC and 83/349/EEC and repealing council directive 84/253/EEC, ojeu l157, 9 june 2006
- EC communication “a strategic review of better regulation in the EU” com(2006) 689 final – 14.11.2006 .
- FCM (Federation of Experts Comptables Mediterraneens- the public oversight system in mediterranean countries -a comparative study-november 2007
- FEE (Federation of Experts Cmptables European)- Public Oversight of the audit profession - fact sheet 12/2006,
- The public oversight and quality assurance systems in audit: community of practice -results of scientific research – Nexia International (Andrejs Ponomarjovs -Director general of audit advice, and Olga Molchanova - Head of the department of economic research and management consulting of audit advice).

Të njohim parimet bazë ku mbështetet puna e rregullatorëve të pavarur të auditimit

Auditimi publik

Kontrolli i lartë i Shtetit në Shqipëri - Sfidat

SFIDAT PËR NJË VIZION MODERN TË AUDITIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Sfidat e kohës së sotme janë tejet kërkuese dhe e vendosin një institucion auditimi, specifikisht Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), përballë një sprove të madhe. Në mbarë vendet me ekonomi tregut është bërë përparësi absolute disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik. KLSH në rolin e tij si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në vend, sidomos i kontrollit të performancës së administrimit dhe financave publike, mbart një përgjegjësi të spikatur për miradministrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, nëpërmjet një kontrolli të përdorimit të burimeve në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe efiçiencë.

DR. BUJAR LESKAJ

Ndryshimet ekonomiko-politike që ndodhën pas vitit 1990 mundësuan krijimin e një institucioni të auditimit të financave publike sipas formateve që ekzistojnë në vendet me ekonomi tregu. në kushtet aktuale ku tranzicioni në një ekonomi tregu është në përfundim, në kushtet e një krize ekonomiko-financiare në vendet Europiane si dhe në ndjekje të standardeve ndërkombëtare të auditimit të cilat evoluojnë vazhdimisht, është i domosdoshëm avancimi në një vizion të ri modern për një institucion suprem auditimi.

1. Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standarteve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI.

KLSH duhet të synojë formatimin e punës duke e organizuar atë sipas parimeve të deklaratave INTOSAI të Meksikos (2007) dhe të Johanesburgut (2010), sipas praktikave më të mira të

institucioneve simotra në vendet më të përparuara të Bashkimit Europian dhe e mbështetur tërësisht në kornizën e plotë kushtetuese dhe ligjore të vendit. Në punën e tij, KLSH mund dhe duhet të pasqyrojë pesë parimet kryesore të një qeverisjeje të mirë, specifikisht: *transparencën*, *përgjegjshmërinë*, *efikasitetin*, *pjesëmarrjen* dhe *koherencën* në veprime. Për ta kryer këtë, ky institucion suprem auditi (ISA) mund dhe duhet të realizojë më fuqimisht standardet ndërkombëtare të kontrollit, si dhe Deklaratat më të fundit të miratuara nga INTOSAI në dy kongreset e saj në Meksikë 2007 dhe në Afrikën e Jugut 2010, duke thelluar përmbajtjen e deklaratës së Limës të vitit 1977.

Deklarata e Meksikës konsolidoi tetë parimet e pavarësisë së Institucioneve të Larta te Kontrollit si më poshtë:

1. Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues/statutor/ligjor dhe zbatimi "de facto" i tij.
2. Pavarësia e drejtuesve dhe anëtarëve të Institucionit Suprem të Auditit (SAI), duke përfshirë sigurinë e rezidencës dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tyre.
3. Një mandat mjaftueshmërisht të gjatë dhe liri e plotë në kryerjen e funksioneve të SAI.
4. Akses të pakufizuar ndaj informacionit.
5. E drejta dhe detyra të raportojnë në punën e tyre.
6. Liria për të vendosur për përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për t'i publikuar dhe shpërndarë ato.
7. Ekzistencën e mekanizmave efektivë që ndjekin rekomandimet e SAI.
8. Autonomi financiare, menaxheriale /administrative dhe pasja e burimeve të duhura njerëzore, materiale dhe monetare.

në një këndvështrim të tillë, audituesi publik duhet të tregojë profesionalizëm dhe integritet në respektimin e këtyre standardeve bazë ndërkombëtare. Ai duhet të thellohet sidomos në zbatimin e kërkesave të Nenit 163 të Kushtetutës dhe në zbatimin e Parimit të Tretë të Deklaratës së Meksikos , i cili kërkon që ISA të fuqizohen për të kontrolluar:

- përdorimin e parasë publike, të burimeve ose aseteve nga një mbajtës ose përfitues i tyre, pavarësisht nga natyra ligjore e tyre;
- mbledhjen e të ardhurave që duhet t'i shkojnë qeverisë ose institucioneve të tjera publike;
- ligjshmërinë dhe rregullsinë e llogarive të qeverisë ose institucioneve të tjera publike;
- cilësinë e menaxhimit dhe raportimit financiar; si dhe
- përdorimin e burimeve ne mënyrë ekonomike, efiçencën dhe efektivitetin e qeverisë ose institucioneve të tjera publike.

FMN në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale në vitin 2007 kërkon që politikat dhe rolet menaxheriale të sektorit publik të jenë të qarta dhe të njohura nga publiku. "Financat dhe politikat publike duhet gjithashtu të jenë subjekt i kontrollit nga një strukturë kombëtare auditimi, e pavarur nga ekzekutivi" (Pika 4.3.1 e Kodit). Nga ana tjetër, Marrëveshjet e Johanesburgut (të njohura edhe si Deklarata e Afrikës së Jugut mbi Standardet Ndërkombëtare të Audititit

të Lartë) në Kongresin e nëntorit 2010 të INTOSAI janë njësoj të rëndësishme për KLSH-në, sepse përqendrohen në vlerën dhe përfitimet nga Institucionet e Larta të Kontrollit, si dhe në sfidat e kohës. INTOSAI ka miratuar në këtë kongres një plan strategjik 2011-2016 me 6 përparësi:

1. Siguro pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditit (SAI)
2. Zbato standardet ndërkombëtare të përmirësuara të miratuara në Kongresin e 2010-ës
3. Fuqizo ndërtimin e kapaciteteve të SAI
4. Trego vlerën dhe përfitimet nga SAI
5. Çoje më tej luftën kundër korrupsionit
6. Rrit komunikimin INTOSAI (mes vendeve anëtare) "(Deklarata e Afrikës së Jugut, nëntor 2010), përparësi të cilat mund dhe duhet të jenë pjesë e planeve strategjike të të një institucioni suprem auditi.

KLSH duhet të përsosë metodologjinë e punës së tij drejt realizimit të një metode auditimi të bazuar gjithnjë e më shumë në vlerësimin e riskut, ç'ka do të rriste efiçencën dhe do të kursente burimet që aktualisht shpenzohen gjatë auditimeve tradicionale. është i domosdoshëm përqendrimi në kualifikimin dhe specializimin e audituesve (specializim sipas llojeve të auditimeve dhe sipas sektorëve) duke përmirësuar trajnimin dhe duke vendosur një sistem të edukimit të vijueshëm në vendin e punës.

Kërkesat e Ligjit organik të Buxhetit dhe të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe ligje të tjera të cilat plotësojnë procedurat e administrimit të pronës shtetërore dhe të raportimit financiar, do ta fokusojnë më mirë punën e KLSH-së në vlerësimin e mënyrës së administrimit dhe të përdorimit të burimeve.

Objektivat e një plani zhvillimi duhet të ndërtohet mbi përparësitë e rezolutave më të fundit të INTOSAI në Meksiko dhe në Afrikën e Jugut, duke realizuar Prioritetin e Tete të 12 Rekomandimeve të Komisionit Europian ndaj Shqipërisë, të përmbajtur në Progres Raportin e KE-së për vitin 2011 për thellimin e luftës ndaj korrupsionit, sipas të cilit "kërkohet të tregohet një zbatim efiçient i strategjisë dhe planit të veprimit antikorrupsion" (Progres Raporti i KE-së për Shqipërinë 2011, f. 28).

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE shtron detyrën: "Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me legjislacionin e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së" (Neni 90 i MSA). Në këtë drejtim, KLSH do të forcojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin me institucionet e BE-së dhe partnerë të rëndësishëm si SIGMA, duke synuar të përfitojë maksimalisht nga mbështetja e tyre, për t'a përputhur në mënyrë të plotë aktivitetin e institucionit me standardet e kërkuara nga BE për një institucion suprem auditi. Një rëndësi të veçnatë në performancën e auditimit publik ka rritja e bashkëpunimit me SIGMA-n, me qëllim që nëpërmjet proceseve të

asistencës dhe rishikimit të jashtëm (Peer review) të ndihmohet zhvillimi strategjik i KLSH-së me vektor praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së.

2.Thellim i misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike

KLSH gjatë viteve të fundit është përpjekur të japë kontributin e tij për zbulimin dhe evidentimin e korrupsionit dhe abuzimeve në shumë nga institucionet shtetërore të kontrolluara. Megjithatë, të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se jo gjithmonë janë arritur rezultatet e synuara, si për dobësi të vete Institucionit, ashtu dhe për faktorë të tjerë jashtë tij. Në këtë aspekt, ngelet ende shumë për të bërë. Funksioni parandalues i KLSH ndaj korrupsionit dhe abuzimit, nëpërmjet analizës së riskut dhe kontrolleve të bazuara mbi këtë analizë, si dhe auditi i performancës kanë lënë gjithashtu shpesh herë për të dëshiruar. Për kushtet ku sot zhvillohet ekonomia, mes presioneve të forta nga kriza dhe vështirësitë ekonomike të vendeve përreth, misioni parandalues ndaj korrupsionit dhe abuzimeve ndaj ekonomisë shtetërore merr një rol të rëndësishëm, duke ditur masën e madhe të dëmit që shkakton mashtrimi financiar dhe korrupsioni, si dhe fokusin që ka marrë sot lufta kundër korrupsionit. Luftën pa kompromis ndaj korrupsionit e shtron edhe parimi Nr. 5 (Çoje më tej luftën kundër korrupsionit) i Deklaratës së INTOSAI në Johanesburg në vitin 2010, si dhe Rekomandimi nr. 8 i Komisionit Evropian për integrimin e Shqipërisë. Kjo përpjekje ka përparësi edhe në vendet më të zhvilluara dhe demokratike të Europës. Kështu, sipas Zyrës Kombëtare të Auditit(NAO) në Britaninë e Madhe ”Puna jonë me luftën ndaj mashtrimit financiar na lejon të përgatisim një perspektivë unike në uljen e kostos së korrupsionit për ekonominë e Britanisë së Madhe. Ne e vlerësojmë koston e korrupsionit dhe mashtrimit financiar në më shumë se 30 miliardë paund në vit. Ne inkurajojmë përhapjen e praktikave më të mira dhe një kuptim më të gjerë të rreziqeve të këtyre dukurive mbi ekonominë, si një mënyrë të punuari për të ulur dëmin që sjellin këto dukuri” (NAO, Botimi “Praktika të mira në trajtimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar”, f. 4, 2008).

Konferenca Ndërkombëtare e Anti-Korrupsionit, e zhvilluar në Afrikën e Jugut 12 vite më parë (tetor 1999), hodhi bazat e një përafrimi efikas në punën parandaluese të institucioneve të auditit të lartë ndaj korrupsionit dhe abuzimeve. Në dokumentin e saj kryesor, të titulluar “Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në Luftën kundër Korrupsionit”, thuhet se ”Institucionet e Auditit të Lartë (ISA) ranë dakort se është e vështirë të zbulosh format e shumta të korrupsionit, duke qenë se humbja dhe dëmi i shtetit nuk del domosdoshmërisht në regjistrat e llogarive ose në deklaratat financiare të subjektit që kontrollohet”. Megjithatë, treguesit statistikorë dëshmojnë për një lidhje mes treguesve të ndryshëm të financave publike dhe nivelit të perceptuar të korrupsionit. Prandaj dhe ISA bien dakort që ligjet dhe rregullimet, së bashku me kontrollin e duhur, mund të parandalojnë dhe zvogëlojnë mashtrimin financiar dhe korrupsionin. Shembuj të sektorëve

veçanërisht të ekspozuar ndaj korrupsionit janë:
- mbledhja e taksave dhe e burimeve të tjera të të ardhurave;
- administrimi i tenderave, prokurimeve dhe kontratave;
- koncesionet, lejet dhe liçensat;
- marrja në punë e personelit të administratës;
- doganat; dhe
- procesi i privatizimit ("Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në Luftën kundër Korrupsionit", f. 4, 1999).

KLSH duhet të thellojë analizën e vet të riskut në auditin financiar pikërisht në këta sektorë, duke e fuqizuar dhe e kombinuar rolin e tij luftues ndaj korrupsionit me rolin parandalues, të cilin duhet ta ushtrojë fuqimisht.

Magnus Borge, drejtor i Inisiativës së Zhvillimit të INTOSAI dhe botues i dokumentit të mësipërm, shprehet në qershor 2008 se "roli qendror i ISA në luftën ndaj korrupsionit është promocioni i menaxhimit financiar të shëndoshë dhe inkurajimi i mekanizmave të fortë të kontrollit të brendshëm në strukturat publike. Në veçanti, sisteme të fuqishëm të menaxhimit financiar, të bazuar në raportimin financiar efektiv dhe në publikimin e çdo deviacioni kanë një efekt ndalues tek ata që tentojnë të kryejnë korrupsion". Sipas Konferencës Ndërkombëtare të Anti-Korrupsionit në Afrikën e Jugut, "Institucionet e Larta të Kontrollit (ISA) ndjekin disa praktika në identifikimin e fushave me rrezik të lartë korrupsioni dhe abuzimi, që nga rishikimi i punës së auditit të vitit të kaluar tek vlerësime sistematike të dobësisë së programeve, projekteve apo institucioneve, të bazuara nga histori abuzimi të së kaluarës, nga dobësia menaxheriale ose nga denoncimet e mediave. Këto dy përafrime përfaqësojnë koncepte të ndryshme të vlerësimit të riskut. Në përafrimin e parë, programet, projektet dhe institucionet renditen me risk të ulët, të mesëm dhe të lartë për të përcaktuar një plan auditi. Kjo i lejon institucionit të auditit superior të alokojë burime tek institucioni apo programi vulnerabël, duke ndërtuar edhe procedura auditi shtesë, nëse do të ishte e nevojshme. Pothuajse gjithnjë auditimet në subjekte me risk të lartë kanë identifikuar aktivitet korruptiv dhe abuziv domethënës.

Përafrimi i dytë përqendrohet në sektorë e fusha veprimtarie, më shumë se sa në institucione e projekte të veçanta qeveritare dhe shtetërore. Ai bëhet baza e një strategjie për të targetuar sektorin që u jep një kërcënim të fortë burimeve publike dhe për të synuar pakësimin ose elimininimin e këtij kërcënimi" (Magnus Borge, "Roli i Institucioneve të Auditit të Lartë në luftën ndaj korrupsionit", dokumente përmbledhëse të Konferencës Ndërkombëtare të AntiKorrupsionit në Afrikën e Jugut, f. 16, 1999).

Mendoj se këto përafrime kanë vlerë aktuale për veprimtarinë e KLSH-së dhe duhet të përqendrojnë vëmendjen e stafit të saj. Lufta ndaj korrupsionit dhe roli parandalues i KLSH-së ndaj veprimeve korruptive dhe abuzive me pronën shtetërore do të jenë politika dhe veprime qendrore në Strategjinë e zhvillimit të institucionit 2012-2015, vijim i strategjisë së tanishme 2009-2012, duke përsosur metodologjinë e kontrollit.

3.Kthim i vëmendjes tek auditi i performancës, krahas konsolidimit të auditit financiar

Deri tani audituesi publik në Shqipëri ka prevaluar auditi financiar, duke u përqendruar me shumë në kontrollin e mbajtjeve të llogarive dhe në disiplinën financiare, pa konsideruar me përparësi treguesit e efektivitetit, efikasitetit dhe rezultatin ekonomik të institucionit shtetëror objekt i kontrollit.

Sipas INTOSAI, auditi i performancës përkufizohet si

"(a) auditi i përdorimit ekonomik të burimeve në aktivitetet administrative, në përputhje me parime dhe praktika administrative të shëndosha, si dhe me politikat menaxheriale të duhura

(b) auditi i efiçiencës së përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe të burimeve të tjera, duke përfshirë ekzaminimin e sistemeve të informacionit, treguesve të performancës dhe te sistemit të monitorimit, dhe

(c) auditi i efektivitetit të performancës në lidhje me përmbushjen e objektivave të subjektit të kontrolluar, si dhe auditi i impaktit aktual të aktiviteteve, i krahasuar me impaktin e synuar"(INTOSAI, "Manual Zbatimi për Auditin e Performancës", f. 3, 2004)

Sipas eksperiencës britanike, "matja e performancës është kuptimi i asaj çfarë marrim për paranë që shpenzojmë. Punonjësi, auditori i performancës duhet të jetë i gatshëm të ndihmojë kolegët e institucionit qeveritar që kontrollon për t'i orientuar në:

• zhvillimin e planeve dhe treguesve të performancës
• përmirësimin e cilësisë së të dhënave
• rregjistrimin e performancës dhe raportimin ndaj drejtuesve dhe publikut
• përdorimin e masave të performancës për të përmirësuar apo motivuar performancën
• lidhjen e performancës me vendimet e alokimit të burimeve
• kryerjen e vlerësimeve organizative (Manual i NAO "Matja e performancës qeverisëse, 2010", f. 28, qershor 2010).

Sipas z. Amyas Morse, kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditit()NAO), Britani e Madhe, "Matja e performancës së qeverisë është jetësore. Tregon nëse taksapaguesi po merr vlerë për paranë dhe i lejon njësive qeveritare të mësojnë nga eksperienca dhe të përmirësojnë performancën.

Çdo tregues matjeje performance duhet të jetë i qartë, i matshëm dhe drejtpërsëdrejti i lidhur me burimet e përdorura për të siguruar shërbimet apo produktet e performancës" (nga fjala e z. Morse mbajtur më 14 korrik 2010 përpara Dhomës së Lordëve). Ky aspekt i matjes së performancës së institucioneve që kontrollon mund të shndërrohet në dobinë kryesore të punës së KLSH, krahas parandalimit të korrupsionit dhe abuzimeve.

Ndarja e detyrave në të mund të çojë në të ardhmen e afërt dhe në një specializim të një pjese të inspektorëve të KLSH në auditues performance, ku roli korrigjues, orientues dhe këshillues mbizotëron.

Auditimi nëse aktivitetet administrative janë bërë në mënyrë ekonomike ka për qëllim të vlerësojë nëse ato janë në pajtim me parimet bazë dhe praktikat me të mira të administrimit dhe në pajtim me politikat e pranuara te drejtimit në ekonomi.

Auditimi i efiçiences, ka për qëllim të vlerësojë përdorimin eficent të burimeve financiare dhe burimeve të tjera; ai përfshin edhe ekzaminimin e sistemeve të informacionit, vlerësimin e matësve të performancës dhe sistemet

e monitorimit dhe procedurat që duhet të ndjekin entitetet e audituara për të korrigjuar mangësitë e vërejtura. Auditimi i efektivitetit ka për qëllim të vlerësojë efektivitetin e performancës në lidhje me arritjen e objektivave të entitetit të audituar dhe gjithashtu, edhe ndikimin (impaktin) aktual të aktiviteteve krahasuar me ndikimin e parashikuar.

Auditimi i performancës nuk është një auditim i rregullt (pra që kryhet me procedura e standarde të përcaktuara) dhe që përfundon me një opinion të formalizuar. Rrënjët e tij nuk lidhen me auditimin e entiteteve private. Ai konsiderohet një ekzaminim i pavarur që nuk bëhet mbi një bazë që ripërsëritet. Për nga natyra, ky auditim është më i gjerë dhe i hapur për gjykime dhe interpretime. Në dispozicion të tij ka një varg metodash të zgjedhjes për investigimin dhe vlerësimin dhe nga ana tjetër ai kërkon një varietet të madh të njohurive, krahasuar me ato që kërkohen për auditimin tradicional. Thënë ndryshe, auditimi i performancës i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike, e cila nënkupton faktin që individët që janë përgjegjës për zbatimin e programeve qeveritare ose drejtimin e ministrive kanë përgjegjësinë për drejtimin e tyre me efektivitet dhe efiçiencë. Auditimi i performancës është një mënyrë për ushtrimin e kontrollit dhe marrjen e informimit mbi mënyrën e drejtimit dhe rezultatet e aktiviteteve të ndryshme qeveritare nga veprimtarët kyçë, ku përfshihen: taksapaguesit, Parlamenti, drejtuesit ekzekutivë, qytetarët e zakonshëm, shoqëria civile dhe media.

Auditimi i performancës shërben për t`ju dhënë përgjigje pyetjeve si : A merret shërbimi më i mirë nga paratë e shpenzuara? A është e mundur që paratë të shpenzohen më mirë ose në një mënyrë më të zgjuar?

Auditimi i performancës është i lidhur ngushte me mirëqeverisjen. Kriteri kryesor i qeverisjes së mirë është pikërisht fakti që të gjitha shërbimet publike (ose programet qeveritare) t'i nënshtrohen auditimit.

KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqëndruar punën tek auditi i performancës, pse ai i shërben vleresimit të përgjegjshmërisë publike. Përqëndrimi i vëmendjes tek auditi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2012-2015 të KLSH. Në të, manuali i auditimit të performancës do të zbatohet jo thjesht si një procedurë , por do të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH. Një filozofi pune që konsideron se kontrolli nuk është një qëllim në vetevete, por në rradhë të parë një instrument parandalimi ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore, një instrument korrigjimi dhe këshillimi të institucionit që kontrollohet. Së bashku me audituesit e brendshëm të institucioneve shtetërore, në bazë të Ligjit Nr. 9720 dt. 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" , si dhe me inspektorët financiarë publikë të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit Nr. 10294 dt. 01.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik", KLSH do të koordinojë punën e auditit financiar, për të mos patur dublime të panevojshme, duke u përqëndruar vetë si institucion tek auditi financiar, dhe shumë herë më tepër se sa tani, tek auditit i performancës.

4. Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të se njejtes fushe, si me Departamentin e AntiKorrupsionit pranë Kryeministrisë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me Prokurorinë e Shtetit, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar

Praktika e deritanishme ka dëshmuar se KLSH ka humbur efikasitetin e ndërhyrjeve të tij në rastet kur ka vepruar i vetëm, ose kur e ka konceptuar veprimtarinë e tij veçmas nga institucionet e tjera të ngjashme me të. Prej kohësh tashmë ka lindur nevoja e një bashkëveprimi konkret dhe intensiv me struktura shtetërore që kryejnë detyra të afërta me një pjesë të detyrave të KLSH, si Departamenti për Luftën ndaj Korrupsionit në Këshillin e Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, apo edhe që vijojnë punën pas propozimeve të KLSH, sikurse është Prokuroria e Shtetit, si organ qendror i akuzës së Shtetit.

Strategjia Anti-Korrupsion 2008-2013 e qeverisë Berisha kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: "Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë "(f. 16, Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013) .

Duhet theksuar se KLSH nuk i cënohet pavarësia kur sinergjizon politikat dhe veprimet e tij me institucionet e lartpërmendura. por përkundrazi i rritet efektiviteti dhe efiçienca e tij, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese.

Unë, në rast se votëbesohem nga Ju, do të propozoj dhe të kërkoj menjëherë realizimin e një bashkëveprimi institucional, nëpërmjet Memorandumeve të Bashkëpunimit me të katër strukturat e lartpërmendura. Për këtë ekziston baza ligjore e duhur. Për shembull, Neni 26 i Ligjit Nr. 9720 dt. 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" e kërkon shprehimisht bashkëpunimin me KLSH, si dhe po ashtu edhe Neni 8, pika "d" e Ligjit Nr. 10294 dt. 01.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik". Në këto marrëveshje, krahas shkëmbimit reciprok të informacionit, nëse do të gjykohet në dobi të punës, mund të planifikohen dhe ndërhyje e kontrolle të përbashkëta(sidomos për tre strukturat e para), për të rritur efektivitetin dhe efiçiencën e auditit.

Një përqasje e tillë është një praktikë pune e hasur dendur në vendet më të zhvilluara të BEsë anëtare të INTOSAI(p.sh., Zyra Kombëtare e Auditit në Britaninë e Madhe për parandalimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar

bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Parandalimit të Mashtrimit Financiar dhe me Komisionin Britanik të Auditit. Të njëjtin bashkëpunim realizon Bundesrechnungshof-i gjerman, organi suprem i auditit në Republikën Federale të Gjermanisë, me gjykatat rajonale gjermane).

Një bashkëpunim i veçantë lypset të jetë ai i KLSH me organin e Prokurorisë së Shtetit, duke parë rastet shumë të rralla të deritanishme, kur denoncimet dhe rekomandimet e KLSH kanë gjetur jehonë në punën e Prokurorisë. Një akt-marrëveshje, një memorandum bashkëveprimi me këtë institucion do t'i hapte rrugë jo vetëm thellimit të njohjes reciproke mes të dyja institucioneve, por edhe kuptimit më të mirë të natyrës së punës së njëra-tjetrës dhe rritjes së informacionit dhe kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit. Shpesh mungesa e informacionit dhe e komunikimit në nivelet e duhura, ka bërë të dështojnë përpjekjet për bashkëpunim. Ju garantoj se nëse ka ndonjë draft apo marrëveshje me Prokurorinë, ai do të çpluroset dhe do të marrë formën e duhur të një bashkëpunimi konkret dhe intensiv në të ardhmen e afërt. Nëse nuk ka, kjo marrëveshje do të jetë ndër veprimet e para që do të ndërmerren.

Nga ana tjetër, rezultatet e kontrolleve të kryera nga grupe të përbashkëta me institucionet e lartpërmendura, ose të mbikqyrura apo konfirmuara nga ekspertë të institucioneve paralele janë të mirëpritura dhe pse mbartin një peshë më të madhe në publik dhe japin mesazhin e fuqishëm të angazhimit të përbashkët të të gjitha strukturave shtetërore për luftën ndaj korrupsionit dhe abuzimeve me administrimin e pronës shtetërore.

5.Intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues.

Në zbatim të neneve 162 dhe 164 të Kushtetutës dhe të detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë dt. 02.06.2011 për konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin, në përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, në përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit, KLSH do të organizojë dhe mbajë gjithnjë operativ një kalendar takimesh e konsultimesh me përfaqësues të Kuvendit, sidomos me Ju, anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Bazuar në përvojën tuaj si legjislatorë dhe profesionistë të fushës, KLSH do t'ju adresohet në vijimësi për ide dhe sugjerime lidhur me përpilimin dhe zbatimin e planit të tij strategjik të zhvillimit 2012-2015. Ky plan do të vlerësojë përpjekjet e Planit Strategjik 2009-2012 në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, të përsosjes së metodologjisë së kontrollit, të rritjes së burimeve njerëzore dhe të mbështetjes administrative, përfshirë teknologjinë e informacionit, por do të thellohet në rekomandimet e kongreseve të fundit të INTOSAI, të cilat mendoj se nuk njihen sa duhet(duke u nisur dhe nga pasqyrimi në website-in e KLSH).

Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos të Komisionit tuaj. Informimi kushtetues dhe ligjor ndaj Kuvendit do të shtrihet me efikasitet dhe profesionalizëm edhe drejt publikut.

6.Intensifikim i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditit të financave publike, si dhe me organizata të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit organik të KLSH-së, i cili shprehet se ky institucion mund të kontraktojë ekspertë të përkohshëm. KLSH, për vete sfidat qe e presin ka nevojë të grumbullojë pranë vetes ekspertizën më të mirë të fushës, duke forcuar lidhjet dhe madje duke i vendosur ato në baza institucionale me organizatat e kontabilistëve, me ekspertët dhe profesoratin e financave publike në universitetet kryesore të vendit dhe me akademikët e kësaj fushe. KLSH duhet të ketë lidhje dhe të zhvillojë konsultime të herëpashershme për veprimtarinë e saj me IEKA dhe me organizatat e tjera profesionale të fushës. Kjo nuk përbën aspak nënvleftësim ndaj ekspertizës së vetë institucionit, por do të jetë në dobi të rritjes së profesionalizmit të stafit të KLSH, për të përballuar me efikasitet auditet e rëndësishme, në veçanti atë të performancës. Bashkëpunimi mund të jetë shumëformësh, duke i ftuar këta ekspertë si lektorë në trajnimet e stafit të KLSH, duke i angazhuar në grupet e kontrollit, apo në kontrollet e performancës së sektorëve të caktuar të ekonomisë, me risk të lartë, si dhe për testimin e vetë stafit të KLSH. Ekspertiza e fituar prej tyre ka vlerë si mendim i pavarur dhe i një niveli të lartë profesional. Një përqasje të tillë e rekomandon edhe FMN në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale(Pika 4.3.4 faqe 4 e Kodit), kur thotë se “ekspertë të pavarur duhet të ftohen për të vlerësuar parashikimet fiskale...”.

Sfidat e reja e bëjnë të domosdoshëm rritjen e kapaciteteve të audituesve të KLSH. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se niveli i tyre profesional nuk është ai i duhuri, pavarësisht nga përpjekjet e bëra, duke u nisur që nga viti 1992.

7.Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës

Deklarata e Johanesburgut(2010) e INTOSAI i ka kushtuar një pikë të veçantë të saj(pika 6) bashkëpunimit mes Institucioneve Supreme të Auditit të vendeve anëtare. Është për t’u vlerësuar bashkëpunimi i deritanishëm i KLSH me Zyrën Kombëtare të Auditit në Britaninë e Madhe dhe me Gjykatën Hollandeze të Auditit në përgatitjen e planeve strategjike. Ky bashkëpunim duhet vijuar dhe thelluar edhe më tej, në formën e vizitave të shkëmbimit të eksperiencës dhe/ose të trajnimeve që ekspertë të SAI të këtyre vendeve dhe

të shteteve të tjera të zhvilluara në BE, ose të Komitetit të Trajnimeve në EUROSAI, mund të zhvillojnë për stafin e KLSH.

Do të intensifikohen kontaktet dhe mundësitë e bashkëpunimit me Institutin e Zhvillimit të INTOSAI dhe me strukturat e EUROSAI, sidomos për luftën kundër korrupsionit. Do shihen mundësitë e bashkëpunimit me Gjykatën Europiane të Audituesve, e cila mbikqyr auditin e jashtëm të vendeve të BE-së, sidomos për rritjen e nivelit të audituesve të performancës. Gjykata ka fuqinë të kontrollojë çdo person ose organizatë që përdor fonde të Bashkimit Evropian, duke përfshirë autoritetet kombëtare në vendet anëtare të BE, institucione të tjera të BE dhe madje edhe vende të tjera jashtë BE që përfitojnë nga fondet e BE. Sipas Vitor Caldeira, President i Gjykates Europiane te Auditoreve, "Gjykata kryen audite, nëpërmjet te cilave ajo vlerëson mbledhjen dhe shpenzimin e fondeve te BE-se. Ajo ekzaminon nëse veprimet financiare janë regjistruar si duhet dhe deklaruar, nëse ato janë kryer në mënyrë ligjore dhe në bazë të rregullave dhe nëse janë menaxhuar për te siguruar përdorimin me ekonomi te fondeve, efiçiencen dhe efektivitetin e tyre. Gjykata promovon përgjegjësinë dhe transparencën duke ndihmuar Parlamentin Europian dhe Këshillin e Europës që ata të mbikëqyrin zbatimin e buxhetit te BE-se...Ajo i sjell vlerë të shtuar menaxhimit financiar të BE-se nëpërmjet raporteve dhe opinioneve te saj. ...Kjo Gjykatë njihet për integritetin dhe paanësinë, për profesionalizmin, efiçiencen dhe cilësinë e auditimeve dhe opinioneve të saj...Hyrja ne fuqi e Traktatit te Lisbonës riafirmoi mandatin e Gjykatës dhe statusin si një institucion qendror i BE-se"(nga fjala e mirëseardhjes në website të Gjykatës, 2010).

Gjykata Europiane e Auditoreve, krahas raporteve të saj të kontrollit financiar, jep mendime dhe rreth legjislacionit financiar të BE dhe veprimit të BE për të luftuar korrupsionin dhe mashtrimin financiar, duke bashkëpunuar me Zyrën Evropiane të Antikrimit Financiar. Në rajon, KLSH do të zhvillojë më tej kontaktet rajonale me strukturat homologe të rajonit, si dhe do të thellohet marrëdhënia me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës(deri tani në website-in e KLSH gjendet vetëm një vizitë e kësaj Zyre në mars 2008), duke dhënë dhe shkëmbyer eksperiencë, si dhe duke kryer trajnime të përbashkëta. Mendoj se krahas marrjes së eksperiencës nga SAI të vendeve më të zhvilluara të BE-së dhe nga ato të vendeve të rajonit, kemi shumë për të bashkëpunuar reciprokisht me strukturën e re të auditit suprem të Kosovës.

8. Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga standardet e INTOSAI(Rezoluta e Meksikos 2007 dhe e Afrikës se Jugut 2010) dhe në përputhje me sfidat për të luftuar me efikasitet korrupsionin

Rezoluta e Kryetarëve të Institucioneve të Auditit Suprem të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe të Gjykatës Europiane të Auditorëve në takimin e tyre në Pragë në tetor 1999, në Rekomandimin e saj të Shtatë shprehet: "Institucionet e Larta të Kontrollit(SAI) duhet të sigurojnë se burimet e tyre njerëzore dhe financiare përdoren në mënyrë efiçiente për të mundësuar ushtrimin më efikas të

mandatit të tyre. Për këtë qëllim, SAI kanë nevojë të zhvillojnë dhe institucionalizojnë politika dhe masa të duhura për të garantuar që Institucioni i Auditit të Lartë të jetë tërësisht i organizuar për të prodhuar punë auditi dhe raporte efektive profesionale dhe të një cilësie të lartë"

Cilësia dhe profesionalizmi do të jenë fjalët kyçe të punës së çdo anëtari të stafit të KLSH, mbas integritetit dhe pavarësisë. Audituesi i KLSH do t'i largohet klishesë së gjobëvënësit apo deklarimeve për bujë, një formatim ky i hasur shpesh, për fat të keq, në të shkuarën. Ç'ka është më e rëndësishme, KLSH do t'i largohet "zbulimeve" të shpërdorimeve hipotetike. Çdo nëpunës i KLSH do të vlerësohet për punën e tij/saj mbi kritere të sakta dhe të qarta profesionale dhe integrale, duke respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 8549 dt. 11.11.1999 "Për Statusin e Nëpunësit Civil", Ligjin 9131 dt. 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" dhe Ligjit Nr. 9367, dt 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike" .

Do të realizohet përshkrimi i ri i punës së secilit, i bazuar mbi standardet INTOSAI për punonjësit e institucioneve supreme të auditit, të përmbajtura në dy Deklaratat e fundit Meksiko 2007 dhe Johanesburg 2010, me synimin e sigurimit të audituesve dhe nëpunësve me integritet të lartë moral dhe profesional, të varur vetëm nga Kushtetuta, ligji dhe Kodi i Etikës i KLSH.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës dhe me universitetet e tjera të vendit, KLSH do të organizojë një konferencë vjetore për të sjellë mendimin më të avancuar në fushën e auditit financiar dhe atij të performancës, mbi bazën dhe të eksperiencave konkrete, duke promovuar specialistët më të zotë dhe rezultativë të tij. Mbi bazën e Nenit 20 të Ligjit organik të KLSH për trajnimin e audituesve, të gjithë audituesit e institucionit do të trajnohen në vijimësi për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe duhet ta gjejnë veten në respektimin rigoroz të standarteve të etikës së audituesit dhe të standardeve ndërkombëtare INTOSAI.

9. Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin

Sipas Magnus Borge, Drejtori i Institutit të Zhvillimit të INTOSAI, roli luftues dhe parandalues ndaj korrupsionit për ISA rritet shumë dhe me bashkëpunimin e tyre efikas me mediat. "ISA mund të luajnë një rol të madh në luftën ndaj korrupsionit, duke komunikuar dhe bërë publike rreziqet e korrupsionit dhe rastet e praktikave korruptive, kur këto janë identifikuar. Ky rol përfshin rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e transparencës dhe të përgjegjësisë së mbajtjes së llogarive, duke prodhuar raporte auditi me vlerë dhe në kohën e duhur, të cilat aksesohen nga publiku ("Roli i SAI në luftën kundër korrupsionit", broshurë e përbashkët e INTOSAI me Transparency International, 2008). Borge po ashtu vëren se disa SAI kanë vendosur lidhje me mediat për të deklaruar në publik rastet e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Ky përafrim duhet të jetë në fokus të punës së përditshme të KLSH me mediat dhe

organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin. KLSH ka nevojë të fitojë akses në publik dhe për këtë i duhet:

a) të transformojë rrënjësisht faqen e saj në internet, duke vendosur lidhje(links) me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin dhe pse jo, dhe me OJF-të aktive në këtë fushë;

b) të furnizojë periodikisht me informacion rrjetet e mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike

c) të bashkëpunojë si partner në botimin e revistave profesionale të fushës, duke kontribuar me kumtesa dhe ese nga anëtarët më aktivë të stafit të tij.

d) të rrisë aksesin e buletinit periodik të KLSH në aktorët kryesorë të opinionit publik, si mediat, opinionistët dhe OJF-të e angazhuara kundër korrupsionit dhe/ose të interesuara për bashkëpunim.

KLSH ka nevojë parësore për një investim të plotë në kuptimin e tërësishëm nga publiku të misionit të tij dhe të aktiviteteve që kryen, si dhe në përmirësimin e imazhit aktual. Për këtë do të përgatisim një strategji komunikimi 2012-2015, që të synojë rritjen e aksesit dhe kuptimin e plotë në publik të misionit dhe rolit të KLSH si luftues dhe parandalues i korrupsionit dhe i abuzimeve me pronën shtetërore, si dhe të rolit të tij orientues dhe ndreqës në performancën e institucioneve publike që kontrollon. Një strategji e tillë do të pajiset me një plan konkret veprimi 2012-2015, duke mundësuar tryeza të rrumbullakëta informacioni dhe konsultimi me OJF-të që luftojnë korrupsionin dhe/ose të interesuara për bashkëpunim, si dhe me media.

Dr. Bujar Leskaj është Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Shënim: [1] Ky punim është shkëputur nga materiali paraqitur nga Dr. Bujar Leskaj pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, datë 14 Dhjetor 2011, në cilësinë kandidatit për Kryetar të KLSH, nominuar nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7163 datë 17 nëntor 2011

Gjithashtu po ky material u punua me audituesit e KLSH në ditën e parë të punës të kryetarit të KLSH B. Leskaj më datën 23 dhjetor 2012.

Auditimi i brendshëm

Auditimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

VLERA E KONTROLLIT TË BRENDSHËM PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) kanë rëndësi të konsiderueshme për ekonominë e një vendi, veçanërisht për një vend të vogël si Shqipëria. Si të tilla ato janë objekt i vazhdueshëm studimi në lidhje me zhvillimin e tyre, qasjen në burimet e financimit etj. Qëllimi i këtij studimi është të bëjë një vlerësim teorik të elementeve të kontrollit të brendshëm në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe të përcaktojë ato elementë të kontrollit të brendshëm që janë më efektive për NVM-të.

DR. REZARTA PERRI
MSC. LINDA ÇEPANI

Abstrakt

Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se punimet kërkimore dhe shkencore që trajtojnë kontrollin e brendshëm më së shumti e shohin atë në kontekstin e shoqërive të mëdha apo të korporatave. Ndërkohë, NVM-të mund të përfitojnë shumë nga implementimi i kontrolleve të brendshme për shkak të kushteve të tyre delikate që burojnë nga madhësia e vogël e tyre. Ekzistenca e kontrollit të brendshëm efektiv mund të kufizojë mangësitë në drejtimin e tyre dhe padyshim që rrit shanset për sukses.

Në bazë të gjetjeve të këtij studimi mund të rekomandojmë se drejtuesit e NVM-ve, audituesit dhe shoqatat profesionale të tyre duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e kontrollit të brendshëm në garantimin e aktiviteteve efektive dhe efiçente. Ky studim është një hap i parë në trajtimin

e aktiviteteve më të përshtatshme dhe më efektive të kontrollit të brendshëm për NVM.

Kufizimet në trajtimin e këtij punimi mund të jenë një mundësi e mirë për kërkime të mëtejshme në fushën e kontrollit të brendshëm për NVM-të duke e pasuruar atë p.sh, me vrojtime empirike në terrenin e ekonomisë shqiptare në lidhje me aplikimet praktike të kontrollit të brendshëm nga ana e NVM-ve në Shqipëri; apo me një kuadër teorik edhe më të plotë të kategorizuar sipas sektorëve të ekonomisë.

Hyrje

Ky punim fokusohet në një trajtim teorik të efektivitetit të kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kontrolli i brendshme përfshin një set instrumentesh nëpërmjet të cilëve mund të drejtohen, monitorohen dhe vlerësohen aktivitetet e ndërmarrjeve të mëdha, të mesme si edhe të vogla. Kontrolli i brendshëm luan një rol të pazëvendësueshëm në parandalimin dhe hetimin e mashtrimeve si edhe në mbrojtjen e burimeve fizike dhe të paprekshme të ndërmarrjeve; mbi të gjitha kontrolli i brendshëm është faktor kyç për një efiçencë të lartë në operacionet e biznesit. Për këto arsye, nëse shoqëria (sidomos NVM-të) nuk ka një sistem të fortë të kontrollit të brendshëm ajo është e kërcënuar në mënyrë të përditshme nga perspektiva e humbjes dhe e falimentimit (Sampson, 1999, fq.4). Sipas përkufizimit të dhënë nga COSO (Committee of Sponsoring Organizations), (COSO, 1992, fq. 2) për kontrollin e brendshëm në NVM, ai është: *"një sistem dhe një proçes i vendosur dhe funksional në një ndërmarrje të vogël apo të mesme në mënyrë që ajo të kryejë aktivitetet e saj në një mënyrë të përshtatshme dhe efiçente*".

Pavarësisht se kontrolli i brendshëm trajtohet kryesisht në kontekstin e ndërmarrjeve të mëdha apo të korporatave globale, kjo çështje ka rëndësi të veçantë të trajtohet pikërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për disa arsye:

Së pari vetë NVM-të kanë rëndësi të konsiderueshme për ekonominë e vendit tonë. Sektori i NVM në vitin 2012 ka një kontribut të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë,duke mbuluar mbi 80% të PBB dhe mbi 80% të punësimit.

Sipas regjistrit të ndërmarrjeve të vitit 2010 (publikuar nga INSTAT) 91.566 ndërmarrje janë me 1-4 të punësuar (mikrondërmarrjet) dhe përbëjnë 91% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërmarrjet e vogla (me 5-9 të punësuar) zënë 5% të numrit total të ndërmarrjeve ndërsa ndërmarrjet e mesme (me 10-49 punonjës) zënë rreth 3% të totalit. Nga ana tjetër, NVM për këtë vit mbulojnë rreth 82 % të numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Për vitin 2011 është komunikuar nga Ministria e Ekonomisë se mikrondërmarrjet përbëjnë 95.7% të numrit total të ndërmarrjeve aktive, duke mbajtur peshën kryesore në zhvillimin e biznesit. Ndërmarrjet e vogla zënë 3.5% të tyre ndërsa ato të mesme 0.7%. Ndërkaq rëndësinë e madhe të NVM-ve, të cilat operojnë kryesisht në sektorin e industrisë dhe shërbimit në vendin tonë, e ka pohuar

edhe censusi më i fundit i ndërmarrjeve. Sipas tij, në këta dy sektorë, kryesojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me nga 50 të punësuar. Duke shtuar edhe faktin tjetër se në Tiranë operojnë 52.9 % e tyre, ndërsa në vend të dytë renditet Durrësi me nivelin prej 11.27 për qind.

Së dyti, aplikimi i kontrolleve të brendshme klasike të shtjelluara në kuadrin konceptual të COSO dhe të pranuara së fundmi globalisht nga organizatat dhe rregullatorët kudo (përfshi edhe IFAC – International Federation of Accountants) bëhet i vështirë dhe shpesh i pamundur për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo sepse këto ndërmarrje nuk kanë numër të mjaftueshëm stafi që të implementojnë ndarjen e detyrave. Mungesa e një ndarjeje të qartë të detyrave hap dyert për veprime mashtruese nga ana e punonjësve. Sipas Higson (2002, fq. 9), për shkak të nivelit të lartë të besimit ambientet e kontrollit në NVM janë të përkufizuara në mënyrë më të dobët, duke lënë hapësira kështu për aktivitete mashtrimi apo përvetësimi të burimeve të shoqërisë. Pra NVM-të mund të përfitojnë shumë nga implementimi i kontrolleve të brendshme për shkak të kushteve të tyre delikate që burojnë nga madhësia e vogël e tyre.

Për më tepër, NVM-të me ligj nuk kërkohen t'u nënshtrohen auditimeve të jashtme të pasqyrave financiare, dhe as të kenë struktura të auditimit të brendshëm. Kjo nënkupton që siguria mbi mbarëvajtjen e aktiviteteve në një ndërmarrje të vogël varet kryesisht nga kontrollet e brendshme të ushtruara në të. Pra kontrolle të brendshme të plota dhe gjithë-përfshirëse kanë rëndësi të pamasë për operacione të pastra dhe të sigurta të NVM-ve.

Ky punim në vijim është organizuar si më poshtë: Në pjesën e parë bëhet një prezantim i koncepteve dhe elementeve kryesore të kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në të njëjtën pjesë jepet gjithashtu një historik i shkurtër i zhvillimit të kontrollit të brendshëm. Në pjesën e dytë shtjellohet teorikisht një kuadër i kontrolli të brendshëm të vlerësuara si më efektive për NVM-të. Në pjesën e fundit konkludohet me gjetjet kryesore të punimit.

Zhvillimi i kontrollit të brendshëm. Elemente dhe koncepte kryesore

Në këtë pjesë të punimit bëhet një shqyrtim i literaturës në lidhje me problematikat kryesore të kontrollit të brendshëm për NVM-të. Ky shqyrtim bëhet me qëllim identifikimin e çështjeve kryesore të trajtuara nga autorë të ndryshëm dhe për t'i përdorur këto elemente në përcaktimin e një kornize teorike sa më të përshtatshme për aplikimin e kontrollit të brendshëm për NVM-të.

Nga literatura e shqyrtuar vihet re se aplikimi dhe praktikimi i auditimit të brendshëm ka ekzistuar për një kohë relativisht të konsiderueshme. Për mbi 60 vite ai është njohur tashmë në rang botëror si një profesion i mirëfilltë me profesionistë praktikues nga mbi 165 vende (IIA, 2005, fq 1). Pika kryesore ku fokusohen audituesit e brendshëm është "kontrolli" i kontrollit të brendshëm, pra objektivi kryesor i këtyre profesionistëve është vlerësimi dhe përmirësimi i efektivitetit dhe efiçencës së kontrollit të brendshëm në organizatë. Me rritjen e kompleksitetit

të shoqërive dhe botës së biznesit ku ato operonin, auditimi i brendshëm fitoi një rëndësi edhe më të madhe (Institute of internal Auditors, 2005, fq. 1). Gjithsesi, shumica e përkufizimeve dhe nocioneve që lidhen me kontrollin e brendshëm janë përcaktuar nga organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në mbarë botën.

Organizatat e para që iu nënshtruan kontrollit të brendshme ishin institucionet financiare. Ndërmarrjet e tjera fillimisht nuk ishin subjekt i kërkesave të rregullatorëve për mekanizmat e kontrollit të brendshëm që duheshin implementuar. Për këtë arsye ato gradualisht përcaktuan në mënyrë të pavarur mekanizmat më të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm (sipas këndvështrimeve të tyre), pa pasur një referencë apo kuadër të standardizuar. Kjo situatë vijoi deri në fillimin e viteve 90 të shekullit të kaluar kur fillimisht në SHBA e më pas në Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar u publikuan kuadro rregullatore mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm.

Pavarësisht se më vonë edhe vende të tjera punuan në drejtim të standardizimit të aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, nga shqyrtimi i literaturës del se kuadri rregullator referencë më i shfrytëzuar në rang global është dokumenti i vitit 1992 i publikuar nga COSO në SHBA dhe i titulluar *Kuadri i Kontrollit të Brendshëm të Integruar*. Ky dokument është rishikuar dhe zgjeruar në vitin 2000 dhe pritet të ketë një rifreskim tjetër në fillim të vitit 2013 pas komenteve dhe sugjerimeve të mbledhura nga profesionistë në mbarë botën gjatë dy viteve të fundit (www.coso.org). Aktualisht dokumenti i COSO njihet botërisht si udhëzues mbi aspektet kritike të qeverisjes së organizatave, etikës së biznesit, menaxhimit të riskut të ndërmarrjes, mashtrimit dhe raportimit financiar. Qëllimi i COSO është të prezantojë një kuadër i cili lejon një kuptim të përbashkët të kontrollit të brendshëm mes palëve të interesuara. Në të specifikohen kritere dhe mjete kontrolli të cilat mund të ndihmojnë menaxherët që të vlerësojnë kontrollin e brendshëm dhe ta përmirësojnë atë. COSO ofron gjithashtu edhe udhëzime mbi përgatitjen e raporteve të kontrollit të brendshëm për përdorim nga palë të jashtme.

Meqenëse dokumenti i COSO është më i referuari dhe më i cituari, në këtë punim në do mbështetemi pikërisht në përkufizimin e dhënë nga COSO mbi kontrollin e brendshëm: “një proces i ndikuar nga bordi drejtues i njësisë ekonomike, administratori i saj apo të tjerë të punësuar, i cili është dizenjuar që të japë një siguri të arsyeshme në lidhje me arritjet e objektivave për efektivitet dhe efiçencë të operacioneve, besueshmëri të raportimit financiar dhe përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme (COSO, 1992, fq.2).

Përkufizimet e COSO mbi kontrollin e brendshëm janë konsideruar në vitet e fundit edhe nga IFAC e cila ka publikuar disa rekomandime për zgjerimin apo rishikimin e dokumentit udhëzues mbi riskun e ndërmarrjes dhe kontrollit të brendshëm. Në përgjithësi standardizimi i udhëzimeve mbi kontrollin e brendshëm në rang global

është një proces ende në zhvillim e sipër.

Kontrolle të brendshme efektive për NVM-të

Në pjesën e parë ky punim u fokusua në historikun e zhvillimit të kontrollit të brendshëm, si edhe në konceptet dhe elementet më kryesore të tij. Në këtë pjesë të punimit do të vijohet me eksplorimin e objektivave të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm. Fokusi do të jenë përbërësit kryesorë të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe parimet bazë ku mbështeten këto elemente përbërës.

Kontrolle të brendshme efektive

Kontroll i brendshëm efektiv konsiderohet ai sistem i kontrollit të brendshëm në të cilin dizenjimi, funksionet dhe programet e kontrollit arrijnë rezultatet e dëshiruara (Aldridge & Colbert, 1994, fq. 21). Megjithëse sistemet e kontrollit të brendshëm operojnë në nivele të ndryshme efektiviteti, një sistem i kontrollit të brendshëm konsiderohet efektiv atëherë kur ai plotëson atributet e mëposhtme kyçe:

1. Ambient kontrolli i përshtatshëm.
2. Proces të përshtatshëm të vlerësimit të riskut.
3. Aktivitete kontrolli operative të përshtatshme.
4. Sisteme efektive komunikimi dhe informacioni.
5. Sisteme efektive vlerësimi dhe monitorimi.

Të pesë elemente të ndërlidhura me njëra-tjetrën duhet të jenë prezent në mënyrë që të konkludohet se kontrolli i brendshëm është efektiv. Nga ana tjetër, tre objektivat kryesore të kontrollit të brendshëm të gjithë-pranuara në literaturë të cilat duhet të ndiqen që të ketë sistem efektiv kontrolli të brendshëm janë: Besueshmëria e Raportimit Financiar; Efiçenca dhe Efektiviteti i Operacioneve; dhe Përputhshmëria me Ligjet dhe Rregulloret (COSO, 1992, fq.1).

Me *besueshmëri të raportimit financiar* nënkuptohet përgatitja e pasqyrave financiare të publikuara të besueshme. Raporti vjetor përfshin pasqyra financiare të ndërmjetme dhe të përmbledhura. Besueshmëria i referohet cilësisë së informacionit, pra faktit se ky informacion nuk ka gabime materiale në të. Kjo lloj sigurie është e domosdoshme dhe mundësohet brenda një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm (Bushman, 2007, fq.1).

Efiçenca dhe efektiviteti i operacioneve lidhen me performancën dhe përfitueshmërinë e një njësie ekonomike. Këto qëllime si edhe ruajtja e burimeve të njësisë përbëjnë objektivat madhorë të operacioneve efiçente dhe efektive. Kjo nënkupton se operacionet kryhen në mënyrë të tillë që të arrijnë efektin e synuar prej tyre dhe ky lloj kontrolli duhet të kryhet një herë në tre muaj ose dy herë në vit. (Bushman, 2007, fq.2).

Përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret i referohet kuadrit ligjor dhe rregullative të cilit i nënshtrohet ndërmarrja. Para së gjithash ndërmarrja duhet të njohë mirë të gjitha ligjet dhe rregulloret të cilave u nënshtrohet si p.sh, standardet kontabël, ligjet e vendit si edhe ligjet e BE-së, rregullat e

qeverisjes së korporatave dhe rregulla të tjera specifike (Bushman, 2007, fq.3)

Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë politika dhe procedura që i ndihmojnë drejtuesit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të arrijnë objektivat e tyre. Këto aktivitete janë veprime të nevojshme që duhet të ndërmerren në mënyrë që të adresohen risqet e identifikuara me reagime konkrete. Aktivitetet e kontrollit ndodhin në të gjitha nivelet dhe funksionet e njësisë ekonomike, qoftë kjo ndërmarrje e madhe apo biznes i vogël. Sipas Sampson (1999) aktivitete kryesore të kontrollit në një biznes të vogël janë përqendrimi i lartë i funksioneve vendim-marrëse, kontrolle të zgjeruara mbi personelin dhe mënyra direkte komunikimi.

Kontrollet mund të jenë parandaluese ose zbuluese në varësi të qëllimit të tyre. Kontrollet parandaluese synojnë parandalimin e ndodhjes së gabimeve apo mashtrimeve kurse kontrollet zbuluese synojnë të diktojnë gabime tashmë të ndodhura. Të dyja këto kontrolle duhet të pasohen nga kontrolle korrigjuese në mënyrë që njësia të reflektojë ndryshimet e nevojshme. Kontrollet parandaluese më të njohura janë ndarja e detyrave, autorizimi i veprimeve, dokumentimi i plotë i transaksioneve dhe kontrolli fizik mbi aktivet (Sampson, 1999, fq.9). Nga ana tjetër kontrollet më të zakonshme zbuluese janë rishikimet, analizat, kontrollet e shmangieve, rakordimet, inventarët fizike, kontrollet surprizë të arkës dhe auditimet.

Pavarësisht se bizneset e vogla kanë një madhësi të tillë që nuk lejojnë ndarje të mirëfilltë të detyrave duhet të bëhet një përpjekje për të ndarë të paktën funksionin autorizues dhe miratues të një transaksioni nga funksioni i kryerjes së tij në praktikë. Një tjetër aktivitet kontrolli efektiv për bizneset e vogla duket se është edhe rakordimi periodik i llogarive dhe gjendjes fizike qoftë të inventarit, qoftë të vlerave monetare në arkë (këto të dyja përbëjnë edhe elementet kryesore pasurore të një biznesi të vogël). Në çdo rast aktivitetet e kontrollit duhet të shoqërohen me masa ndëshkimore të përshtatshme në mënyrë që të jenë efektive dhe të luajnë rolin e tyre në ndërgjegjësimin e personelit. P.sh, mungesat në arkë mund tu ngarkohen arkëtarëve në rastin kur verifikohen të tilla.

Një tjetër aktivitet kontrolli që mund të implementohet në bizneset e vogla është edhe shqyrtimi i performancës. Madje mund të vendosen edhe standarde kundrejt të cilës mund të shqyrtohet performanca e punonjësve apo segmenteve. Çfarë mund të funksionojë më së miri në bizneset e vogla, madje shumë më tepër se në bizneset e mëdha janë kontrollet e personelit. Njohja informale me punonjësit dhe mbikëqyrja nga afër në ambientet e punës janë kontrolle të cilat implementohen fare mirë në kushtet e një biznesi të vogël.

Kontrolli fizik mbi aktivet gjithashtu është një element kontrolli i cili mund të implementohet më së miri në një ndërmarrje të vogël apo të mesme. Aksesi në këto aktive mund të kufizohet vetëm në një numër të kufizuar punonjësish, ose aktivet më të rëndësishme mund t'i lihen në ngarkim

punonjësve përgjegjës për operimin e tyre.

Në bizneset e vogla me rëndësi prioritare janë edhe sistemet e komunikimit dhe informimit. Në mënyrë që kontrollet e brendshme të jenë efektive, informacioni i rëndësishëm mbi aktivitetet e shoqërisë duhet të regjistrohet dhe përcillet në një trajtë të tillë që t'i lejojë punonjësit të përmbushin përgjegjësitë e pritura prej tyre. Punonjësit, edhe në bizneset e vogla, duhet të informohen se çfarë pritet prej tyre të kryejnë, çka mund të përmirësojë performancën e tyre. Raportet informative përgatiten nga sistemet e informacionit të cilat janë specifike për bizneset e vogla dhe duhet të marrin në konsideratë nevojat e tyre. Kohët e fundit standardizimi i sistemeve të informacionit të përdorura nga bizneset e vogla ka sjellë edhe një standardizim të kontrolleve mbi këto sisteme informacioni (IIA, 2005, fq.16).

Sipas vrojtimit të kryer nga IFAC mbi elementet më të përdorura të kontrolleve të brendshme pesë aktivitetet e mëposhtme u identifikuan si më kryesoret:

1. *Ndërgjegjësimi nga ana e drejtuesve kryesorë mbi rëndësinë e kontrolleve të brendshme*. Menaxherët e lartë të NVM-ve identifikuan se ndërgjegjësimi i tyre mbi rëndësinë e kontrolleve të brendshme në operacionet e ndërmarrjes kushtëzon në mënyrë domethënëse suksesin e implementimit të një sistemi efektiv kontrolli të brendshëm. Gjithsesi shkalla e ndërgjegjësimit të drejtuesve varion nga një ndërmarrje në tjetrën, në varësi të përgatitjes dhe formimit të çdo drejtuesi.

2. *Përdorimi i sistemeve kompjuterike*. Drejtuesit e NVM-ve theksojnë rëndësinë e madhe që kanë aplikacionet kompjuterike në marrjen e vendimeve si edhe mbështetjen e lartë që ata kanë në këto aplikacione. Sistemet e informacionit përdoren prej tyre edhe si mjete kontrolli të operacioneve të përditshme si p.sh, ecuria e shitjeve sipas pikave të shitjes apo sipas agjentëve të shitjes. Madje shumë prej tyre u cituan të deklarojnë se mbështetja që ata kanë në sistemet e informacionit zëvendëson madje edhe funksionin e auditimit të brendshëm duke qenë se ata i përdorin këto sisteme për të "audituar" apo rakorduar transaksione të ndryshme (fatura shitje me fletë dalje apo mandat pagesa me derdhje në bankë).

3. *Niveli i autoritetit dhe përgjegjësisë*. Duke qenë se NVM-të kanë një numër të vogël punonjësish shpesh aludohet se ndarja e detyrave është e pamundur. Megjithatë vrojtimi nxori në pah se ekziston një nivel jo shumë i sofistikuar i ndarjes së detyrave si edhe shpesh ky aktivitet kontrolli zëvendësohet nga kontrolli mbi tepricat financiare.

4. *Kundërpërgjigja ndaj riskut*. NVM-të janë të ndërgjegjshme për risqet e brendshme që shoqërojnë aktivitetet e biznesit të tyre. Aktivitetet e kontrollit të përshkruara më lart janë pikërisht masa për t'iu kundërpërgjigjur risqeve të brendshme. Por drejtuesit e NVM-ve identifikojnë si risk të jashtëm shumë evident edhe shitjet me kredi. Për t'iu kundërpërgjigjur këtij risku këto NVM kanë krijuar mekanizma të tillë si shqyrtimi paraprak i klientëve, dhënia e të drejtës së shitjes me kredi vetëm për pak klientë të privilegjuar, ndjekjen me

kujdes të pagesave të vonuara nga klientët, bashkëpunimi i ngushtë me përfaqësuesit e shitjeve në terren, etj.

5. *Politikat e burimeve njerëzore dhe kodet e sjelljes dhe etikës*. Pavarësisht se NVM-të nuk zhvillojnë një politikë të mirëfilltë për burimet njerëzore të tyre, ato gjithsesi kanë një kod të përgjithshëm sjelljeje i cili reflekton orientimin e përgjithshëm të ndërmarrjes dhe shërben nga ana tjetër edhe si mekanizëm kontrolli.

6. *Komunikimi*. Pavarësisht se një NVM është e vogël krahasuar me shoqëri të mëdha ekzistojnë disa nivele komunikimi brenda saj si edhe mes saj dhe palëve të tjera.

Gjetjet kryesore dhe konkluzionet

Hyrje

Ky punim u fokusua në kontrollet e brendshme efektive dhe aplikimin e tyre specifik në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Nga shqyrtimi i literaturës u nxor në pah që jo vetëm në Shqipëri por edhe për vendet e zhvilluara mungojnë studimet e kësaj fushe. NVM-të bëhen objekt i shpeshtë studimi në lidhje me zhvillimin e tyre, qasjen në burimet e financimit por jo në lidhje me kuadrin e kontrollit të brendshëm që aplikojnë. Ndërkohë duke qenë se ato karakterizohen nga një nivel i lartë besimi në kryerjen e aktiviteteve (besim shpesh jo i justifikuar) bien pre e mashtrimeve dhe përvetësimeve që i çojnë pashmangshmërisht drejt falimentimit. Ekzistenca e kontrollit të brendshëm efektiv mund të kufizojë mangësitë në drejtimin e tyre dhe padyshim që rrit shanset për sukses. Nga ana tjetër, punimet kërkimore dhe shkencore që trajtojnë kontrollet e brendshme i shohin ato përherë në kontekstin e shoqërive të mëdha apo të korporatave dhe nuk trajtojnë aplikimin e tyre në NVM. Për këto arsye, si edhe mbështetur në rëndësinë e pamohueshme që kanë NVM-të për ekonominë e një vendi të vogël si Shqipëria, ky punim zgjodhi të fokusohej në një tematikë të tillë të re.

Përfundimet kryesore

Për të bërë një përmbledhje të përfundimeve kryesore po rendisim elementët e mëposhtëm si pikat kryesore për të pasur aktivitete efektive të kontrollit të brendshëm në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

• *Ambient i përshtatshëm kontrolli*
Përcaktimi i linjave të përgjegjësisë dhe autoritetit dhe nivelet e komunikimit janë me rëndësi për të përcaktuar tonalitetin e përgjithshëm të kontrollit në NVM.

• *Proçes i përshtatshëm i vlerësimit të riskut*
Vlerësimi i risqeve të brendshme si edhe të jashtme ka rëndësi për NVM-të. Ato duhet të shqyrtojnë risqet që rrjedhin nga operacionet e brendshme por edhe risqet që vijnë nga ndikimi i faktorëve të jashtëm.

• *Aktivitete kontrolli të përshtatshme*
Një NVM mbështetet në sistemet e kompjuterizuara të informacionit për të kryer një pjesë të kontrolleve të brendshme që lidhen me rakordimin e transaksioneve të përditshme, si edhe

me kontrollin e inventarëve dhe mjeteve monetare. Veç sistemit të informacionit, NVM-të përdorin edhe mbikëqyrjen direkte për punonjësit, njohjen informale të punonjësve dhe kontrollet e befasishme të arkës.

• *Sisteme efektive monitorimi dhe vlerësimi*

Në kushtet kur NVM-të nuk janë të detyruara me ligj t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm dhe as të kenë struktura të mirëfillta të auditimit të brendshëm. përgjegjësia për monitorimin e aktiviteteve dhe për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i takon drejtuesve të NVM-ve. Ata duhet të angazhohen në vlerësimin e performancës së punonjësve dhe të mendojnë për hapa korrigjuese të dëmeve të shkaktuara në shoqëri.

Si përmbledhje mund të thuhet se edhe vetë NVM-të janë të ndërgjegjshme për rëndësinë e kontrollit të brendshëm në garantimin e aktiviteteve efektive dhe efiçente, kësisoj ekzistenca e orientimeve dhe udhëzimeve për këto aktivitete kontrolli do të ishte me interes për këto ndërmarrje.

Kufizimet e këtij punimi

Gjetjet kryesore të këtij punimi nuk tentojnë të jenë ezauruese në vetvete dhe duke pasur në konsideratë trajtimin teorik që i është bërë problematikës në fjalë, ky punim vjen në trajtën e një eksplorimi të fushës së kontrolleve të brendshme në NVM. Kufizimet në trajtimin e këtij punimi mund të bëhen premisa të mira për kërkime të mëtejshme në fushën e kontrollit të brendshëm për NVM-të duke e pasuruar atë p.sh, me vrojtime empirike në terrenin e ekonomisë shqiptare në lidhje me aplikimet praktike të kontrollit të brendshëm nga ana e NVM-ve në Shqipëri; apo me një kuadër teorik edhe më të plotë të kategorizuar sipas sektorëve të ekonomisë si p.sh, ofruesit e shërbimeve të konsulencës, njësitë e hoteleri-turizmit, apo ofruesit e shërbimeve të riparimeve të ndryshme.

Dr.Rezarta Perri është pedagoge e Departamentit të Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës,
E-mail : rezarta.perri@unitir.edu.al
Msc.Linda Çepani është pedagoge e Departamentit të Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
E-mail: lindita.cepani@unitir.edu.al

LITERATURA

- AMF (Financial Markets Authority). (2005). The Internal Control System: Reference Framework. Website of the Institute of Internal Auditors. <www.theiia.org>
- Aldridge R & Colbert J. (1994). Report on Internal Control, and the Accountant's Response. *Managerial Auditing Journal*, 9, (7), 21-28, http://www.businessmagazines.com
- Bushman M. (2007). Designing an effective internal control system. Website of Associated Content. http://www.associatedcontent.com/user/38548/melissa_ bushman.htm
- lCOSO (Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission) (2009). Guidance in Monitoring Internal Control Systems. COSO website. http://www.coso.org. COSOMonitoringGuidanceFeb09Release_002
- European Commission (2003). Commission adopts a new definition of micro, small and medium sized enterprises in Europe. European Union Ëebsite. http://europa.eu/cgibin/etal.pl.
- Higson A. (2002), Indications of Fraud in SMEs, *Fraud Advisory Panel*, www.icaew.co.uk
- Institute of Internal Auditor (2005). "COSO's Theory in to Practice". *Tone at the Top*.Website of the Institute of Internal Auditor. www.theiia.org
- Sampson D. (1999). Understanding Internal Controls: A Reference Guide for Managing University Business Practices. University of California Website. http://www.ucop.edu/ctlacct/under-ic.pdf
- www.ifac.org.
- www.instat.gov.al
- www.minfin.gov.al

Auditimi i publik

Performanca imponuar nga standardet e auditimit

PERFORMANCA E AUDITIMIT NË SEKTORIN PUBLIK

"Unë nuk shoh shumë mënyra për të eliminuar lakminë; kjo është një pjesë e trashëguar e karakterit njerëzor. Kësisoj masat antimashtrim duhet të synojnë në edukimin e njerëzve mbi risqet dhe tipin e kontrolleve teknike që ata duhet të venë në jetë.".

Alan Oliphant

KASEM SEFERI

Pika e parë që duhet analizuar është ajo e diferencave të terminologjisë në lidhje me rrugëzgjidhjet e kontrollit të performancës në sektorin publik, për arsye se përdoren terma të ndryshëm në pjesë të ndryshme të botës dhe, shpesh, referenca bëhet për "vlerën e kontrollit të parasë" (VKP) dhe "kontrollit të performancës" në lidhje me shqyrtimet e përdorimit të burimeve nga organizatat e sektorit publik. Megjithëse kontrolli performancës nganjëherë mund të interpretohet si zgjatje përtej çështjeve të qarta të VKP (për shembull, për të përfshirë cilësinë dhe problemet teknike) termat përdoren në mënyrë këmbese nga shumë kontrollorë, prandaj për qëllimet e këtij trajtimi do të përdoret termi formal "auditim i performancës", i cili është adoptuar nga Standardet e Auditimit të INTOSAI – it.

Auditimi i performancës konsiderohet se është një prej mjeteve më efektive për përmirësimin e performancës dhe qeverisjes dhe, modeli i sistemeve të përmirësimit, të lejon të kesh një koncept të gjerë të efektivitetit të procesit të kontrollit, ndërsa zbatimi i

teorisë në praktikë, shpesh bëhet objekt i kërkimit shkencor, si dhe shpesh një temë e diskutimeve shkencore.

Problemet e zhvillimit të auditimit të performancës janë analizuar nga një numër shumë i madh kërkuesish dhe, problemi shkencor që këmbëngul në kushtin e modeleve korente, nuk përputhet me nevojat praktike korente, për arsye se nuk i ka investiguar mjaft arsyet, që do t'a bënin të mundur realizimin e saktë të një sëre objektivash të përbërë nga objektivat e dëshmuar nga shumë kërkime; në këtë aspekt, qëllimi i kërkimeve ka qenë zhvillimi modelit të sistemit të auditimit të performancës me objekt auditimin e performancës me anë të përdorimit të metodave të analizës sistematike, të logjikës dhe të sintezës.

Niveli i objektivave të integruar përbëhet si vijon: vlerësimi i performancës së modeleve të procesit të auditimit me anë të identifikimit të avantazheve dhe disavantazheve të tyre, vlerësimi i mundësive të zbatimit të kontrollit të orientuar në sistem në praktikën e procesit të kontrollit. Për të arritur këto qëllime, janë analizuar rezultatet e studimeve në kontroll, menaxhim dhe administrim, ligj si dhe fusha të tjera, ndërsa në aspektet teorike të zhvillimit të modeleve të procesit të kontrollit të performancës, studiuesit kanë analizuar literaturë dhe studime të ndryshme dhe, veçanërisht, standardet dhe udhërrëfyesit për procesin e auditimit të performancës bazuar në Standardet e Kontrollit të INTOSAI – it, përvojën praktike si krahasimin e tyre ashtu dhe sintezën.

Auditimi, i krijuar fillimisht si një funksion i orientuar kontabël, është transformuar në profesion të orientuar menaxhimi dhe, në ditët e sotme, auditimi i performancës shihet si një profesion i pavarur, që po luan një rol domethënës në menaxhimin e organizatave dhe politikës së shteteve, gjë që ka bërë që fusha e veprimit të funksioneve të auditimit të performancës dhe rolet të ndryshojnë dhe të zhvillohen nga vitit në vit dhe, pak a shumë, mund të bëhen pretendimet të besueshme në lidhje me performancën e kontrollit njësoj si veprimtaritë e viteve 1960 – të ose gjatë kohës së më të hershme. Auditimi i performancës, si shkallë e gjerë e praktikës së dalluar në mënyrë të ndërgjegjshme vetjake, daton që nga koha e viteve të fundit 1970 – të dhe, veçanërisht, ai u përhap gjerësisht në vitet 1980 – të për shkak të numrit të faktorëve që vijojnë: (i) fushës së zgjeruar në mënyrë të shumanshme të veprimit të veprimtarive të qeverisë: nga funksioni i thjeshtë i ligjit dhe rregullit si dhe administrimit të drejtësisë, pjesa më e madhe e qeverive tashmë janë angazhuar për të luajtur një rol aktiv në zhvillimin ekonomiko – shoqëror, gjë që ka rritur shumë madhësinë e shpenzimeve publike; (ii) ka pretendime konkurruese për caktimin e burimit, për arsye se mungesa e burimeve kërkon një vendim – marrje më të arsyeshme dhe informuese mbi shpenzimet publike, si dhe ka një nxitje për marrjen e vlerës së plotë nga paraja që po harxhohet; (iii) është rritur gjithashtu zhvillimi i institucioneve demokratike, ndërgjegjja e publikut dhe përfaqësuesve të saj, si dhe ka një kërkesë të rritur për

përgjegjshmëri të atyre që menaxhojnë burimet publike; (iv) nevojës për të menaxhuar riskun e detyrimit civil; (v) mundësitë për të rritur fitimet e efiçencës nëpërmjet sistemeve të përmirësuara të menaxhimit të brendshëm, etj.

Në këtë mënyrë, ashtu sikundër programet e qeverive vazhdojnë e rriten në staturë, ashtu ka evoluar dhe e ka zgjeruar fushën e tij të veprimit procesi i auditimit të sektorit publik, përtej kontrolleve thjesht financiare ose të zbatimit të ligjit duke kaluar në procesin e kontrollit të performancës për t'i mbështetur politikëbërësit që të luajnë rolin e tyre mbikëqyrës.

Auditimi i performancës është përkufizuar në mënyra të ndryshme; për shembull Standardet e Kontrollit të INTOSAI – it deklarojnë si vijon: "Procesi i auditimit të performancës lidhet me kontrollin e ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit dhe rrok: (a) kontrollin e ekonomisë për veprimtaritë administrative në lidhje me praktikat dhe parimet e shëndosha administrative dhe politikat e menaxhimit; (b) kontrollin e efiçencës së dobisë së burimeve njerëzore, financiare dhe të tjerë, që përfshin shqyrtimin e sistemeve të informacionit, matjen e performancës dhe monitorimin e përgatitjeve dhe procedurave e ndjekura nga entitetet e kontrolluara për rregullimin e të metave të identifikuara; dhe (c) kontrollin e efektivitetit të performancës në lidhje me arritjen e objektivitetit të entitetit të kontrolluar dhe kontrollin e ndikimit aktual të veprimtarive të krahasuara me ndikimin e qëlluar.".

Në literaturën shkencore auditimi i performancës përkufizohet gjithashtu në mënyra të ndryshme; për shembull: "Procesi i auditimit të performancës është një vlerësim sistematik objektiv në lidhje me procesin e përcaktimit të efektivitetit, ekonomisë, ose efiçencës së tij.".

Ky përkufizim, bashkë me rekomandimet për përmirësim, raportohet për menaxherët, ministrat dhe legjislatorët, që janë përgjegjës për shpalljen e rekomandimeve ose sigurimin e përgjegjshmërisë për veprim shtrëngues; pra, si rrjedhim procesi i kontrollit të performancës është një mjet i rëndësishëm që krijon kushtet për të përmirësuar të përgjegjshmen dhe ndihmën për të krijuar qeverisje që jep përgjigje në lidhje me burimet publike.

Studiuesit argumentojnë se çdo sistem i përgjegjshmërisë publike duhet të rrokë elementët bazë që vijojnë: çdo akt ose veprim bëhet hapur sipas ligjit dhe gjykimit të matur; çdo aktor është përgjegjës për veprimin e tij; çdo akt dokumentohet dhe raportohet publikisht; çdo akt ose veprim është subjekt për rishikimin e kontrollit jo partizan të pavarur dhe profesional tregon se është bërë gabim i qëllimshëm dhe merret veprimi i menjëhershëm korrigjues, që përfshin ndëshkimin atje ku është e përshtatshëm.

Në këtë mënyrë, synimi i auditimit të performancës duhet të vlerësojë performancën e entitetit të kontrolluar dhe menaxhimin në lidhje me ekonominë, efiçencën dhe efektivitetin, si dhe për të siguruar rekomandime mbi

atë si të përmirësohet performanca e entitetit të përmendur.

Në literaturën shkencore prezantohen modele të ndryshme menaxhimi, gjë që kërkon analizën e mjeteve të përbashkëta për menaxherët publik dhe kontrollorët e performancës publike gjithashtu dhe shqyrtimin e modelit logjik të programit.

Procesi i auditimit të performancës funksionon me të njëjtët koncepte të menaxhimit të performancës të përdorur nga menaxherët e programit dhe drejtuesit e tyre: për të planifikuar, monitoruar dhe vlerësuar si përdoren burimet publike për të arritur objektivat e politikës publike; konceptet e inputeve, proceseve, punëve të dobishme dhe rezultateve përfundimtare (vlerësimit nga jashtë) dhe ndikimit, si dhe bashkëlidhjes së tyre me qëllimet e mësipërme të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit, janë mjete të përbashkëta për menaxherët publik dhe kontrollorët e performancës publike.

Në thelb, efiçenca tregon sa mirë i përdor një organizatë burimet e saj për të prodhuar mallra dhe shërbime dhe, në këtë mënyrë, ajo fokusohet mbi burimet (inputet), mallrat dhe shërbimet (punët e dobishme) dhe përqindjen (produktivitetin) me të cilin përdoren për të prodhuar ose dorëzuar punët e dobishme. Dimensionet e punës së dobishme përfshijnë sasinë dhe cilësinë dhe punët e dobishme dorëzohen te klientët e jashtëm dhe të brendshëm brenda parametrave që lidhen me nivelin e shërbimit; sasia i referohet masës, volumit, ose numrit të punës së dobishme të prodhuar, ndërsa cilësia i referohet atributeve të ndryshme dhe karakteristikave të punëve të dobishme të tilla si besueshmëria, saktësia, respektimi afateve kohore, kortezia e shërbimit (etika) siguria dhe komoditetit.

Megjithatë, ashtu sikundër procesi i auditimit të performancës përfaqëson një vlerësim të proceseve të menaxhimit të performancës publike, ai përdor një sërë konceptesh shtesë që përshkruajnë proceset e tyre përbërës dhe punët e dobishme dhe kyç te kjo gjuhë është koncepti i procesit të gjetjes së kontrollit dhe elementëve të tij përbërës.

Në këtë mënyrë, përbërësi themelor i auditimit të performancës është procesi i gjetjeve të kontrollit që bëhet prej elementëve standart, që përfshijnë kriteret, kushtet, efektet dhe shkaqet; struktura e procesit të gjetjes së kontrollit përcaktohet nga objektivi i tij i kontrollit (hulumtimi kyç që ka nevojë për përgjigje) dhe modeli mbi të cilin ndërtohet auditimi duke përdorur këto elemente.

Kriteret, përfaqësojnë idealin kundrejt të cilit do të matet performanca aktuale që mund të përfshijnë parashikimet, standartet, praktikat, politikat, modele të caktuara, qëllimet e programit, ose perfomancën mesatare në institucione ose programe të njëjtë. Në hartimin e metodave të punës në vend, kontrollorët hartojnë mbledhjen e të dhënave dhe procedurat e analizës për të arritur objektivat e kontrollit. Kriteret mund të vendosen me anë të modeleve të caktuar me programe të

krahasueshme, që nxjerrin në dritë kërkesat ose parashikimet e klientit, që përcaktojnë qëllimin e programit, që identifikojnë nga brenda shënjestrat e vendosuar, që krahasojnë njësitë e krahasueshme brenda së njëjtës organizatë, që lokalizojnë standardet e industrisë ose sektorit, që krahasohen me prirjet historike, që identifikojnë performancën optimale ose mesatare të arritur në një prirje, që krahasojnë kohën e procesit të punës me kohën e kaluar aktuale, ose që krahason ndërhyrjen e performancës së grupit me atë të grupit të kontrollit.

Përfundimisht, pavarësisht natyrës së tij (politikës, programit të projektit, matjes), një ndërhyrje publike mund të analizohet si një sërë burimesh financiare, organizative dhe njerëzore të mobilizuara për të arritur, në një periudhë të dhënë kohe, një objektiv ose sërë objektivash, me synimin e zgjidhjes ose kapërcimit të një problemi ose vështirësie që ndikon grupet e shënjestruar; përdorimi i modeleve logjik mund të ndihmojë kontrollin për të identifikuar dhe vendosur marrëdhënie ndërmjet nevojave ekonomiko – shoqërore që duhen adresuar nga ndërhyrja dhe objektivat, inputet, proceset, punët e dobishme, rezultatet përfundimtare, të cilat përfshijnë rezultatet.

Teorikisht, kjo duhet të jetë e mundshme për auditimet e performancës për të shqyrtuar të gjithë përbërësit dhe marrëdhëniet në modele të tillë, me anë të fokusimit mbi ekonominë, efiçencën dhe efektivitetin; kontrollet e performancës mund të kombinojnë rrugëzgjidhje të ndryshme me theks të ndryshëm mbi njërin ose tjetrin që varet nga rrethanat e veçanta.

Rrugëzgjidhja në mënyrë direkte e performancës fokusohet në mënyrë direkte mbi performancën e arritur dhe përqendrohet mbi inputet, punët e dobishme, rezultatet dhe ndikimet, të qenit e hamendjes se, në qoftë se performanca e arritur është e kënaqshme, ka një risk të vogël të problemeve serioze që janë të pranishëm në hartimin ose vënien në jetë të veprimtarisë ose sistemeve të kontrollit; për shembull, auditime të tillë mund të vlerësojnë nëse politikat e adoptuara janë vënë në jetë në mënyrë të përshtatshme dhe nëse ato kanë arritur objektivat e qëlluar ose nëse ka pasoja të padëshirueshme të vendimeve politike të marrë.

Shqyrtimi në mënyrë direkte i performancës mund të përshtatet atje ku ka kritere të përshtatshëm për të matur sasinë, cilësinë dhe koston e inputeve, punëve të dobishme, rezultateve dhe ndikimeve, ndërsa atje ku performanca e arritur shihet se është e kënaqshme, atëherë veprimtaria dhe sistemet e auditimit shqyrtohen në shkallën e domosdoshme për të identifikuar shkaqet lidhëse.

Rrugëzgjidhja e sistemeve të kontrollit të procesit të auditimit hartohet për të përcaktuar nëse entitetet e kontrolluara kanë hartuar dhe vënë jetë sistemet e menaxhimit dhe monitorimit me qëllim që të optimizojnë ekonominë, efiçencën dhe efektivitetin brenda kufizimeve të dhëna. Puna e kontrollit do të përfshijë analizimin, rishikimin dhe testimin e përbërësve kyç të sistemeve të tillë. Shqyrtimi shpesh do të konsiderojë

nëse masat e zgjedhura janë të qëndrueshme me objektivat e politikës dhe nëse këto të fundit fare janë përkthyer në plane operacionale që përmbajnë objektiva, arritja e të cilëve matet hap pas hapi.

Kjo rrugëzgjidhje do të konsiderojë gjithashtu nëse sistemet në veprim prodhojnë informacion të përshtatshëm, të besueshëm dhe kohor mbi zhvillimin e burimeve financiare, njerëzore dhe të tjera (inputet), kryerja e veprimtarive (proceseve) dhe dorëzimi i punëve të dobishme të cilat duhet të krahasohen me objektivat operacional me mënyrën e treguesve të performancës. Kjo do të shqyrtojë nëse kur dalin mospërputhje, merren veprime të përshtatshme në kohën e duhur të veprimit rregullues për të korigjuar planin operacional, zhvendosjen e burimeve dhe/ose kryerjen e veprimtarive. Kjo rrugëzgjidhje do të përfshijë shpesh shqyrtimin e sistemit të vlerësimit dhe informacionin me qëllim që të vlerësojnë cilësinë e tyre dhe, kur janë të konsideruar të kënaqshëm dhe të përshtatshëm me objektivat e kontrollit, për të përdorur si dëshmi kontrolli gjetjet e vlerësimit, përfundimet dhe rekomandimet.

Të gjithë metodat e auditimit që përdorin organizata të ndryshme konvergojnë rreth konceptit të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit dhe lidhjeve të tyre; efiçenca është një prej objektivave më të ndërlikuar të procesit të kontrollit të performancës, një koncept relativ që matet me anë të krahasimit të produktivitetit të arritur me normën e dëshiruar, shënjestrën ose standardin; për shembull, sasia e punës së dobishme dhe cilësia e arritur, si dhe niveli i shërbimit të siguruar krahasohen gjithashtu me shënjestrat ose standardet për të përcaktuar se në çfarë shkalle ata mund të shkaktuar ndryshime në efiçencë; pra, mund të thuhet se efiçenca përmirësohet kur bëhen më shumë punë të dobishme të një cilësie të dhënë me të njëjtët ose më pak inpute të burimit, ose kur bëhet e njëjta masë e punës së dobishme me më pak burime.

Efiçenca rrjedh nga marrëdhënia ndërmjet inputeve të burimit dhe punëve të dobishme dhe, kuptohet, se konceptet e efiçencës dhe të ekonomisë lidhen në mënyrë të pazgjidhshme, ndërsa marrja ekonomike e burimeve kontribuon për efiçencën me anë të minimizimit të kostos së inputeve të përdorura për qëllime të punëve të dobishme.

Për të identifikuar çështjet potenciale të efiçencës shërben për:

- arsyeshmërinë e informacionit mbi arritjen e efiçencës e raportuar brenda dhe nga organizata (volume i punës së dobishme, cilësi dhe nivele shërbimi, dobia e stafit, pajisja ose mjetet, ose koston e njësisë së punëve të dobishme);
- ankesat e klientit rreth ndonjë aspekti të shërbimit;
- prirjet në nivelet e burimit të krahasuara me ngarkesën e punës gjatë pak viteve të kaluar;
- përshtatshmëria e struktures organizative për të shmangur dublimin e funksioneve, mbështetësve të panevojshëm të menaxhimit dhe

mospërdorjes së funksioneve të përgjithshme;

- puna e pabërë, mungesshmëria, mbikoha dhe shërbimi kontraktuar;
- mundësitë për të përmirësuar efiçencën, të tillë si përdorimi i kompjuterave dhe teknologjisë tjetër;
- arsyeshmëria e përdorimit të burimit (për shembull, materialet, energjia, etj).

Kur objektivi i auditimit të efiçencës konsideron punët e dobishme, atij shpesh i nevojitet të shqyrtojë proceset me të cilët një organizatë transformon inputet në punë të dobishme, gjë që tregon se vlerësimi mund të përfshijë llogaritjen e kostos për njësi të punëve të dobishme të prodhuar ose raportet e efiçencës së punës dhe krahasimi i tyre me kriteret e pranuara, të cilët mund të rrjedhin nga organizata të njëjta, periudhat e mëparshme ose standardet dhe/ose rezultatet të cilët entiteti i kontrolluar i ka adoptuar në mënyrë të detajuar. Kur objektivi i auditimit të efiçencës rrok rezultatet, mjetet ekonomik zakonisht janë të domosdoshëm për të vlerësuar aftësinë ose potencialin e entitetit të kontrolluar, operimin ose programin për të arritur disa rezultate me një kosto të dhënë. Si shembull, mund të përdoret analiza kosto/efektivitet për të lidhur efektet neto të ndërhyrjes me inputet financiare të nevojshme për të prodhuar këto efekte; për shembull, kriteret e gjykimit mund të ishin kosto për njësi e rezultatit të prodhuar, e cila më pas krahasohet me atë të ndërhyrjeve të tjera të zgjedhura si modele praktike; varësia nga rrugëzgjidhja e kontrollit, tregon se audituesit ose do të shqyrtojnë besueshmërinë e analizës së kryer nga organizmi i auditimit, ose ta kryejnë vetë një analizë të tillë.

Çështjet e efektivitetit mbivendosen dhe zgjerohen përtej efiçencës në efektet e programit dhe ndikimet (rezultatet përfundimtare të matur nga opinionet e jashtme) e lidhin ngushtësisht efiçencën me efektivitetin për arsye se ky është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e metodës së kostos së vogël për arritjen e rezultateve të dëshiruara përfundimtare.

Çështjet e efektivitetit ngrihen kur një entitet ose ndërhyrje nuk prodhon punët e dobishme të parashikuara, rezultatet ose ndikimet dhe prandaj, në këtë mënyrë, kontrolli i efektivitetit do të përqendrohet mbi punët e dobishme, rezultatet ose ndikimet.

Vlerësimi i ndikimit është i vështirë, për arsye se ka vështirësi të konsiderueshme në vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjes; për shembull, shkalla me të cilën janë arritur objektivat global dhe madje ndërmjetësit e kësaj ndërhyrje dhe vështirësia ngrihet për arsye se objektivat zakonisht shprehen në terma të tillë të gjërë, gjë që bën të mundur që ato të mos mund të shoqërohen me tregues të matshëm.

Shpesh, një objektiv më i qëndrueshëm i auditimit do të jetë ai për të vlerësuar punët e dobishme ose rezultatet e një ndërhyrje; për shembull, shkalla me të cilën janë arritur objektivat operacional ose të menjëhershëm. Me kusht që objektivat të jenë të veçantë, të matshëm, të arritshëm, të përshtatshëm dhe në kohë, si dhe

arritja e tyre të monitorohet nga nga treguesit e performancës, gjë që ka të ngjarë të sigurojë një bazë reference të qartë dhe të përshtatshme për vlerësimin e efektivitetit.
Në këtë mënyrë kontrollorët duhet të identifikojnë risqet potenciale për arritjen e ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit, dhe, si rrjedhim, të zhvillojnë çështjet e kontrollit; kryesisht, secili koncept është i rëndësisë së barabartë dhe atje ku qëndron parësi e veçantë do të vendoset në bazë të rast pas rastit.

Kurdoherë që është e mundur audituesit inkurajohen që efektivitetin ta konsiderojnë një element të analizës.

Të sigurosh një kuadër teorik për një proces kontrolli me efektivitet është domethënëse për arsye se do t'i ndihmonte kontrollorët e performancës në përpjekjet e tyre për të analizuar dhe vlerësuar vënien në jetë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të qeverisë. Rrugëzgjidhja në procesin e kontrollit të performancës, ose i ashtuquajturi modeli synime dhe mjete për të vendosur mënyrat më të mira për të marrë drejtimet e duhura në zhvillimin procesit të kontrollit të efektivitetit, një përbërje e mirëarsyetuar e një objektivi të tillë kompleks është si vijon: për të përkufizuar formimin e një kombinimi të modelit synime dhe mjete, avantazhet dhe dizavantazhet e tyre, për të vlerësuar mundësitë e zbatimit të kontrollit të orientuar te sistemi në praktikën e procesit të kontrollit.

Me qëllim që të realizohet një objektiv i tillë sugjerohet që të përdoren metodat e bazuara mbi parimet që zbatohen në procesin e realizimit të objektivave të tjerë të procesit të kontrollit të performancës, si për shembull, modelin input – punë e dobishme.

Metodat bazohen mbi idetë dhe konceptet që rezultojnë nga "teoria sistem", atje ku ndërmarrjet ose programet e qeverisë shihen si sisteme të elementëve ndërveprues dhe funksional të ndërvarur; rregullat, burimet, organizmat e qeverisë, etj janë të gjithë shembuj të elementëve që përbëjnë një sistem të këtij tipi për një ndërmarrje të qeverisë. Fokusi është mbi efektivitetin e vetë sistemeve dhe konsiderohet parimi i analizës komplekse dhe vlerësimit, për sa i përket procesit të analizimit dhe vlerësimit të standardeve dhe udhërrëfyesve për procesin e kontrollit të performancës.

Elementët strukturorë të përkufizuar nga modeli sistem janë si vijon: prodhimi, administrimi, hartimi strukturor, mjedisi.

1)Prodhimi është thelbi i modelit sistem, për arsye se në të gjithë prodhimin e shërbimeve, prodhimi dhe konsumi ndodhin njëherazi dhe, në këtë mënyrë, klientët, stafi, metodat e punës dhe burimet janë të gjithë pjesë të sistemit të prodhimit.
2)Administrimi, ose përbërësi i dytë në model është funksion i sistemeve të administrimit për të caktuar burimet, për të planifikuar dhe vënë në jetë veprimtaritë, për të monitoruar dhe vlerësuar progresin etj, etj, kryesisht synimet në bërjen e tij më të lehtë për bashkërenduar dhe kontrolluar operimet e ndërmarrjeve të qeverisë.

Ssistemet e administrimit duhet të kontribuojnë për vënien efektive në jetë të ndërmarrjeve.
3)Hartimi strukturor formon një tjetër kuadër (rreth prodhimit dhe sistemeve administrative). Ndërmarrjet shoqërore dhe qëllimet politike të njëkohëshme nuk janë probleme për të vendosur vetëm për parlamentin dhe qeverinë. Çështje të tjera të rëndësishme janë struktura e organizimit ekzekutiv, rregullat dhe kuadri i buxheteve që drejtojnë operimet në sistemet e prodhimit.
4)Mjedisi, që përfundimisht mund të thuhet se ka një rol të rëndësishëm mbi mënyrën si vihet në jetë një ndërmarrje shoqërore.

Rekomandimet e dhëna për zhvillimin e procesit të auditimit të performancës në sektorin publik bazohen në kërkimin teorik të performancës të koncepteve të auditimit dhe modeleve, i cili ka arritur në përfundimet e mëposhtme:

- synimi i auditimit të performancës është për të vlerësuar performancën e një entiteti të kontrolluar dhe menaxhimin në lidhje me ekonominë, efiçencën dhe efektivitetin si dhe për të siguruar rekomandime mbi atë se si të përmirësohet performanca e entitetit në fjalë;
- konceptet e inputeve, proceseve, punëve të dobishme, rezultateve përfundimtare (të matura nga opinionet e jashtme), ndikimeve, si dhe lidhja e tyre me qëllimet e lartpërmendura të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit, janë mjete të përbashkëta për menaxherët publik dhe audituesit e performancës publike si të tillë;
- auditimet e performancës mund të kombinojnë performancën në mënyrë direkte dhe rrugëzgjidhjet e sisitemeve të kontrollit të procesit të kontrollit me thekse të ndryshëm, që duhet vënë mbi njërin ose tjetrin që varet nga rrethanat e veçanta;
- audituesit duhet të identifikojnë risqet potenciale për arritjen e ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit, si dhe për këtë arsye të zhvillojnë çështjet e kontrollit; secili koncept kryesisht është i një rëndësie të barabartë dhe atje ku vendoset parësi e veçantë do të vendoset rast pas rasti;
- audituesit inkurajohen të konsiderojnë efektivitetin si një element të analizës kurdoherë që është e mundshme:
  - o në procesin e auditimit të orientuar te sistemi, operimet në një fushë të caktuar të shoqërisë janë pika e nisjes dhe kjo shprehet duke lejuar një ndërmarrje të veçantë për të formuar bazën si për studim ashtu dhe për vlerësimin përfundimtar;
  - o në procesin e auditimit të orientuar te sistemi, fusha e veprimit të analizës përkufizohet në lidhje me "sistemin" që formohet nga vetë ndërmarrja dhe forcat/aktorët që ndikojnë realizimin e kësaj ndërmarrje;
  - o në procesin e auditimit të orientuar te sistemi, të dhënat mbi rezultatet përfundimtare (të matura nga opinionet e jashtme) përfshihen gjithnjë në bazë për analiza dhe vlerësime.

Auditimi i performancës është një mjet menaxhimi i përparuar që po bëhet gjithnjë e më shumë i sofistikuar me qëllim që rehatojë nevojat e komuniteteve të ndryshme dhe niveleve të qeverisë mbi shërbimet që radhiten nga siguria publike dhe punët publike deri te zhvillimi ekonomik dhe,

prandaj objekti i procesit të auditimit të performancës për entitetet përbërëse të strukturave të qeverisë, që bëjnë ndërmarrje të ndryshme, që përfshihen në mbledhjen e të ardhurave dhe shpenzimet e qeverisë, investimin e kapitalit njerëzor, konsumin e qeverisëdhe shpenzimet kapitale që kanë ndikim në rritjen ekonomike, synon rekomandimet e mëposhtme për qeverinë në lidhje me:

- monitorimin e qeverisë nga afër të procesit të dhënies së kontratave për projekte kapitale, për të parandaluar mbi vlerësimin e kostove të ekzekutimit, gjë që do të sillte një ndikim domethënës të shpenzimeve publike kapitale mbi rritjen ekonomike;
- kanalizimin efektiv të fondeve publike për veprimtari prodhuese, që do të kenë një ndikim domethënës në rritjen ekonomike;
- krijimin dhe funksionimin e një partnershipi ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat në sigurimin e shërbimeve thelbësore të infrastrukturës që do të promovonin rritjen ekonomike dhe zhvillimin;
- bashkërendimin e shpenzimeve të konsumit të qeverisë me të gjithë krahët e qeverisë për të parandaluar efektin e "daljes jashtë kontrollit" të investimeve të qeverisë;
- hartimin e politikave fiskale që nuk rrisin koston e zbatimit të legjislacionit tatimor, që rrisin arbitraritetin dhe nivelin e korrupsionit në administratën fiskale;
- shkallën e lartë të transparencës dhe përgjegjshmërisë mbi shpenzimet e qeverisë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë me qëllim që parandalojë kanalizimin e fondeve publike për llogari private të zyrtarëve të qeverisë.

Kasem Seferi është këshilltar për Ekonominë pranë Presidentit të Republikës.

LITERATURA

- Alan T. Peacock and Jack Wiseman, "The Growth of Public Expenditure in the United Kingdom"
- Barzelay, M. Central Audit Institutions and Performance Auditing: A Comparative Analysis of organizational Strategies in the OECD. International Journal of Policy, Administration and Institutions, Governance, Vol 10, No3, 1997;
- Corry D. "Public Expenditure: Effective Management and Control", the Dryden Press. London 1997;
- Raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën korrik 2007 – qershor 2012.

Auditimi publik

Auditimi dhe efektiviteti i enteve publike

AUDITIMI SI NJË FAKTOR NË RRITJEN EKONOMIKE

Pas viteve 90 Shqipëria hyri në rrugën e liberalizimit të ekonomisë dhe ju hap rrugë iniciativës së lirë, duke aplikuar sistemin ekonomik të moderuar kapitalist. Në fillimet e tij ky sistem u mirëprit nga publiku në tërësi duke krijuar unanimitet thuajse total në qëndrimin pozitiv ndaj tij. Me kalimin e viteve ky mendim filloi të lëkundet duke krijuar qëndrime kontradiktore ndaj këtij sistemi. Nostalgji të të kaluarës të nxitura dhe nga rudimente ideologjike politike forcuan këtë qëndrim negativ ndaj tij. Qëndrime që buronin dhe nga ndjesia se "shteti" nuk ekzistonte më dhe përkrahja ndaj popullsisë ishte venitur. Me kalimin e viteve dhe forcimin ekonomik të vendit këto qëndrime filluan të mos mbështeteshin. Stabilizimi i ekonomisë eci hap pas hapi me idenë e re se mbështetja nuk mund të gjendet në shtet, por në sektorin privat.

DR. EDVIN STEFANI

Shteti nuk ka pse të "mendoje" për gjithçka. Popullsia në tërësi është faktori për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e saj. Sidoqoftë roli i shtetit është ekzistent. Ai ka marrë rolin e ri të përgjegjësit për stimulimin dhe zhvillimin ekonomik. Në këtë aspekt ai ka përgjegjësinë kryesore të rialokimit të fondeve publike. Një rialokim i tillë ka vërtetuar se rrit mirëqenien totale të shoqërisë, duke plotësuar boshllëqet që tregu i lirë nuk mund të plotësojë. Në këtë aspekt e mira publike bashkekziston me të mirën private duke mos e

konkurruar njëkohësisht atë. Raporti midis të mirës publike dhe private përcaktohet kryesisht nga fazat e zhvillimit ekonomik të një vendi. Ajo çka nuk ndryshon është domosdoshmëria e ekzistencës të së mirës publike. Shembuj si mbrojtja dhe siguria kombëtare janë tipike që tregojnë domosdoshmërinë e ekzistencës *të* së *mirës publike*. Ky është një term teknik i përdorur nga ekonomistët për të specifikuar ato produkte dhe shërbime të cilat nuk mund të alokohen përmes aktivitetit të zakonshëm rishpërndarës të tregut. Zakonisht është e pamundur të përcaktohet çmimi i tregut dhe përfitimi konkret që mund të marrë përdoruesi i një të mire publike. Një arsye për këtë është se zakonisht përfitimi është i përbashkët dhe nuk mund të shijohet individualisht. Nëse pranë portës së shtëpisë në buzë të rrugës ndezim një dritë që të ndriçojnë rrugicën zakonisht të errët të lagjes, në nuk mund të ndalim të tjerët të përfitojnë nga kjo dritë. Ndriçimi i rrugëve natën është në këtë mënyrë një e mirë tipike kolektive që emërtohet e mirë publike. Kjo e mirë nuk mund të krijohet nga secila portë e rrugicave të çdo lagjeje. Zakonisht ajo financohet nga shteti në një standard të pranuar dhe në shërbim të të gjithëve. Financimi i tyre bëhet pikërisht me shumat e mbledhura nga shteti përmes taksave dhe tatimeve. Kuptohet që standardi publik i ndriçimit varet nga shuma e parave të shpenzuara. Nëse mblidhet më shumë atëherë ndriçimi mund të jetë i një cilësie më të lartë.

Jo vetëm të mirat publike janë një arsye për mbledhjen e vlerave nga shteti. Dhe të ashtuquajturat të Mira Individualisht të Konsumueshme janë arsye për ekzistencën e barrave tatimore. Një shembull tipik i të mirës Individualisht të Konsumueshme është arsimi. Kuptohet rëndësia e arsimit për të ardhmen e një individi. Në këtë këndvështrim arsimi i shërben tërësisht individit dhe është një e mirë e konsumueshme nga vetë ai. Për të pasur të drejtën për të mësuar duhet të paguhet. Arsimi dhe Institucionet Arsimore janë me kosto të larta administrimi. Këtë të mirë në këtë këndvështrim mund t`a përdorin vetëm familjet e pasura. Për këtë arsye një pjesë e mirë e institucioneve arsimorë krijohen dhe financohen nga shteti. Një gjë e tillë bëhet që jo vetëm familjet e pasura të kenë të drejtën për të arsimuar fëmijët e tyre. Kjo bëhet sepse në tërësi shoqëria do të përfitonte më shumë nëse niveli arsimor i tërë shoqërisë do të zhvillohej, madje duke rritur dhe përfitimin e familjeve të pasura.

Arsye për aplikimin e sistemit rishpërndarës janë dhe të ashtuquajturat Kosto të Jashtme. Këto janë kosto prodhimi, por pa ndikuar në prodhues. Kosto të tilla janë ndotja. Dihet që sidomos në zonat industriale banorët vuajnë nga ndotja, por përfitimin e procesit të prodhimit që është në vetvete ndotësi e ka vetëm prodhuesi. Analiza ekonomike tregon se nëse prodhuesi nuk paguan për këtë të mirë ai aktualisht është duke krijuar një avantazh konkurrues. Për këtë ai duhet të paguajë në mënyrë që të mos krijohen

shtrembërime në treg. Sistemi tatimor në këtë rast mund të krijojë një detyrim monetar mbi këtë prodhues. Në këtë mënyrë rritet dhe kosto e prodhimit dhe çmimi i tij. Të ardhurat e gjeneruara mund të përdoren për të kompensuar banorët e ndotur. Sidoqoftë rruga më e mirë është ajo e krijimit të rregulloreve për të minimizuar ndotjen dhe sistemi rishpërndarës në këtë rast mund të financojë procesin e krijimit të sistemit parandalues të ndotjes si dhe të strukturës për kontrollin e nivelit të saj.

Disa të mira janë monopole natyrale. Energjia hidroelektrike është e kufizuar nga ekzistenca e lumenjve. Është e kuptueshme që monopoli i prodhimit të saj do të jetë nga shteti si përfaqësuesi më i mirë i interesave kombëtare. Në rast të një monopoli privat mund të lindin kosto publike pasi ai aplikon çmime më të larta në interes të tij. Vetë shteti është shpesh i tentuar nga kjo mundësi. Në disa raste për të zbutur këtë mundësi abuzimi krijohen mundësi për koncesione private për krijimin e energjisë nga lumenj sekondarë. Në vende si ai i yni ku numri i burimeve hidroenergjike është i lartë, ekziston mundësia e heqjes së monopolit të shtetit së bashku me të gjithë kostot që e shoqërojnë atë.

Sistemi rishpërndarës është në fuqi për të financuar skemat e shërbimeve publike. Financimi përmes tatimeve bëhet ndaj të sëmurëve (sistemi shëndetësor), të papunëve dhe ndaj skemave të tjera të përfitimit publik. Kjo është shprehje e vendimit shoqëror që ata që punojnë ndajnë një pjesë të vlerës që ata krijojnë dhe e japin atë për palë të treta më në nevojë. Në këtë mënyrë sistemi zbut pabarazitë ndaj shtresave shoqërore me të ardhura të ndryshme.

Në vetvete procesi i rishpërndarjes së vlerave ka shoqëruar zhvillimin e njeriut duke qenë pjese e natyrës se tij shoqërore. Nëse njeriu primitiv bënte një shpërndarje të prerë midis individëve të bashkësisë, nëse ndërtoheshin monumente kushtuar zotave apo mbahej një ushtri, anëtarë të caktuar të shoqërisë kishin detyra të konsumonin vlera që krijoheshin nga pjesëtarë të tjerë dhe e kundërta. Krijimi i bashkësive dhe jeta në grup e njeriut nënkupton një rishpërndarje të vlerave që krijohen nga secili anëtar i bashkësisë. Rishpërndarja e vlerave nënkupton ndërgjegjësimin e njeriut se disa detyra në shoqëri duhet të bëhen nga disa pjesëtarë dhe disa detyra nga pjesëtarë të tjerë. Teoria e avantazhit konkurrues e vërteton një përmirësim të tillë të mirëqenies shoqërore. Kështu udhëheqësi shpirtëror i fisit nuk gjuante pre pasi ishte zakonisht i paaftë fizikisht për t'a realizuar atë. Zakonisht në moshë ai i siguronte bashkësisë qetësinë shpirtërore. Gjuetari, zakonisht i ri në moshë, kishte më të lehtë të gjuante dhe më të vështirë të krijonte komfort shpirtëror. Në këtë mënyrë është vërejtur se specializimi i detyrave ka rritur mirëqenien e shoqërisë që në hapat e para të saj. Kuptohet se rishpërndarja e vlerave ka marrë forma të ndryshme me evoluimin e shoqërisë njerëzore. Me hyrjen në funksion të parasë dhe me fuqizimin e saj kjo rishpërndarje vlerash mori

formën e një tarife monetare, përgjegjësia e mbledhjes dhe përdorimit të saj ishte zakonisht e një personi (mbret, prijës, udhëheqës etj). Detyra e tij ishte rishpërndarja e vlerave me qëllim maksimizimin e vlerës së shoqërisë. Efektiviteti i kësaj rishpërndarje ka evoluar me zhvillimin e shoqërisë dhe rendit shoqëror. Nëse në shoqëritë primitive rishpërndarësi mbante një pjese të madhe të vlerave, kjo pjesë ka rënë gjithnjë e më shumë me evoluimin e shoqërisë. Gjithashtu ka evoluar edhe pjesa e rishpërndarë, pra ka ndryshuar pjesa që mban për vete krijuesi i vlerave dhe pjesa që jep për të tjerët. Nëse në një shoqëri primitive ndarja e vlerave kishte më shumë elementë subjektiv se sa objektiv, në një shoqëri më të evoluar elementët e fundit mbizotërojnë. Në këtë kuptim një shoqëri e evoluar me një moral dhe rregull më të lartë, mbizotërohet nga gjykimi objektiv (mirëqenia e shoqërisë në krahasim me atë të individit, efektiviteti ekonomik) dhe më pak mbizotërohet nga gjykimi subjektiv (dëshira personale për të mos ndarë me të tjerët vlera, mbizotërimi i personit ndaj shoqërisë). Në këtë mënyrë shoqëria ka bërë, vazhdon dhe do të vazhdojë të bëjë rishpërndarje të vlerave në funksion të maksimizimit të mirëqenies.

Në një shoqëri hipotetike në të cilën në momentin që krijohet vlera e tatueshme, krijuesi i saj do të derdhte detyrimin ndaj shtetit nuk do të ishte e nevojshme krijimi dhe mbajtja e një administratë shtetërore. Teorikisht për çdo vlerë krijuesi duhet të ndante pjesën e shtetit dhe t`a përdorte atë për financimin e të mirës publike. Kjo shoqëri hipotetike do të kishte në këtë mënyrë kosto rishpërndarës zero dhe në këtë mënyrë përfitim maksimal pasi dhe shuma e përdorur për të krijuar të mirën publike do të ishte maksimal. Një model i tillë shoqërie nuk mund të ekzistojë. Kjo pasi në procesin e parë të ndarjes së vlerës midis krijuesit dhe shtetit do të mbizotëronin elementët subjektivë të përfitimit personal të krijuesit. Ai nuk do të kishte tendencë të mbante me shumë vlerë për vete dhe më pak për financimin e të mirës publike. Së dyti në procesin e financimit të të mirës publike do të kishte kosto të paevitueshme si ato të kohës oportune të humbur për derdhjen në buxhet të fondit etj. Në praktikë është gjetur zgjidhja që të krijohet një sistem vetdeklarues me të drejtën e kontrollit ndaj tij.

Në mënyrë që rishpërndarja të rrisë maksimalisht mirëqenien, duhet që dhe kostot e këtij procesi të jenë sa më të ulëta. Këto kosto janë dy llojesh, kosto të mbledhjes së fondeve publike dhe kosto të menaxhimit dhe realizimit të të mirës publike. Këto kosto përballohen nga një pjesë e të hyrave publike. Në këtë mënyrë jo të gjithë të hyrat publike përdoren për financimin e të mirave publike. Sa më të vogla të jenë këto kosto aq më shumë mbetet për të shpenzuar për financimin e të mirës publike. Në këtë këndvështrim reduktimi i kostove ndikon në mënyrë direkte në përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë.

Në kostot e mbledhjes së fondeve publike hyjnë kosto të administratës

që merret me kontrollin dhe mbledhjen e të hyrave publike. Këto kosto zakonisht janë në formën e pagave të administratës tatimore dhe doganore. Gjithashtu në këto kosto përfshihen fondet e shpenzuara për krijimin e kushteve të administratës për të punuar. Këto kosto zakonisht janë në formën e shpenzimeve operative, si trajnime, mallra të konsumit si kancelari, karburant. Në këto kosto bëjnë pjesë edhe shpenzimet e investimeve kapitale që nënkuptojnë investimet në ndërtesa, makineri afatgjata etj.

Nga një studim për i realizuar për vendet anëtare të OSBE dhe jo, rezulton se një përqindje të lartë të shpenzimeve agregate administrative zënë kostot e pagave. Kjo paraqitet dhe në Tabelën 1 në fund të këtij materiali.

Vihet re se:

- kostot e administratës në raport me kostot agregate të funksionit të mbledhjes së tatimeve varion nga 60 deri në 90%

- e parë në periudhën 2005 – 2009 pjesa e kostove të pagave varion rreth 72%. Për vendet jo anëtare kjo jashtë OSBE kjo përqindje është lehtësisht më e ulët dhe në rënie në vitin e fundit

- arsyeja për një kosto më të ulët, në disa vende shihet si arsye e përdorimit të burimeve të jashtme sidomos në funksione të tilla si IT, kosto të një vlere të lartë

Raporti i kostove administrative ndaj mbledhjes së të ardhurave që quhen dhe "kosto të mbledhjes" përfaqëson treguesin kryesor të efiçencës/efektivitetit të administrimit. Ky raport krijohet nga pjesëtimi i kostove agregate të një organi mbledhës i të ardhurave dhe të ardhurave të mbledhura nga ai në një vit fiskal. Raporte të tilla janë një praktikë e njohur në shumë vende anëtare të OSBE, si pjesë e transparencës me publikun. Këto raporte nuk mund të përdoren tërësisht për të evidentuar efiçencën/efektivitetin e organit. Faktorë të tjerë duhen marrë parasysh në këtë evidencë. Këta faktorë janë:

- ndryshimet në normat tatimore. Ndryshimet ligjore në uljen e normave tatimore ndikojnë direkt në të ardhurat e mbledhura duke përkeqësuar raportin, pa ndonjë ndryshim në efiçencën/efektivitetin e organit në punën e tij.

- ndryshimet makroekonomike. Fluktacionet e zhvillimit ekonomik pasqyrohen dhe në treguesit e të ardhurave të mbledhura nga organet, pavarësisht nga performanca e punës së tyre.

- shpenzime të jashtëzakonshme të organit. Investimet kapitale janë raste të tilla që ndikojnë negativisht në raport.

- ndryshimet në natyrën e të ardhurave të mbledhura nga organi.

Ndryshimet ligjore si për shembull kalimi në administrim i akcizës nga organet tatimore në organet doganore që ndodhi në vendin tonë do të përkeqësoj këtë raport për organet tatimore në përmirësim të atyre doganore

Nga krahasimi i të dhënave për vendet anëtare rezulton:

- kostot e mbledhjes ndryshojnë shumë midis vendeve.

- ndryshimet strukturore dhe legjislative janë një faktor më i rëndësishëm se sa efiçenca/efektivitet i organit për vendet jashtë OSBE.

- për shume vende ndikim të madh ka pasur kriza botërore duke përkeqësuar raportin.

- për pak organe të vendeve të zhvilluara ndikimi në përkeqësimin e raportit është nga faktorët strukturorë

Këto konkluzione tregojnë diçka të rëndësishme. *Vendet me stabilitet politik kanë kosto administrimi që varen nga efiçenca/efektiviteti i organit. Kjo do të thotë se efektiviteti i kontrolleve ndaj organeve rritet me zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin politik dhe fiskal.* Në kushte të një ndryshimi strukturor si në normat tatimore, ecurinë makroekonomike raporti i kostove të mbledhjes përkeqësohet duke zbehur influencën e kontrolleve ndaj organeve taksambledhëse.

Një tjetër tregues i kostove të mbledhjes është ai i kostove agregate të një organi taksambledhës dhe P.B.B-së. Për vendet anëtare të OSBE ky tregues paraqitet në Tabelën 2 në fund të këtij materiali.

Konkluzione të studimit, midis të tjerave janë se raportet e larta vihen re si pasojë e ndikimit të efiçencës së organit, duke ruajtur rezervat për vërtetësinë e të dhënave të marra nga buletinet statistikore të secilit shtet.
Në këtë aspekt një rol të rëndësishëm në uljen e kostove janë përmirësimi i efiçencës / performancës së organeve shtetërore. Një përmirësim i tillë do të ndikonte në një zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm duke ulur kostot e krijimit të të ardhurave buxhetore dhe duke rritur vlerën e të mirave publike. Roli i KLSH në këtë përmirësim është i qenësishëm me ekzistencën e tij. Përmirësimi i efiçencës/efektivitetit të organeve është pjesë e vazhdueshme e punës së KLSH, pjesë e programeve të punës rutinë të saj.
Një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm përfshin tre zona të aktivitetit:

- shoqërinë
- ekonominë
- mjedisin

Zhvillimi ekonomik ka të bëjë më konceptin e atij zhvillimi ekonomik që nuk krijohet në kurriz të të ardhmes së vendit, pa marrë borxhe që do të ndikojnë në rritjen e momentit të vlerave të konsumuara të të mirës publike dhe pagimin e kësaj kostoje jo nga buxhetet aktuale, por nga brezat e ardhshëm. Arritja e këtij zhvillimi të qëndrueshëm ndikohet nga kontrollet e kryera nga organet e pavarura

shtetërore si KLSH. Vihet re se shtetet që zakonisht udhëhiqen nga klasa politike tentojnë të përmirësojnë të tashmen në kurriz të të ardhmes. Për më tepër rritja e shpenzimeve buxhetore në formën e zgjerimit të tepërt të vendeve të punës për të përfituar politikisht është gjithashtu një realitet. Një tendencë e tillë është e kuptueshme, nëse konsiderojmë sistemin politik zgjedhor që mbizotëron sot në botë. Ky sistem udhëheq dhe shpesh përbën një tregues të rëndësishëm të politikave të ndjekura nga qeveritarët. Për "të shpëtuar" nga ky ndikim krijohen organe kontrolluese me dy kritere kryesore:

• pavarësia politike, për të mos qenë pjesë e cikleve të politikës. Kriteret e përdorura për këtë janë zgjedhja e formave të organizimit në formën e kryetarëve, zakonisht figura të pavarura nga politika dhe me një vizion të lartë që kanë për mision të shkëputen nga influencat politike të momentit.

• pavarësia ekonomike, cikle kohore të operimit që nuk përputhen me afatet kohore të ciklit politik dhe buxhete që nuk lidhen me organet qeveritare.

Në këtë mënyrë bëhet më e lehtë për organet e kontrollit të kenë si qëllim primar të tyre përmirësimin e qëndrueshëm ekonomik.
Ne vitin 1992, 105 vende në deklaratën e Rios mbi Zhvillimin dhe Mjedisin u zotuan për aplikimin e principeve të një zhvillimi të qëndrueshëm për punën e tyre. Këto principe u ritheksuan në 2002 në Mbledhjen Ndërkombëtare mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm në Johanesburg, Afrika e Jugut. Konkluzionet e këtij takimi ishin se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndikim thelbësor në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi.
Udhëzimet e OSBE-së për matjen e treguesit të një zhvillimi të qëndrueshëm janë:

• treguesit e zhvillimit që janë aplikuar duhet të jenë të lehtë për t`u lexuar, të tregojnë një tendencë të qëndrueshme në kohë, reagojnë ndaj forcave të duhura, është e lehtë për t'u matur evolucioni i tyre.

• Treguesit duhet të jenë analitikisht të arsyeshëm. Kjo do të thotë se ata duhet të jenë të bazuar në qëllime të qarta për zhvillim të qëndrueshëm.

• Treguesit duhet të jenë ekonomikisht të matshëm

KLSH duhet të fokusohet në kontrollin e këtyre treguesve për të matur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi.
Roli i KLSh për të ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi është shprehur dhe në orientimet më të fundit që jep organizata ndërkombëtare e auditimit të lartë. Ky orientim thekson se KLSh nëpër botë duhet të kuptojë rëndësinë e rolit të tij në zhvillimin ekonomik. Për këtë në punën e saj KLSH duhet të kushtojë një rëndësi më të veçantë auditimit të organeve që ndikojnë në

zhvillimin e një vendi. Çfarë është konstatuar nga një studim i realizuar nga M. David Gelfand, Peter W. Salsich, JR mbi zhvillimin ekonomik dhe monitorimin e tij nga KLSH:

Pika 1: Auditimi i Performancës i Agjencive të Zhvillimit nuk është Frekuent ose Tërësisht i plotë
Çdo tatimpagues dëshiron që: Shtetet duhet të kryejë shumë rregullisht auditime të performancës për t'u siguruar se zhvillimi ekonomik monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë adekuate, dhe se kompanitë e subvencionuara konsiderohen përgjegjëse.

Çfarë kemi gjetur:

Vetëm 17 shtete kërkojnë auditime të rregullta të performancës së agjencive. Në 33 shtete, auditimet e performancës mbi zhvillimin ekonomik kryhen vetëm afërsisht çdo 15 vjet.

• Nga shtetet që nuk kanë urdhëruar programe auditimi të performancës, katër arritën të selektoheshin pas programit.

• Qëllimi i auditimeve është shumë i kufizuar: ata zakonisht mbikëqyrin shpenzimin e taksave për zhvillimin ekonomik , dhe rrallë vlerësojnë aktivitetet për zhvillimin ekonomik të një shtetit si një e tërë.

Pika 2: Auditorët e Shtetit janë të kufizuar nga Praktikat primitive të Monitorimit të Shtetit

Çfarë duan tatimpaguesit: Agjencitë duhet të monitorojë shpenzimet e programeve të tyre, e cila përfshin grumbullimin e të dhënave për të matur rezultatet e aktiviteteve dhe programit të tyre si dhe monitorimin e performancës së kompanive që marrin subvencione për zhvillim.

Çfarë kemi gjetur:

• Agjencitë kanë dështuar për të kryer mbledhjen dhe monitorim e të dhënave bazë, të tilla si arritja e krijimit të vendeve të punës dhe nivelet e pagave të kompanive të subvencionuara.

• të dhënat e paraqitura të kompanisë nuk vërtetohen gjithmonë.

• Agjencitë nuk mbledhin të dhëna mbi rezultatet e programit të tilla si shtimi i vendeve të reja të punës ose ulja e papunësinë në një zonë të planifikuar.

• Agjencitë nuk kanë objektiva të matshme të performancës: kjo është një nga zbulimet më negative, sepse pa standarde specifike kundrejt një programi apo projekti që mund të vlerësohen, është e pamundur për auditorët për të përcaktuar efektshmërinë.

• Agjencitë mbështeten së tepërmi mbi "analizat e konsumatorit" të kompanive të subvencionuara.

Pika 3: Dështimi i Auditimeve në vlerësimin e efektshmërisë

Çfarë duan tatimpaguesit: Auditimet e performancës duhet të vlerësojnë efektshmërinë e një agjencie, programi, apo strategjie të zhvillimit ekonomik.
Efektshmëria thjesht nënkupton se nëse programi arrin qëllimet për të cilat ai është krijuar, dhe nëse prodhon një përfitim neto publik, të matur duke kërkuar te treguesit e performancës dhe duke krahasuar ato me shpenzimet e projektit.
Çfarë kemi gjetur:

• Pjesa më e madhe e auditimeve nuk janë në gjendje të nxjerrin ndonjë konkluzion rreth efektshmërisë për shkak të mbikëqyrjes së dobët të agjencisë.

• Shumë auditime e përcaktojnë shumë ngushtësisht efektshmërinë, si fokusimi nëse një program është duke përmbushur kërkesat e njohura me ligj në vend të vlerësimit të efektit të tij mbi treguesit e duhur ekonomik.

• Pak auditime fokusohen mbi efektshmërisë.

• Pak auditorë përpiqen të përcaktojnë nëse rezultatet e vëzhguara të tilla si shtimi i vendeve të punës mund t'i atribuohet programit të vlerësuar.

Pika 4: Auditorët zbulojnë pak dëshmi sesa efektive janë Programet e Zhvillimit Ekonomik
Çfarë duan tatimpaguesit: Agjencitë e zhvillimit ekonomik duhet të jenë të afta të krijojnë tregues të matshëm të efektshmërisë, të tilla si shtimi e vendeve të punës në industri të përcaktuara ose ulja e papunësinë në një zone gjeografike të caktuar.

Çfarë kemi gjetur:

• Pak auditorë që studiojnë efektshmërinë arrijnë në përfundimin se programet kanë pasur një efekt minimal mbi veprimtarinë e zhvillimit ekonomik dhe/ose kushtet ekonomike të zonave të përcaktuara.

• Subvencionet janë dhënë kur ata nuk kanë qenë të nevojshme.

• Subvencionet nuk janë përcaktuar mjaftueshëm.

• Programet nuk janë përdorur siç kanë pasur qëllim ligjvënësit.

Pika 5: Qeveria është Një Objektiv i Lehtë: Auditorët zbulojnë Shumë Praktika Shqetësuese
Çfarë duan tatimpaguesit: Agjencitë duhet të ndjekin politika konkrete të gatshme për të vendosur sesi duhet të shpenzohen paratë e taksapaguesve, për t'u siguruar se shpenzimi është bërë sipas qëllimit të programit.

Çfarë kemi gjetur:

•Katërmbëdhjetë agjenci nuk aplikojnë kritere të qëndrueshme kur japin subvencione.

• Agjencitë nuk ndjekin praktika biznesi të mendimit praktik: 34 auditë kanë zbuluar agjenci që kanë pranuar që kreditë të mos paguhen në kohë në norma shkuese, duke dhënë ose

marrë të holla për kompani që kishin dështuar më parë për të plotësuar kërkesat e programit, ose ndryshe kishin keq administruar paratë e tatimpaguesve.

• Agjencitë janë fajtore për gabime etike dhe ligjore: të paktën shtatë auditorë zbuluan se mungesa e përmbushjes sipas rregullave të programit na çon në nivelin e mospërmbushjes së programit sipas ligjit.

Pika 6: Auditimet janë përdorur dobët
Jo shpesh çohen deri në fund auditimet kritike, dhe pak auditë marrin mbulimin mediatik që ato meritojnë.
Konsumatori përfundimtar i veprimtarive të shtetit është në të vërtetë qytetari i thjeshtë i shtetit. Me fjalë të tjera, justifikimi për të pare përpjekjet për zhvillim ekonomik të një shteti janë nëpërmjet përmirësimit të kushteve ekonomike në shtet, mirëqenia ekonomike e rezidentëve të saj do të përmirësohet. Nëse aktivitetet për zhvillim ekonomik të një shteti nuk përmirësojnë jetën ekonomike të banorëve të ... ato nuk mund të justifikohen. Rezidentët e shtetit janë, kështu, personat kyç me të cilin duhet të gjykohen rezultatet.
Përfundimisht roli i organeve të kontrollit si KLSH dhe format e saj të ngjashme në vende të ndryshme është parësor në zhvillimin ekonomik të vendit. Procesi i rialokimit të kryer nga shteti është shprehje e dëshirave të shoqërisë njerëzore për të përmirësuar mirëqenien e saj. Ky proces rialokimi shprehet përmes buxhetit të shtetit. Ky proces ka kosto të cila ndikojnë në mosrealizimin e përfitimit maksimal nga rialokimi. Këto kosto lidhen me efiçencën/efektivitetin e organeve shtetërore. Kjo performancë ndikohet nga ciklet politike dhe nga vetë performanca e brendshme e administratës. Performanca e këtyre organeve përmirësohet nga roli kontrollues i KLSH. Në këtë mënyrë KLSH shprehet si një faktor në zhvillimin ekonomik të një vendi. Evidenca statistikore për vendet anëtare të OSBE dhe jo anëtare tregon për një tendencë të rritjes së shpenzimeve buxhetore për organet mbledhëse të të ardhurave. Kjo rritje ka dy faktorë, të jashtëm ose të lidhur zakonisht me ciklet politike dhe të brendshëm që lidhen me performancën e administratës së organeve. Rekomandimet e OSBE dhe konkluzionet e Mbledhjeve Botërore të Kontrolleve të shtetit janë se KLSH ka një rol të qenësishëm në ndikimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Dr. Edvin Stefani është Kontrollor i Lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

LITERATURA

- Tax Administration in OECD and selected non – OECD countries: comperative information series (2010), centre for tax policy and administration, Mars 2011
- Minding the Candy Store: State Audits of Economic Development by Good Jobs First A project of the Institute on Taxation and Economic Policy
- Ron Snell. March 1998. A Review of State Economic Development Policy: A Report from the Task Force on Economic Development Incentives. National Conference of State Legislatures: Denver. National Association of State Development Agencies, et al. August 1999. Evaluating Business Development Incentives. Economic Development Administration, U.S. Department of Commerce: Washington, D.C
- State and Local Taxation and Finance, M. David Gelfand, peter Ë. Salsich, JR
- Problemi Fiscali nell`Europa del Mercato Unico, mario Baldassarri, Paolo Roberti
- David Gram, "Auditor: Economic Council May Be Violating Law," Associated Press State and Local Wire, June 6, 2000.

Tabela 1

Pagat mesatare/kostot agregate për funksionet e mbledhjes së tatimeve të shtetit					
Vendet	2005	2006	2007	2008	2009
Vendet e OSBE	72.5	72.7	73.1	71.1	72.4
Jashtë OSBE	69.6	69.7	72.1	63.4	63.7
Të gjithë vendet	70.1	70.2	71.1	68.7	69.7

Tabela 2

Shpenzimet e administrimit të një organi taksambledhës/PBB					
Mesataret (%)	**2005**	**2006**	**2007**	**2008**	**2009**
Shpenzime për organet për mbledhjen e tatimeve/ PBB	0.222	0.214	0.211	0.199	0.208
Shpenzime për të gjitha organet që sjellin të ardhura	0.259	0.248	0.243	0.224	0.234

Auditimi publik

Performanca e njësive të auditimit të brendshëm

ROLI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR NJË QEVERISJE TË MIRË PUBLIKE

Situata aktuale e ekonomisë globale e përfshirë nga kriza po nxjerrë në pah çështje të rëndësishme që lidhen me dështimin në qeverisjen dhe mirëadminitrimin e fondeve. Në mënyrë të veçantë këto çështje marrin një ndjeshmëri të lartë në sektorin publik, ku mënyra si përdoren fondet publike dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen prej organizatave të sektorit Publik, është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët qoftë si përdorues të shërbimeve ashtu dhe si taksapagues. Për këtë qëllim kërkohet që qeverisja e shërbimeve publike të jetë në standardet më të larta. *Qeverisja e mirë çon në menaxhim të mirë, performancë të mirë, administrim të mirë të parave publike, angazhim të mirë publik dhe së fundmi dhe rezultate të mira.*

DR. HYSEN MUCEKU

Hyrje

Audituesit e brendshëm, duke pasur një pamje objektive nga brenda organizatës, luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në procesin e qeverisjes duke bërë me dije menaxhimin, organin drejtues/titullarin dhe audituesit e jashtëm mbi problemet e rrezikut dhe kontrollit dhe duke vlerësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut.

Qeverisja efektive e organizatave kërkon një sistem të kontrolleve dhe ekuilibrave, në mënyrë që të sigurohet që çështjet e duhura t'i drejtohen personave të duhur. *Një sistem efektiv i qeverisjes së organizatës vendos një*

lidhje midis menaxhimit, vendimmarrësit, audituesve të jashtëm, dhe audituesve të brendshëm në një mënyrë të tillë që të krijohet një kuadër, i cili jo vetëm plotëson interesat dhe nevojat e tyre, por dhe siguron një nivel të mjaftueshëm të besimit tek njëri - tjetri apo tek e gjithë organizata në tërësi.

Auditimi i qeverisjes është një element bazë për një qeverisje të mirë publike. Duke ofruar një vlerësim objektiv të paanshëm nëse burimet publike janë menaxhuar në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi për të arritur rezultatet e synuara, audituesit ndihmojnë organizatat qeveritare (subjektet e sektorit publik) që të kenë përgjegjshmëri dhe integritet, të përmirësojnë operacionet, dhe të nxisin besimin midis organizatave, qytetarëve dhe gjithë grupeve të interesit.

Nisur nga fakti që suksesi i qeverisjes matet kryesisht nga aftësia e saj për të ofruar shërbime të suksesshme dhe realizimin e programeve të saj në mënyrë të përshtatshme dhe të drejtë, veprimtaritë e auditimit të qeverisjes duhet të kenë autoritetin dhe kompetencat (aftësitë) për të vlerësuar integritetin financiar dhe efektivitetin. Për më tepër, ai duhet të mbrojë dhe të ruajë vlerat kryesore të organizatës, përderisa si organizatë e sektorit publik ajo i shërben të gjithë qytetarëve.

Audituesit ndihmojnë vendimmarrësit duke bërë vlerësimet e duhura nëse organizatat publike po kryejnë atë ç'ka pritet prej tyre dhe atë që i është ngarkuar të kryhet prej tyre, duke shpenzuar fondet për qëllimet e synuara, dhe në pajtueshmëri me kuadrin ligjor e procedural. Pra, auditimet bashkëkohore fokusohen në çështje të tilla si : "Politika që shqyrtohet është implementuar sipas qëllimit për të cilin është hartuar ?"; dhe nëse "Menaxherët kanë zbatuar sisteme efektive të menaxhimit të riskut ?". Auditimi mbështet strukturën qeverisëse duke verifikuar që raportet e agjencive dhe programeve të performancës financiare dhe programatike duke testuar apo provuar përshtatshmërinë, pajtueshmërinë me rregullat dhe qëllimet e organizatës. Për më tepër, auditimet e brendshme kontribuojnë për përgjegjshmërinë publike duke siguruar eksesin e informacioneve të tilla për grupet përkatëse të interesit brenda dhe jashtë organizatës. Në vijim, menaxherët kanë detyrën për të vlerësuar rreziqet dhe të krijojnë sisteme efektive të kontrollit për arritjen e objektivave dhe identifikimin e rreziqeve. Audituesit vlerësojnë dhe raportojnë për suksesin e këtyre përpjekjeve.

Gjithashtu, audituesit luajnë një rol të rëndësishëm në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit, përfshirë mashtrimin, veprimet e papërshtatshme apo abuzive, dhe keqpërdorime të tjera të pushtetit/detyrës dhe burimeve që u janë vënë në dispozicion zyrtarëve, punonjësve të sektorit publik. Audituesit monitorojnë efektivitetin e strukturës se kontrollit të brendshëm të ngritur nga menaxhimi për të identifikuar dhe pakësuar kushtet të cilat mund të sigurojnë baza për veprimtari korruptive.

Audituesit japin vlerësime nga brenda organizatës për të mbështetur vendimmarrësit duke vlerësuar se, cilat programe apo politika po funksionojnë

dhe cilat jo, duke shpërndarë praktikat më të mira dhe informacion të standardizuar, dhe duke kërkuar horizontalisht në të gjithë organizatat publike dhe vertikalisht midis niveleve të ndryshme të qeverisjes për të gjetur mundësi për të huazuar, adaptuar apo ri-organizuar praktikat e menaxhimit. Veprimtaria audituese ndihmon gjithashtu për të institucionalizuar ndryshimet e reja organizative duke ofruar informacion të vazhdueshëm për përmirësimin e politikave. Audituesit e kryejnë punën e tyre në mënyrë sistematike dhe objektive duke krijuar një koncept të detajuar të operacioneve dhe duke arritur në konkluzione bazuar në evidencën që ata mbledhin.

Audituesit duke ofruar një përshkrim të drejtë të problemeve, burimeve, roleve dhe përgjegjësive të kombinuara me rekomandime të dobishme, ndihmojnë palët e interesuara për të rikonsideruar problemet dhe programet.

Duhet pasur parasysh se, kur punohet për përmirësimin e performancës së programeve specifike dhe duke i lidhur problemet e nxjerra nga një auditim mund *të rritet aftësia dhe kapaciteti i qeverisjes* për t'u përfshirë apo lidhur me probleme të ngjashme. Auditimet duke u fokusuar në kontributin e tyre si vlerësues të brendshëm kanë kontribut të rëndësishëm në dhënien e përgjigjeve për çështje të përgjithshme si : "A ka sjellë politika rezultatet e pritshme apo atë që synohej ?". Njëkohësisht me funksionin e përgjegjshmërisë auditimet kontribuojnë dhe në përmirësimin e funksioneve të organizatës dhe qeverisjes së saj.

Audituesit gjithashtu ndihmojnë organizatën të shohë përpara në terma afatgjatë duke identifikuar tendencat dhe duke sjellë në vëmendje probleme emergjente apo sfidat kritike të pritshme para se ato të kthehen në kriza.

Një metodë e rëndësishme e auditimit – Auditimi mbi Bazë Risku (ABR)- fokusohet në kuadrin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut në organizatë e cila ndihmon për të identifikuar dhe zbuluar rreziqe të papranueshme. Nëpërmjet auditimit mbi bazë risku, veprimtaria audituese jep informacion të dobishëm dhe të përshtatshëm për organizatën lidhur me menaxhimin e rreziqeve të saj. Auditimet të fokusuar në parashikime ndihmojnë për t'i dhënë përgjigje çështjeve si : "cilat ndryshime apo zbatime të politikës mund të përballen në të ardhmen me rreziqe apo kërkesa të tjera ?".

Kur audituesit e sektorit publik fokusohen tek tendencat dhe tek e ardhmja, ata ndihmojnë në vendimmarrje, ata gjithashtu luajnë një rol kyç duke ndihmuar drejtuesit në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve.

Në vijim, vlerësimi i rrezikut nga vetë audituesit siguron që burimet e auditimit janë përdorur në mënyrë efektive duke u fokusuar në fushat që janë më shume të ekspozuara ndaj këtyre risqeve.

Një strukturë e mirë qeverisëse kërkon zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të kuadrit ligjor. Mungesa e strukturave të mira të qeverisjes dhe e zbatimit të qeverisjes së mirë rrit riskun për *korrupsion publik, i cili përcaktohet si keqpërdorim i pushtetit të besuar për përfitime private.* Si rrjedhojë parime të qeverisjes si : Përgjegjshmëria, transparenca, ndershmëria dhe paanësia janë thelbësore në sektorin publik. Ato përfaqësojnë bazën mbi të

cilën duhet të ndërtohet një qeverisje e mirë publike.

Zhvillimet kryesore të auditimit të brendshëm në vendin tonë

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik (KBFP) si një kombinimin i tre elementëve: përgjegjshmërisë menaxheriale, auditimit të brendshëm dhe harmonizimit qendror, është përgjegjësi e çdo drejtuesi publik zbatimi i tij me qëllim që të garantoj se, fondet publike po shpenzohen me maturi, pasi kontrolle të tilla ndihmojnë për të luftuar mashtrimin dhe korrupsionin, si dhe të parandaloj keqpërdorimin e fondeve publike. Sistemi synon të përcaktoj metoda të përshtatshme dhe transparente për të marrë garanci të arsyeshme se fondet publike do të shpenzohen në përputhje me objektivat e identifikuara nga Qeveria dhe të miratuara nga Parlamenti

Në kuadrin e reformave të ndërmarra në Shqipëri në fushën e menaxhimit të financave publike, auditimi i brendshëm merr një rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm për dhënien e sigurisë mbi përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Si një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës, ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e veta, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësisë publike.

Në procesin e integrimit europian të vendit tonë përcaktohet detyrimi i ngritjes dhe funksionimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, si rrjedhojë dhe vetë auditimit të brendshëm si një nga elementët kryesorë të këtij sistemi. Në këtë këndvështrim, kryerja e auditimit është një shërbim i detyrueshëm për çdo subjekt publik.

Modernizimi i sistemit të menaxhimit të financave publike ka çuar në një rritje të fokusit në drejtim të sistemeve të auditimit dhe kontrollit. Reformat e ndërmarra në fushën e financave publike kanë krijuar bazën e plotë funksionale për fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Rritja e performancës së procesit të buxhetimit, kontabilitetit dhe përgjegjshmërisë për rezultatet e arritura, kërkojnë metoda të reja dhe moderne të veprimtarisë së sistemeve të kontrollit e të auditimit, të ndryshme nga sa janë përdorur në të kaluarën.

Auditimi modern dhe sistemet e kontrollit shkojnë përtej pajtueshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator, ato i referohen më shume se kurrë lidhjes së auditimit dhe kontrollit me rezultatet që ato ofrojnë. Në fakt, *fuqizimi dhe modernizimi i sistemit të auditimit të brendshëm është vendimtar dhe i rëndësisë thelbësore për të mbështetur menaxherët publike në arritjen e objektivave dhe në mënyrë të veçantë për të bërë qeverisjen publike më efektive*.

Bazuar në legjislacionin dhe standardet bashkëkohore të auditimit të brendshëm, ushtrohet edhe veprimtaria e auditimit të brendshëm në vendin tonë, ku Njësia Qendrore e

Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm zhvillon dhe koordinon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në të gjithë nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Nga analiza e sistemit në vendin tonë konstatohet se, sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar prezent një nivel të lartë risku janë: Sistemet e menaxhimit financiar, Investimet në vepra strategjike, Subjektet apo fushat me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, e cila shfaqet me mangësitë në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik, Menaxhimi i burimeve njerëzore, Subjekte me nivel të ulët të njohurive dhe përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit, pasi ka ende subjekte që përpunojnë informacionet e tyre në mënyrë manuale, ku risku i gabimeve në llogaritje apo të dhëna shfaqet mjaft i lartë. Auditimi i Brendshëm, i karakterizuar nga zhvillime dhe progres pozitiv, ende vijon të mos ketë një ndarje të qartë funksionale nga roli i inspektimit financiar. Shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të titullarëve kundrejt mbështetjes së funksionit të auditimit, kuptimit të rolit dhe përfitimeve si dhe dobive, vijon të ketë ndikime në mënyrën e organizimit dhe realizimit të kësaj veprimtarie. *Përmirësimi i vijueshëm i mjedisit për një kuptim dhe konceptim të drejtë të funksionit të auditimit të brendshëm për menaxhimin do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e saktë të auditimit të brendshëm si mbështetje dhe ndihmë për menaxhimin e subjektit publik në përmbushjen e objektivave* .

Zhvillimet aktuale të sistemit të auditimit të brendshëm që konsistojnë në: *miratimin e ndryshimeve të ligjit, miratimin e manualit dhe përgatitjen e një baze metodologjike bashkëkohore* për ushtrimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm përbën një bazë të fuqishme që kjo veprimtari të ushtrohet në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të BE-së dhe të ndikojë në mirëqeverisjen e njësive të sektorit publik.

Audituesit e brendshëm mund të veprojnë në mënyrë më efektive për vendimmarrësit (organin drejtues/titullarin) *si një konsulent që i siguron atij* (organit vendimmarrës) *informacion të pavarur dhe objektiv*. Atëherë organi drejtues ka auditimin "e tij" të brendshëm, dhe nxit një marrëdhënie dypalëshe mbështetëse auditim i brendshëm – organ drejtues. Për të marrë apo krijuar një koncept të plotë të operacioneve të organizatës, *është thelbësore që drejtimi i lartë të marrë në konsideratë punën e auditimit*. P.sh audituesit mund ta informojnë titullarin e organizatës mbi çështje të tilla si: kultura, etika, transparenca dhe marrëdhëniet e brendshme. Në vijim auditimi i brendshëm bashkëkohor bazohet në kuadrin organizativ për: identifikimin, reagimin dhe menaxhimin e risqeve të ndryshme strategjike, operacionale, financiare dhe të pajtueshmërisë me të cilat përballet organizata. Si rezultat, *audituesit mund të japin siguri objektive mbi efektivitetin e kuadrit organizativ si një i tërë, përfshirë veprimtaritë e monitorimit të menaxhimit dhe sigurinë, si dhe mbi menaxhimin e risqeve kyç individuale*.

Menaxhimi po mbështetet gjithnjë e më shumë tek audituesit e brendshëm për të përmirësuar proceset e qeverisjes. Profesioni i auditimit të brendshëm ka shumë mundësi për t'u bërë një

element strategjik në qeverisjen e organizatës në përgjigje të kërkesave në rritje të qeverisjes dhe direktivave të menaxhimit për të forcuar kontrollet dhe menaxhimin e riskut. Standardet Ndërkombëtare po kërkojnë që audituesit të vlerësojnë dhe të japin rekomandime për të përmirësuar proceset e qeverisjes dhe të konfirmojnë rëndësinë e tyre në veprimtarinë e menaxhimit të riskut.

Megjithatë, auditimi i brendshëm do të jetë gjithnjë përballë sfidës të qëndroj i pavarur dhe objektiv, duke qenë pjesë e organizatës. Në fakt një auditim i brendshëm pasiv i cili të ishte përgjegjës thjesht vetëm për riskun dhe për të eliminuar plotësisht atë nuk do të ofronte atë ç'ka organizata dhe palët e interesuara presin prej tij, prandaj auditimi i brendshëm kërkon njohje të gjithanshme të veprimtarive të organizatës, mprehtësi, gjykim të mirë dhe komunikime efektive.

Dr. Hysen Muceku është Drejtor i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm në Ministria e Financave

LITERATURA

- Graham John, Bruce Amos Tim Plumtre(2003) "Principles for Good Governance in 21-st Century" Policy Brief No.15 – August 2003.
- The Institute of Internal Auditors (2006) "Organizational Governance, guidance for internal auditors "Position Paper, July 2006.
- The Institute of Internal Auditors (2006) "The role of internal auditing in public sector governance", Professional guidance, November 2006;.
- Jeffrey Carmichael Chairman, Australian Prudential Regulation Authority, Dani kaufmannsenior Manager, World Bank Institute (2001), "Public Sector Governance and the Finance Sector", June 2001.
- ASX Corporate Governance Council Principles of Good Corporate Governance.
- Welcome to the world PIFC, 2006.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, botim i vitit 2010.
- Raporti vjetor 2011 i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Standardet

Zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit (ISSAI) 40

CILËSIA E KONTROLLIT PËR INSTITUCIONIN SUPREM TË AUDITIT

Në këtë punimi do të synohet të njihemi mbi zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit (ISSAI) 40 "Cilësia e kontrollit për Institucionin Suprem të Auditimit".
ISSAI 40, mbështetet në parimet kryesore të Standardit Ndërkombëtar Mbi Kontrollin e Cilësisë (ISQC 1), si dhe përcakton një kuadër të përgjithshëm për kontrollin e cilësisë
Ky standard fokusohet në aspekte organizative të cilësisë së veprimtarisë audituese të institucioneve supreme të kontrollit.

LULJETA NANO

Hyrje

Qëllimet bazë të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit (ISSAI) 40 janë parimisht dy:
Së pari, të zhvillojë një kod të përgjithshëm të për kontrollin e cilësisë në Institucionin Suprem të Auditit (ISA)[1].
Dhe së dyti, të ndihmojë institucionet supreme të krijojnë ruajnë një sistem të përshtatshëm të kontrollit të cilësisë që mbulon gjithë veprimtarinë e tyre.

[1] Funksionin e Institucionit Suprem të Auditit në Shqipëri e luan Kontrolli i Lartë i Shtetit.

ISSAI 40 është pjesë e standardeve të cilët përbëjnë *parakushtet* për funksionimin e Institucioneve Supreme të Auditimit që janë (ISSAI 10-99) ku përmendim :

ISSAI 10 "Deklarata e Meksikos mbi pavarësinë e ISA"
ISSAI 20 "Parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë"
ISSAI 30 "Kodi i etikës"
ISSAI 40 "Kontrolli i cilësisë për ISA"

ISSAI 40, mbështetet në parimet kryesore të Standardit Ndërkombëtar Mbi Kontrollin e Cilësisë (ISQC 1), si dhe përcakton një kuadër të përgjithshëm për kontrollin e cilësisë
Ky standard fokusohet në aspekte organizative të cilësisë së veprimtarisë audituese të institucioneve supreme të kontrollit.
Elementët kryesore të sistemit të kontrollit të cilësisë janë:

1- Përgjegjësia e lidershipit
2- Kërkesat etike përkatëse
3- Miratimi dhe vazhdimi
4- Burimet njerëzore
5- Performanca e punës së ISA
6- Monitorimi

Elementi i Parë: Përgjegjësia e lidershipit për cilësi

Parimi kryesor i cili duhet të jetë i përshtatur për Institucionin Suprem të Auditimit është : Përgjegjësia e lidershipit për cilësi në Institucionin e ISA
Ky parim ka të bëjë me faktin se një ISA duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për të nxitur një kulturë të brendshme veprimi sipas së cilës cilësia është themelore në funksionimin e ISA. Këto politika duhet të instalohen nga Kryetari i ISA i cili mban përgjegjësi të plotë për sistemin e kontrollit të cilësisë në institucion.
Cilët janë objektivat që duhet të arrihen në këtë drejtim?
-Përgjegjësi e qartë për cilësinë e punës audituese
-Implementimi i një kulture pune që e vë theksin në cilësi
-Sigurimi i burimeve të mjaftueshme për të mbajtur sistemin e kontrollit të cilësisë. Marrja e masave që të komunikohet tek i gjithë stafi i ISA i politikave dhe procedurave për kontrollin e cilësisë.
Përgjegjësia e menaxhimit për cilësi mund të strukturohet mbi bazën e strategjisë, komunikimit, udhëzimeve të punës vlerësimit të performancës dhe monitorimit.
Për arritjen e objektivave të mësipërme ISA mund të përdorë instrumente ndër të cilët përmendim: Krijimi i një dokumentacioni të përgjithshëm që përshkruan të gjithë sistemin e kontrollit të cilësisë. Kjo mund të përfshihet në rregulloren e funksionimit të ISA-it.
Hartimi i një programi të veçantë trajnimi për menaxherët e rinj për të garantuar që ata e njohin sistemin e sigurimit të cilësisë për të cilin kanë përgjegjësi.
Aplikimi i procedurave që ISA të sigurohet se po rekrutohen drejtuesit e afte dhe kompetente.

Elementi i dytë : Kërkesat etike

Parimi i përshtatur për ISA duhet të jete:
Një ISA duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara që të sigurojë

garanci të arsyeshme se ISA së bashku me stafin dhe palët e kontraktuara vepron në përputhje me kërkesat etike. Institucioni Suprem i Auditimit nëpërmjet aplikimit të këtij elementi synon që stafi gjatë funksionimit dhe përmbushjes se detyrave duhet të demonstrojë sjellje të përshtatshme etike. Ky element i këtij standardi është i lidhur ngushtë me standardin ISSAI 30 –(shih me lart) "Kodi i Etikës" dhe nëpërmjet këtij elementi ISA duhet të arrijë objektivin që të garantojë që politikat dhe procedurat dhe parimet fondamentale të etikes profesionale veprojnë siç duhet në institucion . Parimet referuar ISSAI 30 janë:

- Integriteti
- Pavarësia, objektiviteti dhe paanshmëria
- Sekreti profesional
- Kompetenca

Cilat mund të jene instrumentet përkatëse që një ISA mund të përdorë për arritjen e këtyre objektivave?

-Në kuadrin rregullator të brendshëm duhet të përfshijë Udhëzime të brendshme etike dhe të sigurohet që stafi është në dijeni të këtyre udhëzimeve.

-Stafi i ISA-t përfshirë dhe Kryetarin e saj duhet të deklarojë me shkrim për të konfirmuar përputhshmërinë me kërkesat etike.

-Duhet të ekzistojnë procedura të cilat të parashikojnë njoftimin e kryetarit të ISA-it për shkeljet e kërkesave etike nga stafi i nivelit drejtues të larte të mesëm dhe atë të ulet.

-SAI duhet të sigurojë procedura dhe të zbatojë politika të cilat sigurojnë rotacionin e stafit kryesor të auditimit me synim uljen e riskut të familjaritetit me organizatën që auditohet.

-Po kështu ISA në vijimësi duhet të organizojë aktivitete për edukimin, trajnimin e stafit me kodin e etikes dhe duhet në mënyrë të vazhdueshme të fokusohet në monitorimin e veprimtarisë së stafit të ISA-te nëse kryen funksionet në përputhje me kërkesat etike.

Elementi i trete: Pranimi dhe miratimi

Parimi i përshtatur për ISA:

SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për të ofruar garanci të arsyeshme që do të kryen auditime dhe punë të tjera ku ISA:

A- Është kompetente të kryejë punën e tij dhe ka aftësinë e mjaftueshme duke përfshirë kohen dhe burimet për ta bërë këtë gjë

B- Mund të veprojë me kërkesat etike përkatëse

C- Ka marrë në konsideratë integritetin e organizatës së audituar dhe ka parashikuar se si të trajtojë riskun operacional.

Sipas këtij parimi politikat dhe procedurat e ISA-t duhet të pasqyrojnë gamën e punës së kryer. Në shumë raste ISA-t kanë pak liri për punën që ata kryejnë .

Objektivat e ISA- në lidhje me këtë element të kontrollit të cilësisë kanë të bëjnë me faktin që ISA duhet të trajtojë rreziqet e ndryshme që dalin gjatë kryerjes së punës. Bazuar në udhëzime të caktuara ISA duhet të kryejë vlerësimin e e përgjithshëm të riskut dhe të përcaktojë identifikojë dhe të planifikojë si duhet të adresimin dhe menaxhimin e tij.

Po kështu ISA zakonisht punon me burime të kufizuara dhe për këtë duhet të marrë masa të përshtatshme që të arrijë *një balancë të përshtatshme* midis

burimeve që ka në dispozicion dhe gamës së punës me synim arritjen e një niveli të lartë cilësie.
Për këtë është e nevojshme që në institucion të instalohet një sistem i prioritetin të punës në mënyrë që të merret në konsideratë nevoja e sigurimit të cilësisë së punës audituese. Por në rastet kur burimet e ISA janë të pamjaftueshme ISA duhet të ketë procedura që të sigurojnë që mungesa e burimeve duhet të bëhet prezent tek Kryetari i ISA-t dhe deri në autoritetet legjislative dhe buxhetore pra duhet të hartohet një sistem raportimi që të identifikohet çdo mungesë burimesh.
Instrument tjetër për arritjen e objektivave për këtë element është hartimi i një plani vjetor përfshirë prioritetin e detyrave punës administrative zhvillimin profesional etj.

Elementi i katërt: Burimet njerëzore.

SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për ti dhënë një garanci të mjaftueshme se ka burime të mjaftueshme dhe kompetenca aftësi dhe angazhim për kërkesat etike të domosdoshme:

A) Për të kryer punën e saj në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore rregullatore në fuqi

B) Për ti bërë të mundur ISA të nxjerrë raporte që janë të përshtatshme .

Objektivi i këtij parimi është që ISA duhet të synojë të sigurojë një staf të mjaftueshëm që të zotërojë kompetencë, aftësi dhe të jetë plotësisht i angazhuar në zbatimin e parimeve etike.

Për këtë ISA duhet të hartojë dhe aplikojë politika dhe procedura në *menaxhimin e burimeve njerëzore të cilat duhet të konsiderohen Asete në dhe jo Kosto për institucionin.*
Për këtë ISA duhet të hartojë strategjinë e burimeve njerëzore e cila duhet të përmbajë nënstrategji për rekrutimin e stafit të ri dhe kualifikimin e stafit ekzistues, vlerësimi i performancës se audituesve, zhvillimi profesional, zhvillimi i karrierës, zbatimi i standardeve të etikës etj.

Elementi i 5. Performanca e punës audituese

SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për të dhënë garanci të arsyeshme se auditimet e saj dhe puna tjetër kryhen në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi dhe se ISA gjeneron raporte të përshtatshme.
Këto politika dhe procedura duhet të përfshijnë:

a. Çështje që kanë lidhje me nxitjen e cilësisë së punës audituese.

b. Përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe

c. Përgjegjësinë e rishikimit.

Për zbatimin e këtij elementi parimi ISA duhet të ketë si objektiv që të garantojë që udhëzimet dhe procedurat janë në përputhje me standardet.
Me synim që të garantohet një cilësi e qëndrueshme është e nevojshme që ISA të caktojë përgjegjësitë e nivelit drejtues të stafit për sigurimin e cilësisë.

Për arritjen e objektivave të mësipërme ISA duhet:

-Të hartojë Udhëzime në të cilat të përcaktohen qarte procedurat të cilat inkurajojnë sigurimin e një cilësie të lartë të punës audituese dhe parandalojnë kryerjen e auditimeve me cilësi të ulët.

-Angazhimi i eksperteve të fushës për çështje të caktuara, sigurimi i metodologjive të auditimit duke reflektuar në to praktikat dhe eksperiencat me të mira ta institucioneve analoge.

-SAI duhet të balancojë konfidencialitetin e dokumentacionit me nevojën për transparence dhe përgjegjshmëri. Për këtë është e nevojshme të vendosë procedura transparente për shenjen e informacionit procedura këto në përputhje me legjislacionin.

Elementi i 6. Monitorimi

SAI duhet të vendosë një proces monitorimi garantuar një siguri të mjaftueshme se politikat dhe procedurat për sistemin e kontrollit të cilësisë janë të përshtatshme ë mjaftueshme dhe funksionojnë me efektivitet.

Procesi i monitorimit duhet të përfshije një konsiderim dhe vlerësim në vazhdimësi të sistemit të kontrollit të cilësisë së ISA përfshirë një vlerësim kampioni të punës së përfunduar nga punët e kryera nga ISA

Standardi kërkon që:

- Përgjegjësia e procesit të monitorimit t'i caktohet një individi ose individëve me përvojë dhe autoritet të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të ISA.

- Monitoruesit të kryejnë vlerësimin e të jenë të pavarur (d.m.th ata nuk duhet të marrin pjesë në punë ose ndonjë vlerësim të kontrollit të cilësisë).

Nëpërmjet këtij elementi ISA ka për objektiv të ruajë sigurimin e cilësisë dhe kjo kërkon monitorim të vazhdueshëm.

Si mundet të arrijë ISA këtë objektiv?.

Nëpërmjet kryerjes së monitorimeve të pavarura dhe raportimit të rezultateve të monitorimit Kryetarit të ISA-it.

- Kur e sheh të përshtatshme ISA mund të angazhojë stafin e një tjetër ISA ose të një stafi të përshtatshëm që të kryejë rishqyrtim të pavarur të sistemit të përgjithshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë. (kjo në përputhje me ISSAI 20 parimi 9).

- Nëse është e përshtatshme ISA-s mund të konsiderojë të tjera mjete për monitorimin dhe cilësinë e punës së tyre të cilat mund të përfshijnë po jo të limitohet në to; përmendim:

-Trupa të pavarura akademike

-Reagimi i subjekteve të audituara etj.

Po kështu ISA duhet të ketë procedura për trajtimin e ankesave apo deklaratave që kane të bëjnë me cilësinë e punës audituese të ISA-T

Nga ana tjetër ISA duhet të marrë masa të bëjë publike raportet e monitorimit.

Është e rëndësishme për ISA-n që "Monitorimi" të mos shërbeje si një "Mjet" për dhënien e masave sanksionuesve ndaj stafit auditues për të gjitha mangësitë që janë evidentuar gjatë procesit monitorues.

Në përfundim mund të konkludohet se instalimi i Sistemit të kontrollit të

cilësisë dhe Monitorimit është pjesë e Politikës së Përgjithshme që një ISA ka për cilësinë .

Politika e ISA-t për cilësinë duhet të përcaktohet nga niveli drejtues i do ISA, duhet të përqendrohet tek përfitimet dhe ruajtjen e besueshmërisë dhe kredibilitetit institucional por nga ana tjetër duhet të behet kujdes me efektivitetin dhe efiçencën e kostos se sistemit të kontrollit dhe cilësisë.

Luljeta NANO,
është Kryekontrollore në Kontrollin e Lartë të Shtetit

LITERATURA

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve të Auditimit Suprem (ISSAI)
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (IFAC)
- Deklarata e Meksikës
- Kodi i Etikes për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI 30)
- SAI Audit Methodology Workshops 2002-2006
- Public Sector External Audit
- Documents Collection 2010, SIGMA, www.sigma.org
- SAI Instambul Agreement March 2011

Auditimi

Performanca e funksionimit të enteve publike

KORRUPSIONI DHE MASHTRIMI: ROLI I AUDITUESIT

Ky studim mbështetet mbi bazën e eksperiencës personale dhe mësimeve të nxjerra nga pjesëmarrja në workshopin "Mbi Korrupsionin dhe Mashtrimin Financiar, si dhe Rolin e Audituesve në parandalimin dhe zbulimin e tyre", mbajtur në datat 23-25 prill 2012 në Qendrën për Ekselencën në Finance (CEF) në Lubjanë, Slloveni.

SALI AGAJ

Hyrje

Korrupsioni dhe mashtrimi financiar janë pengesa serioze për një drejtim efektiv, rritje ekonomike, stabiliteti dhe vendim marrje si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Për këtë arsye është në interesin e shoqërisë që shfaqjet e korrupsionit dhe mashtrimit të reduktohen në nivele minimale.

Audituesit e jashtëm dhe të brendshëm mund dhe duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në zbulimin e premisave të korrupsionit dhe rasteve të mashtrimit. Megjithëse deri tani nuk ka qenë detyrë primare e audituesve zbulimi dhe raportimi i veprave penale korruptive, në kuadrin e thellimit të luftës kundër korrupsionit si një problem global, është e nevojshme që kjo kategori profesionistesh të zotërojë një kuptim me të mirë lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e tyre për parandalimin e korrupsionit si dhe në procesin e nxjerrjes së përgjegjësisë për këto vepra penale.

Korrupsioni shfaqet me rastet e shërbimeve, komisioneve (të shpërblimit) ryshfeteve dhe përfitimeve

të tjera pa lënë gjurmë në dokumentet zyrtare, ndërsa mashtrimi konsiston në përfitime të pamerituara, duke anashkaluar kontrollet e duke shkelur dispozitat. E thënë ndryshe, në rastin e një mashtrimi, ndryshe nga korrupsioni, mbeten gjurmë në dokumentet e subjekteve përkatës (publike dhe private) e veçanërisht në deklarimet financiare.

Për këtë arsye është i domosdoshëm dallimi ndërmjet auditimit të mashtrimit, ku shkeljet mbështeten në dokumentet e subjektit që auditohet dhe auditimit të korrupsionit, i cili nuk mund të evidentohet me dokumente.

Duhet pasur parasysh fakti se është shumë e vështirë për audituesit të zbulojnë korrupsionin, dhe se përcaktimi i saktë i dëmit ekonomik për këto raste është i pamundur. Megjithatë, konkluzionet e raporteve të auditimit për korrupsionin vlerësohen si të domosdoshme, në mënyrë që entet publike në përgjithësi dhe Qeveria në veçanti të marrë masa parandaluese në luftën kundër tij.

Kuptimi i mashtrimit dhe korrupsionit

Mashtrimi përkufizohet si paraqitje e gabuar e fakteve, me paramendim dhe në mënyrë të qëllimshme, me qëllim nxjerrjen e përfitimeve personale. Sipas Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të Ministrisë së Financave (2010), "*Mashtrimi financiar është veprimi, apo moskryerja e një veprimi në mënyrë të qëllimshme, që lidhet me paraqitjen e fakteve të rreme, të pasakta, apo të paplota si dhe me abuzime, të cilat kanë pasoja negative për të ardhurat dhe shpenzimet e një njësie publike apo private*"[1]

Pasaktësitë në deklarimet financiare mund të rrjedhin nga gabimet ose mashtrimi. Faktori kryesor dallues ndërmjet mashtrimit dhe gabimit është nëse kjo pasaktësi është e qëllimshme apo e paqëllimshme.

Mashtrimi është një koncept i gjerë nga ana ligjore, ndërsa audituesi duhet të merret me mashtrimin që rrjedh nga deklarimet e gabuara financiare.

Korrupsioni përfshin sjelljen në mënyrë të paligjshme ose abuzimin me pushtetin nga ana e zyrtarëve në sektorin publik dhe privat, nëpërmjet dhënies apo pranimit të një favori me anë të të cilit ata sigurojnë pasuri ose privilegje për veten dhe/ose të afërmit e tyre.

Korrupsioni është një problem global i përbashkët për vendet e zhvilluara dhe sto në zhvillim duke arritur proporcione shqetësuese për shoqërinë. Thyerja e barrierave midis sektorit publik dhe privat dhe në veçanti privatizimi i shërbimeve, partneriteti i sektorit publik me atë privat, shkëmbimet e personelit midis dy sektorëve etj, kanë rritur të ashtuquajturat "zonat gri" ku konflikti i interesave midis atyre që punojnë në sektorin privat dhe atyre që punojnë në sektorin publik është shumëfishuar. Të gjitha këto zhvillime, pavarësisht avantazheve që sjellin, kanë si efekt anësor rritjen e hapësirave për korrupsion.

Në vendet në tranzicion dukuritë e korrupsionit janë edhe më të dukshme për shkak të intensitetit më të lartë të faktorëve që e mundësojnë atë, por

[1]Ministria e Financave, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (2010), fq. 103

edhe të sistemeve dhe procedurave të brishta menaxheriale të cilat ndikojnë ndjeshëm në konsolidimin e rendit ekonomik dhe politik.
Korrupsioni ka pasoja të pallogaritshme në dobësimin e sistemit ekonomik dhe atij politik. Ndër pasojat kryesore mund të përmendim:

- deformimin e konkurrencës;

- shpërndarjen e padrejtë të burimeve publike dhe shpërdorimin e tyre;

- shkaktimin e skandaleve që dobësojnë besimin e qytetarëve në institucionet publike, etj.

Efekti më i dukshëm i korrupsionit është humbja e besimit publik për politikanët, jetën politike dhe shtetarët në tërësi.
Ndikimi mbi biznesin dhe shoqërinë e gjerë është edhe më i madh sepse ai devijon burimet produktive për sektorët joproduktive dhe bën një individ të pasur në kurriz të taksapaguesve. Kjo sëmundje rrit rreziqet dhe kostot për biznesin, dëmton besimin e investitorëve, frenon rritjen ekonomike dhe është cilësuar si takse mbi të varfrit.
Korrupsioni vepron si një pengesë e fortë për investimet e huaja direkte dhe redukton dëshirën e investitorëve të huaj të formojnë ndërmarrje të përbashkëta me kompanitë vendore apo të investojnë drejtpërdrejt. Sipas Shigeo Katsu, Zëvendës President i Bankës Botërore për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore**, "…***Nga shpeshtësia e ryshfeteve të ndryshme, përqindja vjetore e të ardhurave që përdoren për ryshfete dhe mendimet e manaxherëve mbi shkallën në të cilën korrupsioni pengon ecurinë e biznesit, në mund të evidentojmë elementët që pengojnë investimet të cilat nxisin një zhvillim më të lartë"*[2]
Subjektet private kur përfshihen në korrupsion, luajnë një rol aktiv në kuptimin që ato janë shpesh në anën dhënëse (në dallim nga ana marrëse). Në disa raste, punonjësit e subjekteve private angazhohen në korrupsion pasiv (pra përfitojnë pagesa dhe favore të tjera të paligjshme), kur vetë subjektet prokurojnë shërbime dhe mallra nga subjekte të tjera.

Po si është niveli i korrupsionit dhe mashtrimit, apo më mire të themi, perceptimi tij tek në në Shqipëri?

Sipas sondazhit të IDRA (Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi) të titulluar "Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe përvoja" theksohet se "*Perceptimi mbi korrupsionin në Shqipëri vazhdon të mbetet i lartë. Nga 20 grupe/institucione të vlerësuara në sondazhin e publikut të gjerë në 2010,14 prej tyre konsiderohen si më shumë të korruptuara sesa të ndershme dhe vetëm 6 prej tyre kanë marrë më pak se 50 pikë në shkallën e vlerësimit nga 0-100 pikë, ku 0 do të thotë "Shumë i ndershëm" dhe 100 do të thotë "Shumë i korruptuar". Drejtuesit fetarë, Presidenti, media, ushtarakët, mësuesit e shkollave publike dhe drejtuesit e OJF-ve shihen si më pak të korruptuarit. Doganierët, tatimorët, ministrat, parlamentarët dhe doktorët janë vlerësuar si më të korruptuarit"*[3]

[2] Raport i Bankës Botërore "Antikorrupsioni në tranzicion", Vëllimi II, fq. 39
[3] IDRA (Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi), Sondazhi

2. Mashtrimi financiar, roli i audituesit në parandalimin dhe zbulimin e tij

Parandalimi dhe zbulimi i mashtrimit financiar mund të realizohet nëpërmjet auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Workshopi "Mbi Korrupsionin dhe Mashtrimin Financiar, si dhe Rolin e Audituesve në parandalimin dhe zbulimin e tyre" i CEF sugjeroi dy forma auditimi.

1. "Auditimi i fortë" bazuar mbi procedura, kritere dhe sanksione për drejtuesit,

2. "Auditimi i butë" bazuar në vlera dhe norma të përbashkëta, dhënien e shembullit të duhur dhe "kontrollit shoqëror" nga kolegët.

Auditimet e forta:

- Fusha e natyrshme e audituesit
- Procedura të qarta, kritere, shpërblime dhe sanksione të qarta;
- Ndarje e qartë e detyrave, linjave të raportimit dhe të përgjegjësisë;
- Ndarje e detyrimeve, administrate moderne, raportim i mire dhe periodik

Auditimet e buta:

- Synojnë kulturën e administratës;
- Njerëzit e bëjnë gjene e duhur, sepse duan ta bëjnë gjene e duhur;
- Kodi i sjelljes i bere nga drejtuesit dhe stafi;
- Atmosfere e hapur, lejohet kritika dhe ajo merret seriozisht;
- Zyrtar me integritet (për këshilla & ankesa konfidenciale);
- Drejtimi behet duke dhënë shembullin vete drejtuesi;
- Koleget reagojnë ndaj sjelljes se papërshtatshme;
- Ka sesione në grup (diskutime lidhur me dilemat e punës)

Si kryhet mashtrimi financiar?

Gjatë marrjes së vendimit për t'u përfshirë në në mashtrim financiar funksionari instinktivisht mbart brenda vetes 2 pyetje bazë:

Pyetje 1: Cili është probabiliteti për t'u zbuluar dhe cili është përfitimi personal?

— *për një probabilitet të lartë për t'u zbuluar dhe një fitim të ulet personal, ju në këtë ent keni nevoje për auditime të forta*

Pyetje 2: A mund ta justifikoj sjelljen time? A e është vërtet kaq gabim, tek e fundit?

— *për ndryshimin e sjelljes, ju në këtë ent keni nevoje për auditime të buta.*

Efektiviteti i auditimit

Për të ndryshuar sjelljen shpejt, ju keni nevoje për auditime të forta në njësinë publike (kritere të qarta, sanksione të forta, njerëz që forcohen të mbajnë rregullin);

Për të ndryshuar sjelljen në mënyrë afatgjate, ju keni nevoje për auditime të buta;

Megjithatë, auditimet e buta pa ndonjë auditim të forte nuk kanë sukses. Edhe e kundërta është e vërtetë.

Trekëndëshi i mashtrimit financiar

"Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe përvoja", fq. 4

Presioni mbi punonjësin për të kryer mashtrimin:
- Probleme financiare
- Shume ambicioz, por jo shume i suksesshëm
- Standard shume i larte jetese (makina, shtëpi, biznese)

Sjellja / arsyet:
-"Bosi im e bën po ashtu" ose "Nuk jam i vetmi"
-"Meritoj shume me tepër rroge pe rate çfarë bëj" ose "Me trajtojnë shume keq"
-"Nuk vjedh, i kthej vetes"

Shanset për mashtrim:
- Pune me risk të larte (arkëtar, doganier, tatimor, pune me blerje për entin) dhe:
- Nuk ka auditim të duhur të brendshëm, ose
- Drejtues jo kompetente, ose
- Me shume përparësi për marrëdhëniet personale.

Mashtrimi: Konkluzione

- Gjithsecili në njësi duhet kontrolluar.
- Përshtypja e parë nuk është gjithnjë me e drejta.
- Sjellje e mirë në të kaluarën nuk nënkupton sjellje të mirë në të ardhmen.
- Gjithkush e ka një çmim!

Sipas Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të Ministrisë së Financave (2010), faqe 104-105 nënvizohet se "Titullarët e njësive publike kanë përgjegjësinë për ngritjen e sistemeve për menaxhimin e risqeve të njësisë publike, duke përfshirë edhe riskun e mashtrimit financiar, apo të korrupsionit. Çdo njësi përballet me një gamë risqesh për mashtrime dhe parregullsi, që janë specifike për veprimtarinë e saj dhe që vijnë nga burime të jashtme, ose të brendshme. Risku për një mashtrim, ose parregullsi konkrete matet zakonisht nëpërmjet probabilitetit që ai të materializohet dhe impaktin që do të kishte mbi fondet dhe reputacionin, nëse do të verifikohej në praktikë. Çdo njësi duhet të identifikojë, klasifikojë dhe vlerësojë sa e ndjeshme është karshi mashtrimit dhe korrupsionit, duke i trajtuar me hollësi risqet kryesore".

Në terma të përgjithshëm risku për mashtrime, ose parregullsi përfshin:

a. Vlerësimin e ndjeshmërisë së njësisë në tërësi ndaj mashtrimit dhe korrupsionit;
b. Identifikimin e zonave që janë më të prekshme ndaj risqeve për mashtrim dhe parregullsi;
c. Vlerësimin e shkallës së riskut të mashtrimit dhe parregullsive;
d. Përgjigjen ndaj riskut të mashtrimeve dhe parregullsive;
e. Vlerësimin e efektivitetit të strategjisë së riskut ndaj mashtrimit dhe parregullsive.

Përgjigja e njësisë publike ndaj riskut të mashtrimit duhet t'i përshtatet risqeve, me të cilat ajo përballet. Në mënyrë tipike, ajo do të përfshijë disa, ose të gjitha pikat e mëposhtme:.

Së pari, hartimi i një Deklarate Politikash mbi Parregullsitë dhe Mashtrimet, si dhe Planin e Veprimit kundër Parregullsive (dy dokumentet bazë, që duhet t'i ketë çdo njësi publike).

Së dyti, krijimin dhe kultivimin e një kulture që lufton mashtrimet dhe

parregullsitë. Mund të jetë e dobishme që gjithë punonjësit të bëjnë një deklaratë të qartë, të angazhimit të tyre, për një sjellje etike, që rrit sensibilizimin kundër korrupsionit dhe mashtrimit.

Së treti, verifikimet gjatë procesit të rekrutimit dhe ruajtja e një morali të lartë të stafit, mund të jenë gjithashtu të rëndësishme.

Së katërti, ndarja e përgjegjësive për menaxhimin e risqeve të përgjithshme dhe atyre konkrete për mashtrim dhe parregullsi, në mënyrë që këto procese të integrohen në drejtimin e përgjithshëm.

Së pesti, vendosja e kontrolleve të brendshme, efektive nga pikëpamja e kostos, për të frenuar mashtrimin dhe korrupsionin, në përpjesëtim me risqet e identifikuara.

Së gjashti, zhvillimi i aftësive dhe ekspertizës për të menaxhuar riskun e mashtrimit dhe parregullsive me efektivitet, dhe për t'ju përgjigjur mashtrimit dhe parregullsive me efektivitet, në rastet kur ato vërehen. Ngritja e mekanizmave dhe ekspozimi i tyre i mjaftueshëm për të gjithë stafin dhe publikun për të raportuar dyshimet e mashtrimit.

Së shtati, dhënia e një përgjigje të shpejtë dhe efektive kundër rasteve të mashtrimit dhe parregullsive, të vërejtura në praktikë, dhe shfrytëzimi i një stafi të trajnuar dhe me përvojë për hetimin e tyre në baze të marrëveshjeve të lidhura me Ministrin e Financave dhe rregullimeve që ka vendosur Ligji Nr. 10294, date 1.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik".

Së teti, ngritja e sistemeve për të monitoruar ecurinë e hetimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Së nënti, mundësia e caktimit (në rast mungese ekspertize) të Auditimeve të Brendshëm për të investiguar, në rastet kur kërkohen, për mashtrimet dhe parregullsitë si dhe përdorimi i përvojës së tyre për të forcuar kontrollet, në funksion të parandalimit të këtyre rasteve.

Dhe së fundmi, vlerësimi i vazhdueshëm i efektivitetit të masave kundër mashtrimit dhe parregullsive në kufizimin e rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit. Gjithashtu dhe bashkëpunimi me palët e interesuara për t'i trajtuar mashtrimet dhe parregullsitë, nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, hetimeve të përbashkëta, etj.

Korrupsioni dhe roli i audituesit

Audituesit sapo krijojnë dyshime mbi prezencën e parregullsive apo të veprimeve korruptive duhet të njoftojnë menjëherë nivelin më të lartë të menaxhimit. Ekzaminimi i plotë i veprimeve mund të kërkojë edhe përfshirjen e specialistëve të tjerë në përfundim të ekzaminimeve një raport i shkruar duhet formuluar duke shprehur edhe opinionin e ekspertit. Raportimi në kohë ndihmon menaxhimin e subjekteve private dhe agjencitë publike të zbatimit të ligjit që të merren efektivisht me trajtimin e mëtejshëm të veprimeve korruptive dhe parandalimin e korrupsionit në të ardhmen.

Raportimi mbi korrupsionin përbëhet nga komunikime të ndryshme me shkrim për përdorim të brendshëm ose përfundimtar të menaxhimit në lidhje me statusin dhe rezultatet e auditimit të kryer.

Shkrimi i raportit duhet të marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Zbulimet duhet të paraqiten në një mënyrë të pakthyeshme që do të thotë se faktet e paraqitura të jene të provuara dhe të qarta; e njëjta gjë vlen edhe për shprehjet me stil të dykuptimësi dhe gjuhë abstrakte;
- Promovimi i gjuhës më të zakonshme dhe të një stili të saktë të të shprehurit;
- Toni polemik, ofendues dhe tendencioz duhet të shmanget;
- Klasifikimi i zbulimeve (ato të rëndësishmet duhet të paraqiten në sintezat e përfundimeve);
- Asnjë supozim nuk mund të bëhet në raporte.

Audituesit gjatë tërë punës së tyre duhet të jetë të kujdesshëm për të identifikuar shenjat paralajmëruese që i korrespondojnë çdo faze të proceseve të auditimit, të cilat lenë shteg për veprime korruptive.

Këto shenja paralajmëruese duhen konsideruar si faktor risku për procesin e auditimit në evidentimin e rasteve korruptive.

Për shembull, faktorët e riskut në rastin e prokurimeve të investimeve apo blerjeve publike janë si më poshtë:

- Kërkesat e përcaktuara në fazën e analizës se nevojave janë jo të përshtatshme;
- Informacion i pamjaftueshëm dhe jo i qartë për furnizuesit potenciale;
- Vendosja e periudhave të shkurtra të furnizimit pa arsye;
- .Mungesa e analizës se nevojave: produkti i kërkuar është më tepër se nevojat;
- Ofertuesit përcaktojnë kërkesat për blerje të mallrave.
- Përfshirja pajustifikuar e zyrtarëve të lartë (te subjektit publik ose privat) në fazën e përzgjedhjes dhe vlerësimit;
- Specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve nuk janë të përcaktuara qartë;
- Pranimi i një numri shumë i kufizuar i ofertave;
- Dyshime në lidhje me konfliktin e interesave;
- Dëshmi e marrjes së hershme të informacionit të prokurimit nga disa kontraktorë
- Kërkesa për oferte nuk është shpallur si duhet (nuk ka qenë transparente);
- Kriteret e vlerësimit nuk janë të qarta dhe lene shteg për interpretime të ndryshme
- Ndryshimet në ofertat e bëra pas marrjes së tyre në rrugë formale;
- Kontraktori paraqet ofertën joreale që tregon marrëveshjet e fshehta ose ofertën qarkulluese që do të thotë se ofertuesit janë marre vesh paraprakisht.
- Tërheqja e pazakontë e ofertave;
- Kontraktuesit përdorin konkurrentët si nënkontraktojë; duke kryer me shumë se 50 % të punimeve,
- Arsyetimi për justifikimin e prokurimit të drejtpërdrejtë (psh se ofertuesi është burimi i vetëm në atë rast) nuk është i mjaftueshëm;
- Ndryshimet në rritje në koston e mallrave (punimet shtesë) dhe shërbimeve pas lidhjes së kontratës;
- Zgjatje pajustifikuar e kontratës dhe pas mbarimit të afatit;
- Ankesat në lidhje me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të marra;
- Inspektimet e përcipta për t'u siguruar për cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të marra;
- Fatura të dyshimta.

Roli i ISA-t në luftën kundër mashtrimit & korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit kërkon një sulm shumëformësh. Kërkon reforma në administratën publike, në sistemin gjyqësor, në informacionin publik dhe në vlerat kulturore të shoqërisë.
Audituesi individual dhe madje edhe një departament apo njësi e tere qeveritare apo në sektorin publik nuk mund të propozoje veprime dhe masa që s'mund të zbatohen nga të audituarit e tyre. Ka veprime të cilat duhet të merren nga Qeveria, ose që kërkojnë vullnet politik të shtetit. për veprime të tilla, vetëm një institucion si institucioni suprem i auditimit (SAI) mund të marre nismën. për këtë, vete ISA duhet të jete i fuqishëm dhe me burime të shumta. Duhet zhvilluar një mekanizëm që të fuqizoje ISA-n dhe veprimin që ai mund të marre, me qellim që të parandaloje ose minimizoje korrupsionin. Ky veprim është shume i rëndësishëm, sepse nëse ISA nuk është i forte dhe i afte të luaje një rol lideri, nivelet e tjera me të ulta të auditimit dhe audituesit e brendshëm nuk janë në gjendje të bëjnë diferencën në luftën kundër korrupsionit.
Edhe pse ka një marrëveshje të përgjithshme që ISA duhet të luaje një rol efektiv në promovimin e transparencës, qeverisjes se mire dhe përgjegjësisë, ende shumica e ISA-t në vendet në zhvillim nuk kane pavarësi të mjaftueshme dhe burime për ta luajtur këtë rol.
Vetëdija për rolin në luftën kundër korrupsionit do të ishte e pamjaftueshme, nëse nuk do të shoqërohej me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ushtrimin e këtij roli (identifikimi dhe raportimi) ndonëse nuk pritet që audituesit të kenë ekspertizën e një personi, përgjegjësia primare e të cilit, është zbulimi dhe hetimi i korrupsionit.
Një qasje e re ndaj korrupsionit në zhvillimin e profesionit të audituesit është e diktuar nga skandalet ndërkombëtare të kontabilitetit të kompanive të profilit (duke filluar nga ajo e kompanisë Enron në vitin 2002), të cilat kanë vënë në pikëpyetje efektivitetin e qeverisjes korporatave dhe mekanizmave të mbikëqyrjes dhe, ç'ka është me e rëndësishme për këtë udhëzues, cilësinë e raporteve financiare dhe të auditimit.
Një letër e IFAC sugjeron një rol të ri për organet kombëtare të kontabilitetit dhe auditimit të cilat duhet të inkurajojnë bashkëpunimin e këtyre organizatave me ligjvënësit dhe aktorët e tjerë për të ç'rrënjosur korrupsionin. Në kuadër të kësaj përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe nxitur debatin, IFAC bën disa propozime:

- edukimin për ndërgjegjësimin e profesionisteve të sektorit në lidhje me efektet negative të korrupsionit mbi marrëdhënien mes kontabilistëve dhe publikut;
- IFAC këshillon komitetet e auditimit për të shqyrtuar nëse ekzistojnë politikat e duhura antikorrupsion dhe të këmbëngulin që veprimet korruptive të raportohen;
- Këshillohen kontabilistët, ekspertët kontabël, audituesit që të promovojnë kodet e sjelljes në subjektet ku ata punojnë me qëllim që të mund të parandalohen aktivitetet korruptive;
- Inkurajohet roli individual i kontabilistit dhe audituesit në frenimin e praktikave korruptive duke nxitur të auditimi mund të zbulojë rrethana apo

ngjarje që ndikojnë se entiteti i audituar i zbatonte ose jo ligjet dhe rregullat”

- Në fund të fundit, në besojmë se zbatimi i standardeve më të larta profesionale nga kontabilistët është një nga mbrojtjet më të mira kundër korrupsionit. Propozimet për ridimensionimin e rolit të kontabilisteve, eksperteve kontabël, audituesve, në luftën kundër korrupsionit plotësojnë dijen e kahershme se këta profesioniste luajnë një rol të rëndësishëm në shoqëri, duke siguruar informacion të besueshëm dhe transparent si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. një rol i tille i gjere dhe jetik nuk mund të mos e shpalose potencialin e tij edhe në fushën antikorrupsion.

Nga ana tjetër, roli i audituesve është më tepër efikas në promovimin e transparencës, drejtësisë dhe të funksionit mbikëqyrës brenda organizatave të cilat auditohen.

Ata kanë autoritet hetues të zgjeruar brenda subjektit të audituar për të mbledhur provat të cilat identifikojnë veprimtari korruptive apo të paligjshme.

Ndonëse përgjegjësia kryesore për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit mbetet tek autoritetet administrative, policia, prokuroria dhe institucione të tjera hetimore të cilat janë të veshura me pushtetin për të hetuar korrupsionin, ISA mund të kontribuojë me përpjekjet e tyre në këtë luftë të vazhdueshme në mënyrat e mëposhtme:

- duke përmirësuar përgjegjshmërinë e përgjithshme financiare brenda subjekteve private të cilat auditohen dhe këshillohen duke ndikuar në këtë mënyrë në krijimin e një klime të transparencës dhe qeverisjes së mirë.
- duke identifikuar e dokumentuar kryerjen e veprimeve konkrete që dyshohen se janë korruptive.

Në përgjithësi mund të thuhet se roli dhe përgjegjësitë e ISA-t kane të bëjnë më shumë me parandalimin e korrupsionit se sa me zbulimin e fakteve që identifikojnë kryerjen e tij.

Puna e ISA-t, që gjate auditimit bën vlerësimin e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm është shume efikase sa i takon parandalimit. Sipas standardit ISSAI 1240, “Audituesi duhet të arrijë të njohë në mënyrë të mjaftueshme sistemet kontabël dhe të kontrollit ë brendshëm. Ai duhet të përdorë gjykimin profesional për të vlerësuar rrezikun...” (ISSAI 1240, Nota praktike, fq. 54).

Roli dhe përgjegjësitë e ISA-t në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit mund të përmblidhet si më poshtë:

1. identifikimi i mangësive strukturore, procedurale dhe organizative brenda organizatave
qe auditohen ose këshillohen si dhe raportimi i tyre në nivelet më të larta menaxheriale;

2. mbështetja dhe inkurajimi i auditimit të brendshëm të organizatave që auditohen ose këshillohen duke ndikuar kështu në përmirësimin e qeverisjes dhe, për pasoje, në marrjen e masave proaktive parandaluese kundër korrupsionit;

3. identifikimi i diskrecionit të tepruar në duart e vendimmarrësve dhe këshillimi për ridimensionimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet efiçenca në menaxhim dhe, nga ana tjetër, të

minimizohet mundësia e vendimmarrësve për korrupsion.

4. shtrirja e sferës se kontrollit jashtë organizatës se audituar apo të këshilluar për të vlerësuar në terren sesa të kënaqur janë përdoruesit/klientët me shërbimet/mallrat e ofruar nga subjekti në ato raste kur organizimi i strukturave të brendshme vendimmarrëse, procedurat dhe kontrolli i brendshëm janë formalisht në rregull,;

5. konsultimi i burimeve të jashtme të informacionit sa here që është e nevojshme që të arrihet një përfundim në lidhje e faktin nëse subjekti i audituar apo i këshilluar i kryen transaksionet me vlerën e tregut.

Në këtë kontekst, duhet kujtuar se audituesit mund të ndodhen nën përgjegjësi penale për deklarimet e rreme, nëse pranojnë t'i bëjnë ato. Problemet dhe sfidat me të cilat përballen audituesit kërkojnë jo vetëm aftësi të lartë teknike, por edhe besimin e fortë për të kundërshtuar metodat e vjetra në të cilat janë rrënjosur praktikat korruptive e të mashtrimit të kontabilitetit, të tilla si fshehja e të ardhurave, mbivendosja e shpenzimeve dhe manipulimi i destinacionit të tyre duke punuar me dy grupe të ndryshme të pasqyrave financiare, të cilat synojnë të shmangen nga taksat që rezulton në nivele të larta të ekonomive hije.

SAI do të ndjeje një presion në rritje nga qeveria, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe shoqëria civile për marrjen e një roli gjithnjë e me të madh në luftën kundër korrupsionit. Tabela e mëposhtme tregon qarte rolin e audituesit të ISA në luftën kundër korrupsionit.

Situata	Roli i audituesit
Mungesa e provave dokumentare	Tregon mundësi për korrupsion
Përplasje mes kontraktorëve dhe funksionareve publike	Baze për auditim pjesëmarrës
Përplasje mes qytetareve dhe funksionareve publike	Nuk ka rol
Fuqi të fshehta të Funksionareve Publike	Te insistoje në bërjen publike të manualeve për përcaktimin e funksioneve
Zbulimi i korrupsionit	Nuk ka rol
Hetimi i korrupsionit	Bashkëpunon me hetuesit.

Rekomandime për ISA-n në luftën kundër praktikave të korrupsionit dhe mashtrimit financiar:

- ISA duhet të këtë fuqi të kontrolloje llogarite e taksapaguesve individuale, nëse ka një dyshim të arsyeshëm që të bën të besosh se korrupsioni ka ndodhur për shkak të një përplasjeje mes punonjësve tatimore dhe taksapaguesit, duke i shkaktuar humbje të rëndësishme buxhetit të shtetit.

- Qeveria duhet të vendose një komision të përhershëm për rishikimin e të gjitha procedurave, rregullave, manualeve dhe madje edhe ligjeve, me qellim që të modifikohen këto procedura dhe rregulla për të minimizuar shanset për korrupsion. ISA duhet të punoje me këtë komision si një partner i ngushte.

Roli i audituesit në auditimin ndaj korrupsionit

- ISA duhet t'i hape dyert e tij ndërveprimit me publikun. Ai duhet të përcaktoje një mekanizëm për të përfshire publikun e gjere ose individët e interesuar në planifikimin e auditimeve. Përqendrimi duhet të jete në marrjen e sugjerimeve lidhur me auditimin e atyre sektorëve dhe enteve ku publiku mendon se janë me të mëdha shanset për korrupsion.

- ISA duhet t'i publikoje raportet e auditimit në një gjuhe të lehte për t'u kuptuar nga publiku i gjere dhe t'i shpërndajë gjerësisht këto raporte. Kjo do t'i jepte zemër publikut të interesohet me shume për punët e shtetit dhe të jete me llogari kërkues ndaj qeverise.

- Ka pasur shume buzëkuq në zbatimin e rekomandimeve të auditimeve. Megjithatë, në vendet në zhvillim nuk ka rregullim institucional që të siguroje se planet e ardhshme të zhvillimit marrin parasysh rekomandimet e mëparshme të auditimeve. Kjo duhet bere në interes të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit të ISA-t dhe që të hyhet thelle në vrimat joetike të qeverisjes.

- Komuniteti ndërkombëtar duhet të intensifikoje përpjekjet për zhvillimin e materialeve trajnuese për auditimin ndaj korrupsionit, duke trajnuar trajnerët në vendet në zhvillim. Ai duhet t'u japë me shume ndihme teknike dhe financiare vendeve në zhvillim, për të fuqizuar ISA-t e tyre.

Sali Agaj është Kontrollor i Lartë, në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

LITERATURA

- Workshop "The role of auditor in detecting and preventing fraud and corruption", April 23-25, 2012
- ISSAI 1240 "The auditor's responsabiliies relating to fraud in an audit of financial statements"
- Magnus Borge, 9th International Anti-Corruption Conference, 10-15 October 1999, Durban, South Africa. "The role of Supreme Audit Institutions (SAIs) in Combating corruption'
- INTOSAI's Working Group on the Fight Against Corruption and Money Laundering, Policy Paper 12, 2011
- Manuali per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i Ministrisë se Financave (2010), fq. 104-105
- IDRA (Instituti per Kerkime dhe Alternativa Zhvillimi); "Korrupsioni ne Shqiperi, perceptime dhe pervoja", 2009, fq. 4, fq. 18-19.

Bashkëveprimi ndërinstitucional në auditimin publik

MBIVENDOSJA E AUDITIMIT - KOSTO SHTESË DHE MUNDËSITË PËR REDUKTIMIN E TYRE

Mbivendosja e funksioneve, mungesa e një ndarje të qarte të roleve dhe e përgjegjësive është një nga problemet që evidentohet jo rralle në sektorin publik e cila shkakton rritjen e kompleksitetit të procedurave administrative dhe përgjegjshmëri të ulet të strukturave, me një reflektim të drejtpërdrejt në nivelin e qeverisjes. Këto dukuri jo vetëm që shtojnë kostot administrative por paralizojnë edhe funksionimin e strukturave duke cenuar rezultatet dhe objektivat e vendosura.
Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm kane për mision të evidentojnë dhe vlerësojnë këto dukuri që pengojnë arritjen e objektivave me kursim dobi dhe frytshmëri dhe të japin rekomandimet e duhura për të përmirësuar qeverisjen. Por problemi vjen e behet me kompleks kur vete auditimi si funksion "vuan" pikërisht nga dukuri të tilla.

GJON NDREJA

Auditimi si funksion i vetëm

Ne se do të përpiqeshim të formulonim një kuptim të përbashkët mbi auditimin e jashtëm dhe të brendshëm , të gjitha përpjekjet tona mund të përqendroheshin duke e paraqitur atë si një funksion të pavarur vlerësimi , i cili ka për qellim të shtojë vlerën e parave dhe të burimeve publike si dhe të përmirësoje qeverisjen. Pavarësisht fokusit të punës , standardeve që aplikon, faktit se kujt i raporton etj, qëllimi i këtij shërbimi është padyshim maksimizimi i vlerës se burimeve publike. në këtë kuptim mund t'i japim të drejte vetes që për qëllime të arsyetimeve që kane të bëjnë me përmbushjen e misionit që përmendëm

me sipër, këtë funksion ta unifikojmë duke e konsideruar auditimin(të brendshëm dhe të jashtëm) si një funksion i vetëm. Kjo edhe për shkak se sektori publik konceptohet si unik në pikëpamje të parimeve të qeverisjes.
Misioni i auditimit për maksimizimin e vlerës se burimeve publike mund të plotësohet nëpërmjet dy drejtimeve kryesore të cilat kane të bëjnë me rritjen e efektivitetit të strukturave të auditimit si dhe me uljen e kostos administrative për realizimin e funksionit. Auditimi është pjese e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërtimi e funksionimi i këtij shërbimi i nënshtrohet të njëjtave kërkesa e parime si edhe elementet e tjerë të këtij sistemi dhe që kane të bëjnë me raportin e kostos me përfitimin. E thënë me fjale të tjera, as një menaxher si në sektorin publik dhe privat nuk do ta ngrinte dhe mbante një strukture auditimi, në se kostot për mbajtjen e kësaj strukture do të ishin me të mëdha se përfitimet që rrjedhin nga realizimi i funksioneve të tij. Rritja e kostove të auditimit është një problem mjaft i diskutuar sot në boten e biznesit kur volumi i transaksioneve është shtuar me hapa të shpejte, ekonomia po shkon drejt globalizimit, shkalla e kompleksitetit të ekonomisë është rritur etj. Është kjo një nder arsyet që i kane detyruar organizatat e auditimit të perfeksionojnë teknikat dhe metodat e auditimit që synojnë uljen e kostove të auditimit dhe rritjen e efektivitetit të tij. Përveç sa përmendëm me sipër rritja e kostos se auditimit është rrjedhojë edhe faktorëve të tjerë që kane të bëjnë me mbivendosjen e funksioneve të auditimit të jashtëm, auditimit të brendshëm dhe inspektimit të cilët në lufte "për zona influence" shkaktojnë kosto të larta administrative dhe ulin efektivitetin dhe efiçencën e këtij shërbimi në veçanti dhe të burimeve publike në tërësi.

Situata e mbivendosjeve. Shkaqet dhe pasojat

Shërbimi i auditimit (i brendshëm dhe i jashtëm) në vendin tone, për nga përqasja e veprimtarisë se tij me standardet ndërkombëtare duhet konsideruar në hapat fillestare dhe për rrjedhoje profili i tij nuk mund të thuhet se është qartësisht auditim. Me gjithë hapat pozitive të viteve të fundit akoma menaxheret e të gjitha niveleve nuk kane një kuptim të qarte për rolin dhe përgjegjësitë e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Nga ana tjetër auditimi i jashtëm i sektorit publik që përfaqësohet nga Kontrolli i Larte i Shtetit ka një qasje paternaliste ndaj auditimit të brendshëm dhe ka ruajtur akoma profilin represiv të Inspektimit të Shtetit. Inspektimi financiar i sapo krijuar shihet me xhelozi nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm për shkak se ata mendojnë se inspektimi ka "shkelur" në territorin e tyre. Kjo paqartësi e roleve dhe e përgjegjësive, mungesa e besimit, si dhe standardet e ulëta profesionale që aplikojnë, kane krijuar një mbivendosje të punës se tyre dhe për rrjedhoje një kosto administrative shtese.
Mbivendosja e pare serioze ekziston, në mes të veprimtarisë audituese të Kontrollit të Larte të Shtetit dhe strukturave të auditimit të brendshëm. Kjo mbivendosje ekziston si në pikëpamje të shtrirjes se auditimit ashtu edhe të teknikave që përdorin të dy

këto shërbime. Misioni kryesor i Kontrollit të Larte të Shtetit duhet të fokusohet në certifikimin e buxhetit të shtetit dhe në funksion të kësaj ai depërton pa kufizim në ekzaminimin e veprimtarisë se subjekteve publike. Por kjo sipas pikëpamjes time nuk presupozon auditimin e të gjithë subjekteve pa dallim . Shpesh here Kontrolli i Larte i Shtetit vepron si auditim i brendshëm duke përfshirë në planet e tij vjetore të auditimit të gjitha subjektet publike pa dallim për një periudhe 2-3 vjeçare. Nga ana tjetër metodat dhe teknikat e auditimit dominohen akoma nga revizioni dokumentar dhe shqyrtimi radhazi i gjithë transaksioneve pavarësisht se ato janë audituar nga auditimi i brendshëm. Shpesh strukturat e auditimit brendshëm janë tërhequr nga misionet e tyre të auditimit për shkak të respektimit dhe prioritetit të KLSH-se. Në planet e tyre të auditimit të subjekteve publike por edhe në ekzaminim shpesh përfshihet gjithë veprimtaria e subjektit publik pavarësisht në se kjo mund të jete audituar qofte edhe para një muaji nga auditimi i brendshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të heqë dore gjithashtu edhe nga veprimtaritë e inspektimit të cilat përgjithësisht iniciohen nga letrat e publikut. Këto letra ai duhet ti adresoje strukturave të inspektimit financiar përjashtuar rasteve kur rëndësia e tyre është e atille sa vlerësohet se këto të fundit nuk e kane pavarësinë dhe kompetencën e duhur profesionale ose çështjet e referuara janë jashtë juridiksionit të tyre. Auditimi e përdor inspektimin si një nga teknikat për të programuar auditimin në subjekt ose për të vlerësuar risqet por ai nuk duhet të udhëhiqet në veprimtarinë e tij nga inspektime jashtë procesit të auditimit për shkak se rrezikohet të cenoje edhe pavarësinë e tij.

Inspektimi është një test përgjithësisht i atëçastshëm, i menjëhershëm, që kryhet për llogari të niveleve të menaxhimit, për të verifikuar në se veprimtaritë e strukturave vartëse janë kryer në përputhje me ligjet rregullat dhe politikat e subjektit. në këtë kuadër të inspektosh do të thotë të verifikosh në vend punën e veprimtarinë e një njeriu, të një grupi njerëzish, të një institucioni, të një ndërmarrjeje etj. duke nxjerr përfundimet përkatëse, të krahasueshme kurdoherë me ligjin dhe rregullin. Me tej të inspektosh do të thotë të zbulosh dobësitë e të metat, të identifikosh përgjegjësitë dhe personat që i kane shkaktuar ato, ti raportosh ato në nivelet përkatëse menaxheriale dhe të propozosh masa për korrigjimin e tyre dhe ndëshkimin e ndjekjen fajtoreve.

Referuar praktikave me të mira europiane inspektimi financiar është një shërbim që krijohet pranë ministrit të financave i cili është edhe përgjegjës përpara qeverise për menaxhimin e buxhetit të shtetit. Qëllimi i inspektimit financiar është mbrojtja e interesave financiare të shtetit, kundrejt abuzimit, mashtrimit dhe korrupsionit në përputhje me parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës. Inspektimi ndjek sinjalet për dëmtimin e interesave financiare të shtetit në të gjitha agjencitë qeveritare dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror. Ai vihen në lëvizje gjithashtu nga nëpunësi pare autorizues, ministri, kryeministri, prokuroria si dhe nga media. Mbivendosja e funksioneve të

auditimit me inspektimin bart në vetvete një sere rreziqesh jo vetëm financiare por edhe të imazhit të funksionit. Duke dashur t'i kontribuojmë shkëputjes se auditimit nga inspektimit me poshtë kemi përshkruar disa dallime që lehtësisht lexuesit mund të shohin rreziqet e mbivendosjes.

Po ndërsa inspektimi është një vlerësim në një moment, në një kohe të caktuar , i cili identifikon shmangiet pozitive dhe negative në raport me ligjin dhe rregullin, auditimi është një proces i gjere dhe i gjate vlerësimi i këtyre veprimtarive. Inspektimi është i fokusuar të produkti të shkelja dhe parregullsitë, auditimi është i fokusuar të procesi që i ka mundësuar ato. Inspektimi përdor teknika të kontrollit e verifikimit ndërsa auditimi ato të analizës dhe shqyrtimit. Inspektimi vlerëson veprimtaritë e kryera në raport me ligjin dhe rregullin, ndërsa auditimi vlerëson edhe vete ligjin ose rregullin. Inspektimi orientohet drejtpërdrejt nga titullari në objektin e punës se tij ndërsa auditimi është i pavarur në planifikimin, ekzaminim dhe raportim. Inspektimi është një vegël një instrument, ndërsa auditimi është një funksion. në punën e tij inspektimi orientohet nga sinjalet përkundër auditimit që orientohet nga vlerësimi i rrezikut. Auditimi e përdor inspektimin si një nga teknikat paraprake për të programuar një auditim ose për të ekzaminuar veprimtari të caktuara krahas metodave të tjera të shqyrtimit ekzaminimit dhe vlerësimit që ndërmerr. Inspektimi është një mjet dhe një qellim në vetvete ndërsa auditimi e përdor inspektimin si një nga mjetet dhe teknikat e shumta .Dhe se fundi Auditimi është një shërbim i pavarur sigurie dhe si i tille një profesion besimi me impakte publike. Tek shërbimet e auditimit kërkohet që të kenë besim jo vetëm menaxheret por edhe publiku i gjere ndërkohë që inspektimi nuk "merakoset" shume për besimin e publikut.

Auditimi i brendshëm ndodhet gjithashtu në një situate mbivendosje serioze. Shpesh here ata me veprimet e tyre kërkojnë të "sfidojnë" Kontrollin e Larte të Shtetit duke vepruar si auditim i jashtëm. Mjafton të përmendim faktin se të gjitha njësitë e auditimit në ministritë dhe institucionet qendrore auditojnë njësitë që kane vartësi administrative pavarësisht se kane një buxhet të miratuar nga Kuvendi ose nga bordet kur ato janë shoqëri aksionere. Auditimi i ministrive të linjës nuk përfill jo vetëm auditimin e brendshëm por as auditimin e jashtëm të emëruar nga asambleja e aksionerëve sipas ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"

Një situate mbivendosje në kufijtë kritike ekziston në organet e qeverisjes vendore. në këto njësi që administrojnë vetëm në përqindje të caktuar të buxhetit qendror kane akses për auditim strukturat e auditimit të brendshëm të njësisë qeverisjes vendore,auditimi i brendshëm i prefekturës,auditimi i Ministrisë Arsimit, Shëndetësisë, Financave dhe Kontrolli i Larte i Shtetit. Një situate e tille jo vetëm që bart mbi vete një kosto shtese administrative por është njëherazi edhe një cenim i parimeve të autonomisë vendore.

Karta e autonomisë vendore e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin 8548 date 11.11.1999 sanksionon pavarësinë e organeve të qeverisjes

vendore dhe përcakton qartë raportet midis tyre dhe qeverise qendrore. Parimet e kësaj Karte janë sanksionuar edhe në një seri ligjesh të tjera që rregullojnë veprimtarinë e qeverisjes vendore si dhe në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republike se Shqipërisë. Një nga dispozitat e kësaj Karte dhe pikërisht neni 8 i saj ka disa rregullime mbi "Kontrollin administrativ të veprimeve të bashkësive vendore".

Karta lexohet ndryshe për interesa aspak profesionale por me qëllime të pastra politike, nga subjekte të ndryshme të përfshira në këtë debat. Më se pari duket se koncepti "kontroll administrativ" nuk kuptohet qarte veçanërisht nga prefekturat. Kontrolli administrativ nuk është një auditim e aq me tepër një auditim financiar siç pretendohet nga prefektura. Referuar përkufizimeve të standardeve profesionale kontrolli administrativ është: **"**Një seri veprimesh, si pjese integrale e sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me procedurat e duhura administrative për vendimmarrjen menaxheriale që realizojnë efiçencën me të lartë ekonomike dhe administrative dhe të politikave administrative". Nga ky përkufizim kuptohet qarte se sa larg janë kompetencat e Prefektit për të ushtruar një auditim financiar në njësitë e qeverisjes vendore. Por le të vazhdojmë me tej referuar Kartës. në nenin 8 pika 1 ajo parashikon se "Çdo kontroll administrativ mbi bashkësitë vendore mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji". Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë njeh si të vetmin autoritet të jashtëm për të ushtruar auditim në qeverisjen vendore, Kontrollin e Larte të Shtetit. Kushtetuta, Karta e autonomisë vendore prevalojnë mbi të gjitha dispozitat e tjera të ligjeve që i kane njohur të drejtën subjekteve të tjera për të kryer auditime në njësitë e qeverisjes vendore..

Karta parashikon gjithashtu se "kontrolli administrativ mund megjithatë të kuptoje një kontroll të ushtruar nga autoritetet e nivelit me të larte lidhur me detyrat,zbatimi i të cilave i është kaluar bashkësive vendore" në këtë kuptim i vetmi veprim i përligjur i autoriteteve të qeverise qendrore, sipas kësaj dispozite është inspektimi ose kontrolli administrativ (verifikimi) i procedurave për të verifikuar në se grantet e akorduara nga qeveria janë vendosur në destinacionin e duhur ose jo. Kjo në të vërtetë garantohet nga sistemi i thesarit i cili është barriera e sigurte për të siguruar destinacionin e fondeve, megjithatë ndonjë procedure administrative që lidhet me këtë mund të kontrollohet nga qeveria qendrore. Kur them kontrollohet, nuk kam parasysh auditimin e tyre pasi ai është tjetër gjë por vetëm një verifikim i procedurave administrative i cili nuk përfshin rregullshmërinë financiare ose veprimet të tjera që kane të bëjnë me keqmenaxhimin, shpërdorimin apo abuzimet të cilat janë detyre parësore e inspektimit financiar, por edhe e auditimit të brendshëm të njësisë, komisioneve përkatëse të këshillave dhe Kontrollit të Larte të Shtetit kur gjate rrjedhës normale të procesit të auditimit ndeshen me këto fenomene. në ushtrimin e kontrollit administrativ, Karta përcakton se duhet të mbahet shume mire parasysh parimi i proporcionalitetit sipas të cilit autoriteti kontrollues duhet të

vlerësojë dhe të respektoje proporcionin midis shkalles se ndërhyrjes në autonominë vendore, me shkallen e interesave që kërkon të mbroje. i pare nga ky këndvështrim veprimi i Prefekturave për të audituar buxhetin e njësive të qeverisjes vendore nuk është aspak i përligjur.

Pozicionin e sakte të njësive të auditimit të brendshëm e ka përcaktuar ligji "Për Menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik. Referuar këtyre ligjeve të cilat reflektojnë standardet me të përparuara ndërkombëtare auditimi i brendshëm është funksion i menaxhimit të buxhetit dhe të burimeve publike. Kësisoj titullari i njësisë se entit publik është përgjegjës për ngritjen e funksionit të auditimit të brendshëm dhe krijimin e të gjithë hapësirave të nevojshme në mënyrë që të ndihmohet menaxhimi të përmbushur përgjegjësitë e tij.

Duke u përpjekur të vlerësojmë dhe të evidentojmë disa nga shkaqet që gjenerojnë situata e mbivendosjes mendoj se me se pari ka të beje me një kuptim të hershem të rolit të auditimit i cili në pamjen e disa menaxhereve ka akoma pamjen e policit. Nga ana tjetër ai konceptohet prej tyre si një segment apo instrument për të ushtruar pushtetin, përkundër rolit të këshilltarit të menaxhimit që parashikojnë Satndartet profesionale. Rrjedhoje e këtij koncepti janë mbivendosjet në ligje të ndryshme veçanërisht ai i Prefektit që i jep atij të drejtën të auditojë organet e qeverisjes vendore. Reminishencat e funksioneve të se kaluarës të auditimit e joshin vete auditimin për t'i dhënë vetes pushtet duke e orientuar atë nga inspektimi apo nga karakteri represiv i tij.

Rrjedhoje e gjithë këtyre dukurive negative janë kostot e larta administrative që përballojnë taksapaguesit, janë shtimi i kompleksitetit dhe procedurave administrative, ngadalësimi dhe here-here paralizimi i veprimtarive menaxhuese dhe i vendimmarrjeve efikase që reflektohet tërësisht në performancën e ulet të burimeve publike

A mund të shmangen mbivendosjet dhe si ?

Eksperiencat e mira të vendeve të Europes dhe me tej, tregojnë se shmangia e mbivendosjeve të auditimit mund të behet nëpërmjet vendosjes se një bashkëpunimi institucional në mes të auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm. Ky bashkëpunim konsiston në radhe të pare në ndryshimin e filozofisë se auditimit të jashtëm lidhur me qasjen ndaj auditimit të brendshëm. Siç edhe e përmendëm qasja e deritanishme e auditimit të jashtëm ndaj auditimit të brendshëm ishte një qasje paternaliste me elemente represioni, kundrejt një qasje komplementare që kërkohet.

INTOSAI i ka kushtuar një vëmendje të veçante vendosjes se bashkëpunimit me auditimin e brendshëm dhe madje ai ka përgatitur dhe nënshkruar një marrëveshje me Institutin e Auditëve të Brendshëm. Komiteti i Standardeve të INTOSAI në Manama, Bahrein me 23-24 Prill i ka kushtuar një takim të veçante çështjes se bashkëpunimit me auditimin e brendshëm dhe domosdoshmërisë

nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi.
INTOSAI ka publikuar gjithashtu një udhëzues se si ISA e të gjitha vendeve anëtare duhet të bashkëpunoje me auditimin e brendshëm në sektorin publik për realizimin e misionit të tyre. Ky dokument në radhe të pare qartëson rolet dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm në plotësimin e përgjegjësive të tyre. Ne baze të parimeve të angazhimit të ndersjelltë, komunikimit të vazhdueshëm,mirëkuptimit dhe besimit reciprok këto institucione duhet të vendosin bashkëpunim në fushat dhe mënyrat e mëposhtme:

- Komunikimi dhe shkëmbimi planeve të auditimit dhe i strategjive të zhvillimit
- Vendosja e takimeve në një mënyrë sistematike dhe diskutimi i çështjeve me interes të përbashkët.
- Organizimi i trinimeve të përbashkëta dhe ndarja e materialeve të trajnimit.
- Zhvillimi i metodologjive të auditimit
- Përdorimi i punës se njeri tjetrit gjate auditimit.
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm
- Raportimin e deklarimeve financiare
- Vlerësimin dhe menaxhimin e riskut
- Hetimin e mashtrimit dhe korrupsionit
- Zhvillimin e procedurave të auditimit.

Ky bashkëpunim mund të realizohet në të gjitha fazat e procesit të auditimit si në atë të planifikimit të auditimit,gjate kryerjes se auditimit në fazën e raportimit dhe veçanërisht në atë të ndjekjes se rekomandimeve por të dy palët duhet të bëjnë kujdes që të shmangen disa rreziqe potenciale gjate këtij bashkëpunimi dhe që kane të bëjnë me kompromiset e besimit të cenimit të pavarësisë dhe objektivitetit,shmangien e konkluzioneve të gabuara kur përdorin punët e njeri tjetrit etj.
Përdorimi i punës se auditimit të brendshëm nga ISA është një nga mënyrat për të shmangur mbivendosjet gjate auditimit. Por INTOSAI nëpërmjet një standardi të veçante me Nr. 1620 të veçante ka porositur që të behet kujdes në këtë drejtim duke përcaktuar edhe disa kritere se kur puna e auditëve të brendshëm do të përdoret dhe përcakton se:

- puna e kryer nga auditët e brendshëm nga individë që kanë teknike adekuate
trajnimit dhe aftësi;
- Puna e auditëve të brendshëm është e mbikëqyrur, shqyrtuar dhe dokumentuara si duhet;
- Dëshmi të mjaftueshme auditimi janë marrë për të mundësuar brendshme
Auditët e brendshëm për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme;
- Konkluzionet e arritura janë të përshtatshme në rrethanat dhe se raportet e përgatitura nga auditët e brendshëm janë në përputhje me rezultatet e e punës së kryer; dhe
- Çdo përjashtime ose çështje të pazakonta publikuara nga auditorët e brendshëm janë zgjidhur si duhet.

E thënë me fjale të tjera auditët e jashtëm të ISA përpara se të përdorin punën e auditëve të brendshëm duhet të sigurohen se auditimi i brendshëm ka pasur pavarësinë dhe objektivitetin e duhur për kryerjen e auditimit, se ai nuk ka qene objekt i kufizimeve të

mundshme dhe se ai ka respektuar standardet e punës gjate kryerjes se auditimit.

Ne frymën e këtyre dokumenteve me datën 8 Maj 2012 me nismën e Kryetarit të KLSH-se z.Bujar Leskaj u nënshkrua midis tij dhe z. Ridvan Bode, ministër i Financave një marrëveshje bashkëpunimi e cila mbështetur në standardet e INTOSAI dhe IIA ka përcaktuar fushat e bashkëpunimit duke përcaktuar edhe mekanizmat përkatëse për realizimin e këtij bashkëpunimi. Kjo marrëveshje ka dhënë frytet e para në vendosjen e një bashkëpunimi me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Metodologjisë se Auditimit të Brendshëm ku kane filluar të zhvillohen trajnime të përbashkëta,janë zhvilluar ide lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e palëve në këtë marrëveshje janë përgatitur publikime etj.

Sekretariati teknik i krijuar sipas kësaj marrëveshje pritet të përcaktojë konkretisht fushat dhe veprimtaritë e bashkëpunimit si dhe modalitetet e realizimit të tyre. Pritshmëritë e këtij bashkëpunimi janë fokusuar në uljen e kostos administrative të auditimit, zgjerimin e kapacitetit të auditimit si rrjedhoje e shmangies se mbivendosjeve dhe e përdorimit të punës se auditimit të brendshëm,ndjekjen efikase të rekomandimeve, forcimin e rolit antikorrupsion të strukturave të auditimit, inkurajimin e qeverisjes se mire dhe rritjen e besimit të publikut.

Gjon Ndreja është ekspert i jashtëm pranë Kontrollin të Lartë të Shtetit

Performanca

Performanca imponuar nga standardet e auditimit

PËR NJË NDJESHMËRI MË TË LARTË MBI PERFORMANCËN E AUDITIMIT

Audituesit e performancës punojnë mbi bazën e normave profesionale të auditimit dhe kriteret që përbëjnë bazën e vendimeve të performancës. Kur vlerësohet produkti (malli apo shërbimi) i një organizate, objektivat vjetore të prodhimit, apo objektivat për të përmirësuar cilësinë ose reduktimin e kostove, përbëjnë pikat fillestare logjike. Kur vlerësohet efektiviteti i programeve të politikave, normat dhe kriteret mund të gjenden në objektivat e politikave dhe të treguesve.

PETER VAN DER KNAAP

Sipas standardit ndërkombëtar ISSAI 3000, një auditim i performancës është "Shqyrtimi i pavarur i efiçencës dhe efektivitetit të organizatave qeveritare, e veprimeve ose politikave të tyre, me kujdesin e duhur për ekonominë. [1]"

Qëllimi i auditimit të performancës është që të çojë në përmirësime. Audituesit e performancës punojnë mbi bazën e normave profesionale të auditimit dhe kriteret që përbëjnë bazën e vendimeve të performancës. Kur vlerësohet produkti (malli apo shërbimi) i një organizate, objektivat vjetore të prodhimit, apo objektivat për të përmirësuar cilësinë ose reduktimin e

INTOSAI, Udhëzuesit e Implementimit për auditimin e performancës: Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t dhe përvojës praktike, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit 3000 (2010), f. 11.

kostove, përbëjnë pikat fillestare logjike. Kur vlerësohet efektiviteti i programeve të politikave, normat dhe kriteret mund të gjenden në objektivat e politikave dhe të treguesve. Të marra së bashku, këto norma dhe kritere, dhe veçanërisht objektivat e politikave dhe treguesit, përbëjnë një kornizë relativisht të qëndrueshme të referimit. Për politikanët, politikë-bërësit dhe gjithashtu audituesit e performancës, kjo ka përparësi të rëndësishme: ajo ofron fokus, transparencë dhe parashikueshmëri. Objektivat dhe treguesit formohen lehtë për të kuptuar kornizat e referencës në një debat politik të orientuar. Normat dhe kriteret e qarta, së bashku me kontrollet e shëndosha të cilësisë në procesin e auditimit, ndihmojnë për të prodhuar raporte të besueshme mbi performancën e qeverisë.

Udhëzime e reja të INTOSAI-t: pavarësisht këtyre avantazheve, një rrezik i rëndësishëm i auditimit të performancës që fokusohet në mënyrë të vendosur në objektivat dhe treguesit është se auditorit i mungon shpjegimi i vërtetë i agjencisë zhgënjyese apo performancës së programit. Auditimet e tilla të performancës mund edhe të bëhen më pak të rëndësishme. Përafrimi i objektivave dhe treguesve gjithashtu mbart rrezikun e (1) keqkuptimit të nevojave të grupeve të interesit ", (2) rezistencës për të ndryshuar, dhe (3) sjelljes jofunksionale strategjike.

Sikurse politikani holandez dhe profesor i administratës publike Mary-Louise Bemelmans të Universitetit Videc dhe kolegët e saj kanë vënë në dukje: "Shumë shpjegime për rezultatet zhgënjyese të politikës tregojnë një "boshllëk(hendek)" mes qëllimeve të politikave të thjeshta dhe skemave në njërën anë, dhe kompleksit dhe natyrës gjithnjë në ndryshim të problemeve shoqërore në anën tjetër". Ata parashikojnë një tip të ri përgjegjësie, në të cilën auditimi i sektorit publik duhet të luajë rolin e tij duke (1) marrë një qasje dinamike më tepër se një qasje statike, (2) duke u përqendruar kryesisht në rezultate, më tepër se në proces, si dhe (3) duke theksuar nevojën për mësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm. Si pjesë e kësaj, audituesit e performancës duhet të konsiderojnë nëse synimet e politikave dhe skemat ende lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit..

INTOSAI njeh nevojën për auditime të performancës që lejojnë më shumë kompleksitet. Udhëzimet e reja të auditimit të performancës në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (Issai) 3000 nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve**:** ndikimi aktual i aktiviteteve krahasuar me ndikimin që synohej, duhet të auditohet. Ndryshe nga auditimi i pajtueshmërisë, audituesit e performancës nuk duhet të shikojnë vetëm nëse programet politike janë duke u realizuar sipas planit. As të përqendrohen shumë hollësisht nëse objektivat janë arritur, kritere janë plotësuar, dhe treguesit janë kapur. Sipas ISSAI 3000, "progresi dhe praktikat duhet të ndërtohen nga të mësuarit mbi përvojën."

Iniciativat për Promovimin e Përgjegjshmërisë në Auditimin e Performancës

Gjykata Holandeze e Auditimit (NCA) thekson nevojën për të mësuar. Audituesit duhet të jenë më të përgjegjshëm për atë që të audituarit dhe palët e interesit kanë për të thënë në lidhje me rëndësinë e pyetjeve të auditimit, kuptimin e rezultateve të ndërmjetme të auditimit, si dhe dobinë e rekomandimeve të mundshme. Për të arritur këtë, NCA ka zgjedhur në mënyrë aktive një qasje më të hapur dhe të përgjegjshme, duke përfshirë më shumë metoda pjesëmarrjeje. Duke ndjekur shembullin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, NCA ka zhvilluar metoda pjesëmarrëse në auditime të ndryshme dhe në aktivitete të tjera përfshirëse të palëve të interesit, që ekipet e auditimit mund të përdorin gjatë fazave të ndryshme të procesit të auditimit. Audituesit e NCA kanë përcaktuar për të analizuar aktorët kryesorë të politikës, grupet e tjerë të interesit si dhe interesat e tyre përkatëse. Veprime të tilla si takimet në fillim të auditimit dhe seanca debati për diskutimin e rezultateve të ndërmjetme dhe mjetet e mundshme janë konsideruar dhe kompletuar së bashku me afatin kohor të procesit të auditimit.

Ekspertët dhe panelet e palëve të interesuara janë një pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Përveç kësaj, NCA dëshiron të dijë se çfarë ndodh me rekomandimet e auditimit, pasi raportet e auditimit janë publikuar, kështu që në mënyrë aktive monitoron aktivitetet dhe kundërmasat në vijim të ministrave. Auditimet për vijueshmërinë adresojnë dy përmasa: (1) A bënë ministritë atë që premtuan se do të bënin? (2) Cilat ndryshime-pozitive dhe negative, në të vërtetë u zhvilluan në lidhje me çështjet në rrezik? Këtu, hidhen pyetje edhe më të vështira: Si arriti ndjekja e rekomandimeve të auditimit të kontribuojë në cilësinë e proceseve të zbatimit? Në çfarë shkalle u zgjidh problemi social ?

Kontrolle të realitetit: Testimi i politikave, teorive, objektivave dhe treguesve

"Kontrollet e realitetit" janë nisma me e fundit e NCA për të zhvilluar një përafrim me të përgjegjshëm ndaj auditimit të performancës. Nga viti 2009 deri me 2011 NCA kreu 20 prej tyre. në gjuhen e krijuesve dhe zhvilluesve të produktit, një kontroll realiteti është një test për t'u siguruar se një ide është e zbatueshme në boten reale. NCA qëllimisht e përdor këtë fjale disi provokative. Qëllimi i NCA është t'i japë qeverise dhe Parlamentit informacion mbi pasojat e programeve të politikave publike dhe nëse këto programe vlerësohen në publik. NCA e nisi duke pare në një numër problemesh që preknin qytetaret dhe bizneset, si dhe në mënyrat se si qeveria i përktheu këto probleme në objektiva dhe masa të politikave të saj. Pyetja qendrore ishte se kush ishte kontributi aktual i masave të politikave qeveritare për të gjetur zgjidhjet, gjykuar nga (1) interesat e grupit të prekshëm të politikave (qytetaret, bizneset ose institucionet që po kalojnë një seri të veçante problemesh) dhe nga (2) provat në diskonim të efektivitetit të programit?
NCA përdori pyetjet e mëposhtme në auditimet e saj:

- Si lidhen këta grupe interesi (veprimtare kyçe) me objektivat, kriteret dhe logjika e ndërhyrjes (ose teoria e politikave) e qeverise qendrore?

- A i njohin këta veprimtare rendësinë dhe vlerën e këtyre elementeve dhe a i përdorin ata këto?

- Si i vlerësojnë ata ndërhyrjet aktuale ose mjetet e politikave, si dhe mënyrën se si programi i politikave është zbatuar?

- Në çfarë mase arriti të këtë efekt shpenzimi i planifikuar?

- Çfarë efekti konkret patën politikat e zbatuara mbi ata që ishin të përfshirë drejt për se drejti?

- Çfarë informacioni u dha nga qeveria qendrore lidhur me efektivitetin e masave të marra?

Audituesit e NCA intervistuan përfaqësues nga grupet e interesit dhe veprimtare të tjerë kyçe, për të zbuluar se çfarë mendonin ata rreth objektivave zyrtare dhe kritereve të ndërhyrjeve ose masave të politikave qeveritare. Përveç kësaj, u ekzaminua edhe përdorimi aktual i skemave të politikave nga grupet e interesit, duke përdorur të dhëna të disponueshme nga agjencitë, statistikat dhe raportet e monitorimit dhe të vlerësimit. Aty ku ishte e përshtatshme dhe e mundshme, audituesit vrojtuan negociata të jetës reale, takime, transaksione dhe kështu me radhë. Se fundmi, rezultatet iu vunë përpara politikëbërësve për të pasur reagimin e tyre. Dy shembuj të këtyre kontrolleve të realitetit përfshijnë përmirësimin e sigurisë se bizneseve të vogla dhe përmirësimin e efiçencës se energjisë në shtëpitë. në rastin e pare, një skeme subvencioni i inkurajon bizneset e vogla që të marrin pasa parandaluese kundër krimit. një element kyç në programin e politikave ishte kompensimi i bizneseve të vogla për koston e këshillimit të përshtatur për to në përmirësimin e sigurisë. në praktike, megjithatë, shume nga bizneset punësuan

Në praktike, megjithatë, shume konsulentë dhe specialiste të sigurisë të punësuar punojnë me formate standarde. NCA gjeti që edhe pse 80 për qind e grupit të interesit (bizneseve të vogla) e konsideronin kontrollin e sigurisë të dobishëm, vetëm 8 për qind e tyre mendonin se ky skanim (kontroll) ia vlente 350 euro. në shembullin e dyte, në të tre subvencionet shtetërore për të përmirësuar efiçencën e energjisë në shtëpitë ekzistuese, NCA gjeti një tension të qarte mes objektivit për t'i lehtësuar pronaret e shtëpive nga barrat administrative të aplikimit dhe deklarimit të kostove dhe mosdashjes se këtyre pronareve për t'ua lëne këto detyra kontraktorëve. NCA ia raportoi gjetjet e saj Parlamentit në maj 2010 dhe 2011. Kontrollet e realitetit zbuluan se lidhja mes politikave dhe praktikes linte shume për të dëshiruar. Edhe pse produktet e pritura (grantet, subvencionet, faqet në internet dhe këshillimi) ishin në pjesen me të madhe të realizuara sipas planit (siguruar efektiviteti), përfituesit ose nuk ishin shume të familjarizuar me to, ose nuk mund t'i përdornin ato, ose nuk

panë nevoje për t'i përdorur, ose shprehen një nevoje me të madhe për masa të tjera. Zgjedhja e instrumenteve mund të karakterizohet si me baze ofertën (dëshirën dhe mundësitë e qeverise për të dhëne shërbime). NCA shpesh vërejti një përafrim "pushke" në politikat qeveritare. në vend të ndërhyrjeve me baze provat në terren-ku do të kishte një marrëdhënie të qarte dhe të bazuar mire mes ndërhyrjes dhe efektit që kërkohet prej saj- politika qeveritare në me të shumtën e herës zgjodhi subvencionin ose incentivat të tjerë financiare. "Paraja bën çudira" duket se ka qene perspektiva dominuese në këto programe, edhe atëherë kur faktorë të tjerë(kulturore, teknike ose juridike) ishin prapa problemeve shoqërore. Kontrollet e realitetit treguan rendësin që politike-bërësit të testojnë aktivisht nëse të vërtetat dhe opinionet e tyre pas politikave që zbatojnë kane kuptim, si përpara futjes se masave të këtyre politikave, ashtu edhe gjate zbatimit të tyre. Vlerësimet paraprake, megjithatë, shpesh mungojnë. NCA gjeti një mungese të dhënash të rëndësishme dhe informacioni që të ndiqnin zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve të politikave dhe të bënin korrigjimet e duhura. në shume raste NCA gjeti se mënyra se si ishin projektuar ndërhyrjet e politikave qeveritare çonin në procese zbatimi shume komplekse. Lidhjet e shumta mes qeverise, organizatave ndërmjetëse, veprimtareve kyçe dhe grupeve përfituese të ndërhyrjeve krijonin kanale shume të gjata dërgimi të shërbimeve dhe rrezikun se shume duar ishin përfshirë. Si rezultat, politikat e zyrës dhe logjika institucionale mund të dëbojë rendësin shoqërore të ndërhyrjes, duke vene në rrezik si efiçencën ashtu dhe efektivitetin e saj.

Konkluzione dhe sfida

Ndërsa objektivat dhe treguesit e politikave janë ndihmues të rëndësishëm, audituesit e performancës duhet gjithnjë të jene të ndërgjegjshëm për rreziqet që ato sjellin. Megjithatë, të bëhesh me përgjegjës nuk është një proces i lehte. Nismat e fundit të NCA për të sjelle me shume përgjegjësi në auditimet e saj të performancës ilustrojnë sfidat në këtë proces. Se pari, është problemi i kohës. Paralajmërime të hershme në formën e kontrolleve të realitetit mund të parandalojnë programe inefiçente ose infektive që të shkojnë nga shiu në breshër. Ndërkohë, që për ministritë dhe agjencitë, auditimet dhe vlerësimet e hershme mund të çojnë në një ndjesi që programit nuk i është dhënë shansi për ta demonstruar vlerën e tij. Se dyti, përgjegjësia nuk duhet keqkuptuar për të përdorur shqetësimet dhe ankesat e veprimtareve kyçe në mënyrë diskriminuese kundër agjencive që auditohen. është relativisht e lehte të gjesh ankesa dhe pabarazi mes synimeve të një programi të politikave publike dhe nevojave dhe dëshirave të grupit përfitues. Edhe atëherë kur ndërhyrjeve qeveritare duken se u mungon rëndësia në sytë e përfituesve, mund të këtë arsye shume të mira për këto ndërhyrje. Se treti, duhet të këtë drejtësi në kritiken ndaj përdorimit të objektivave dhe treguesve të performancës se politikave. Kontrollet e realitetit treguan se një format nuk u qëndron të gjithave, kur vjen puna e nismave të politikave. Megjithatë, sërisht objektivat dhe kriteret janë dhe

do të jene gjithnjë versione të thjeshtëzuara të realiteteve të dëshiruara, të cilat mund të sjellin përqendrimin e nevojshëm për debat, zbatim dhe vlerësim. Auditimi përgjegjës i performancës nuk nënkupton që audituesit duhet të braktisin kriteret e tyre tradicionale për gjykim, ose të bëhen marres pasive të interpretimeve dhe kritereve të te tjerëve. As edhe që audituesit duhet t'i bashkohen korit ankues që mohon çdo lloj përfitimi nga objektivat dhe treguesit e performancës të politikave qeveritare. në një shoqëri demokratike, qeveria ka një detyrim moral të organizoje përgjegjësinë dhe reflektimin e saj. Me ngritjen e internetit dhe medieve të reja shoqërore, ka tani me shume mundësi se kurrë që të angazhosh publikun e gjere në politike-bërjen dhe vlerësimin. Të mësuarit dhe organizmi i të mësuarit të orientuar nga politikat janë thelbësore në këtë proces dhe këtu auditimi i performancës ka një rol të rëndësishëm për të luajtur.

Peter van der knaap është Drejtor i Auditimit të Performancës në Gjykatën e Auditimit të Holandës
peter.vanderknaap@rekenkamer.nl

**Shkëputur nga: International Journal of Government Auditing, Prill 2012, Vol. 39, Nr. 2, faqe 10-13*
Përshtati në shqip: Alkida Llakaj

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

VEPRIMTARI TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2012

1. Me datën 20 janar 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit finalizoi në praninë e përfaqësuesve të medias së shkruar dhe audiovizive, si dhe përfaqesuesve nga shoqëria civile, Analizën Vjetore të Veprimtarisë për vitin 2011.

Foto nga analiza vjetore e KLSH-së

Në këtë analizë pune asistoi dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, z.Adriatik Llalla.

2. Me 19 janar 2012, Kryeministri Berisha priti në një takim Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Bujar Leskaj, të cilit i uroi zgjedhjen në këtë post dhe suksese në realizmin e detyrës së tij.

Foto nga takimi i Kryeministrin Berisha me Kryetarin e KLSH-së

Kryeministri theksoi se lufta kundër korrupsionit dhe transparenca e qeverisjes janë gur themeli në një shtet demokratik.

Duke e vlerësuar KLSH si një institucion themelor në këtë drejtim, Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë punën e këtij institucioni.

3. Kryetari i Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zoti Bujar Leskaj, zhvilloi më 19 janar 2012 një takim miqësor me Profesorin e shquar të Financave Publike pranë Universitetit të Bambergut në Gjermani dhe një sërë Universitetesh të tjera Europiane, Prof.Dr Heinz-Dieter Wenzel, i cili mban dhe titullin Doctor Honoris Causa nga Universiteti Publik i

Tiranës dhe nga shumë universitete të tjera prestigjioze.

Foto nga takimi i Dr. Bujar Leskaj me Prof.Dr Heinz-Dieter Wenzel.

Kontributi i Profesor Wenzel do të jetë mjaft i vlefshëm për institucionin e KLSH, në rritjen e forcimin e marrëdhënieve në fushën e trajnimeve dhe specializimeve, ku në fokus të tyre do të jetë zgjerimi i bashkëpunimit me institucionin homolog të Landit të Bavarisë

4. Me 2 shkurt 2012, Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi priti Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj.

Foto nga takimi i Presidentit Topi me Kryetarin e KLSH-së.

Në këtë takim të parë institucional, Kryetari i Shtetit e përgëzoi z.Leskaj për zgjedhjen në këtë post të lartë me përgjegjësi duke i uruar suksese dhe punë të mbarë në detyrën e tij në krye të një institucioni të pavarur kushtetues.

5. Më 20 mars 2012, KLSH paraqiti përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit Raportin mbi Veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2011.

Foto nga Komisioni i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në fjalën e tij, Kryetari i KLSH z. Leskaj u përqendrua në punën e bërë nga institucioni për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të datës 2 qershor 2011, në performancën e KLSH gjatë vitit 2011, në masat reformuese të deritanishme dhe në objektivat e programuara për vitin në vazhdim 2012.

6. Më 25 janar 2012, z. Bujar LESKAJ priti në një takim z. Joop VROLIJK dhe z. Jan Pieter LINGEN, përfaqësues të SIGMA-s, të cilët ndodhen në Tiranë në kuadrin e përpilimit të raportit vlerësues për KLSH, për vitin 2011.

Gjatë takimit me përfaqësuesit e SIGMA-s, z.Leskaj shprehu falënderimet dhe vlerësimin e tij për raportet e hartuara dhe për mbështetjen që SIGMA i ka dhënë KLSH-së gjatë këtyre viteve si dhe theksoi se ky bashkëpunim do të forcohej më shumë gjatë mandatit të tij si Kryetar i KLSH-së. Z.Leskaj, paraqiti një ekspoze të përgjithshme të objektivave dhe u ndal në disa prej pikave kyçe lidhur me situatën në KLSH, duke

theksuar si më të rëndësishme çështjen e reformës ligjore dhe të ndryshimit të ambienteve për KLSH-në.

Z.Leskaj u dorëzoi të dy përfaqësuesve të SIGMA-s, kopjen në anglisht të Projekt-Idesë së paraqitur prej tij në Komisionin e Ekonomisë dhe të ripunuar me stafin e KLSH-së, e cila do të shërbejë si një bazë për krijimin e Planit të ardhshëm Strategjik të institucionit, 2013-2015, ku sigurisht do të jetë vendimtare edhe mbështetja dhe sugjerimet dhënë nga SIGMA. Mbështetjen e SIGMA-s, z.Leskaj e konsideroi si mjaft të rëndësishme edhe për përftimin nga KLSH-ja të projekteve të binjakëzimit në të ardhmen, me qëllim rritjen profesionale të institucionit dhe thithjen e eksperiencave më të mira.

Përfaqësuesit e SIGMA-s e falënderuan nga ana e tyre z.Leskaj për mikpritjen dhe për dhënien e Projekt-Idesë. Ata theksuan se mbështetja e SIGMA-s do të ishte e plotë për KLSH-në si në drejtim të mendimeve apo sugjerimeve, në këtë rast për reformën ligjore, por edhe konkrete, në zhvillimin e trajnimeve apo projekteve të binjakëzimit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të institucionit.

7. Në datat 15-16 shkurt 2012, me ftesë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë, një delegacion i nivelit të lartë i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës dhe personalitet i auditimit ndërkombëtar. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dhe intensifikimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Gjatë takimit me homologun kosovar, Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj e njohu z.Olofsson me një ekspoze të detajuar të hapave historike të zhvillimeve institucionale, ku një vend të veçantë zë dhe strategjia e mbështetur në projekt-iden, në të cilën përfshihet vizioni koherent mbi modernizimin e institucionit të KLSH-së.

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Dr. Bujar Leskaj dhe z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës

Z.Olofsson shprehu kënaqësinë që ndodhej në Tiranë dhe prezantoi etapat kryesore të veprimtarisë së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, e cila është në hapat e saj të parë dhe përpjekjet që po ndërmerren, si në rekrutimin e personelit auditues ashtu dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Më 15 shkurt, në praninë e organeve të ndryshme të medias u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje konsiston në respektimin e reciprocitetit dhe bashkëpunimit të përbashkët dhe dobiprurës, si dhe në principet e

implementuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Kontrollit (INTOSAI) dhe Organizata Europiane e Institucioneve të Larta të Kontrollit (EUROSAI). Në këtë marrëveshje palët shprehin vullnetin e tyre të përbashkët për të bashkëpunuar në zbatimin e plotë të standarteve ndërkombëtare të sektorit të auditimit publik dhe praktikave më të mira Europiane, shkëmbimin e eksperiencave në zhvillimin e institucioneve respektive, si dhe prezantimin e Fjalorit të Auditimit Publik Shqiptar të standartizuar.

Z. Olofsson vlerësoi vizionin e ri të KLSH dhe punën që po zhvillohet në këtë institucion për përmirësimin e cilësisë së auditimeve financiare dhe për thellimin e vëmendjes ndaj auditimit të performancës, duke kërkuar një bashkëpunim të gjerë me institucionet e tjera të shtetit që luftojnë korrupsionin. Ai dha këshilla shumë të vyera për drejtimet e kooperimit ndërkombëtar të KLSH dhe u shpreh i gatshëm të vijojë me nisma konkrete bashkëpunimin e nisur.

8. Më 27 shkurt 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në prani dhe të përfaqësuesve të organeve mediatike, me qëllimin e krijimin e një bazë të dhënash për raste të dyshuara korrupsioni në administratën publike.

Në ceremoninë e zhvilluar në ambientet e ILDKP-së, Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj, dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së, z.Adriatik Llalla, shprehën impenjimin për koordinimin ndërinstitucional për ndëshkimin e zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin publik.

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së, z.Adriatik Llalla

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Leskaj, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e veprimit ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit, si edhe u shpreh se "sot po formalizojmë një marrëveshje, e cila tashmë ka nisur të aplikohet në praktikë. Mendojmë se ka çështje konkrete që kanë nevojë për kontroll ndërinstitucional, me qëllim efikasitetin në luftën kundër konfliktit të interesave e fshehjes së pasurisë dhe, në përgjithësi, kundër veprimeve abuzive të zyrtarëve me pushtetin publik.

Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP, z. Llalla, e cilësoi Marrëveshjen si një moment shumë të rëndësishëm në aktivitetin ndërinstitucional. "Dokumenti i firmosur sot është një mekanizëm më shumë në luftën kundër korrupsionit, pasi dy institucionet kanë një bazë të dhënash mbi raste të dyshuara të abuzimit me pushtetin publik. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të krijohen lehtësira të mëdha për shkëmbimin e informacionit në një kohë shumë të shpejtë, e cila do të shoqërohet me efikasitet të lartë dhe forcë goditëse më të madhe".

9. Më 8 mars 2012. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z.Bujar Leskaj takoi Përfaqësuesen e Përhershme të Bankës Botërore në Shqipëri, Znj. Kseniya Lvovsky dhe z.Rajeev K. Swami, Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore të BB .

Z. Leskaj vlerësoi kontributin e Bankës Botërore për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe institucioneve të tjera shtetërore të vendit dhe u shpreh optimist në ndihmën konkrete në nivel të ekspertizës që ky institucion prestigjoz ndërkombëtar mund t'i ofrojë KLSH-së.

Ai i prezantoi zj. Lvovsky përparësitë strategjike të KLSH-së, sikurse janë intensifikimi i punës për zbatimin e standardeve të përditësuara të INTOSAI dhe rritja e performancës së stafit të institucionit në auditimin e performancës dhe në atë financiar, krahas thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij.

Nga ana e saj, Zj. Lvovsky e uroi Kryetarin Leskaj për këndvështrimin e ri strategjik të institucionit, duke cilësuar se KLSH ka një pozicion shumë jetik për t'u dhënë jo vetëm donatorëve, por edhe taksapaguesve shqiptarë sigurinë se paratë e tyre shpenzohen si duhet.

Ajo premtoi se Banka Botërore do t'i shikonte shumë shpejt mundësitë konkrete të saj për dhënien e asistencës teknike për KLSH.

10. Më 23 mars 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Autoriteti i Konkurrencës nënshkruajnë një Marrëveshje Bashkëpunimi, të nisur nga interesi dhe ndjeshmëria e qytetarëve si taksapagues dhe konsumatorë për efiçiencë e përgjegjshmëri maksimale të administratës publike në shpenzimin e fondeve publike.

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Dr. Bujar Leskaj dhe Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Prof. As. Dr.Lindita Lati.

Të dyja institucionet kanë vënë re se interesat e qytetarëve preken ndjeshëm nga deformimet e kontratave publike në proceset e prokurimeve, ankandeve, koncesioneve, apo çdo forme tjetër të partneritetit publik-privat, si dhe nga fakti që zbatimi i këtyre kontratave luan një rol të rëndësishëm në tregun vendas, duke ndikuar edhe në shkallën e konkurrencës, si dhe në shfaqjen e dukurive si kufizimi, pengimi apo deformimi i konkurrencës në treg. Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të njoftojë në një kohë sa më të shpejtë Autoritetin e Konkurrencës për rastet kur gjatë auditimeve të tij konstatohen praktika të administratës publike, ose kontrata administrative si prokurime, ankande, koncesione etj. që mund të ndikojnë negativisht në shkallën e konkurrencës.

Ndërsa Autoriteti i Konkurrencës merr përsipër që në përfundim të kontrolleve apo hetimeve të tij, në rast zbulimi të praktikave abuzive apo arbitrare që cënojnë interesat pasurore të shtetit, t'i dërgojë sa më shpejtë KLSH një kopje të dokumenteve të nevojshme.

11. Më datën 23 Prill 2012, në ambientet e KLSH-së, u nënshkruan gjashtë marrëveshje bashkëpunimi mes KLSH-së dhe disa prej organizatave të pavarura (OJF) më të spikatura të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, përkatësisht me lëvizjen "Alternativa Civile", e drejtuar nga z. Mentor Kikia; me "Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë", e drejtuar nga z. Sami Neza; me "Institutin e Studimeve Bashkëkohore", i drejtuar nga z. Artan Hoxha, me "Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim", i drejtuar nga z. Sotiraq Hroni; me "Transparency Internacional në Shqipëri", drejtuar nga z. Lutfi Dervishi dhe me "Lëvizjen Evropiane Shqipëri", drejtuar nga z. Gledis Gjipali.

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj me lëvizjen "Alternativa Civile", e drejtuar nga z. Mentor Kikia

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj me "Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë", e drejtuar nga z. Sami Neza.

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj me "Institutin e Studimeve Bashkëkohore", i drejtuar nga z. Artan Hoxha

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj me "Transparency Internacional në Shqipëri", drejtuar nga z. Lutfi Dervishi

Foto nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes nga Kryetari i KLSH-së Bujar Leskaj me "Lëvizjen Evropiane Shqipëri", drejtuar nga z. Gledis Gjipali.

Marrëveshjet lidhen nën moton e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit, INTOSAI, "Experentia mutual ominibus prodest"

(Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve) dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së dhe shoqatave, si vrojtime, prognoza dhe studime të përbashkëta, pjesëmarrje reciproke në seminare, simpoziume, konferenca, në luftën kundër korrupsionit, mundësisht parandalimin e tij si dhe rritjen e transparencës së institucioneve publike.

Për KLSH-në është e vyer eksperienca dhe ekspertiza e organizatave të shoqërisë civile për realizimin e analizës se riskut në përzgjedhjen e auditimeve dhe kontrolleve të tij, si dhe në hartimin e rekomandimeve dhe raporteve për përmirësimin e performancës së institucioneve që auditon.

Marrëveshjet parashikojnë edhe mundësinë e shkrimit të projekteve të përbashkëta, apo aplikimit të tyre pranë donatoreve të interesuar, për forcimin real të luftës ndaj korrupsionit, luftë e cila mund të ketë sukses vetëm me punë të përbashkët në sistem.

12. Më datë 25 prill 2012 në Ljubjanë të Sllovenisë, Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, Dr. Igor Šoltes. Marrëveshja u nënshkrua në prani të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni, z. Sandër Kovaçi.

Delegacioni shqiptar i KLSH-së, i kryesuar nga kryetari Dr. Bujar Leskaj, ndodhej në Ljubjanë me rastin e një vizite i ftuar nga presidenti i Gjykatës Sllovene të Auditimit, Dr. Igor Šoltes.

Kryetari i KLSH Dr. Bujar Leskaj gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, Dr. Igor Šoltes

Marrëveshja ishte frut i një korrespondence tremujore. Ajo u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (INTOSAI) si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem (EUROSAI). Në Deklaratën e Limës (Neni 15) theksohet se shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencës dhe i informacionit shërben si një mjet i mirë ndihmues për institucionet e kontrollit të lartë, për të përmbushur detyrën e tyre.

Kjo përfshin shkëmbimin e mësimeve të nxjerra, sikundër trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodat e auditimit. Duke patur parasysh ndryshimet në kuadrin ligjor dhe ekonomik të secilit shtet, është e mundur të përdoret eksperienca e fituar nga të tjerët si bazë rritjen e efektivitetit dhe efiçiences së auditimit.

Dokumenti i nënshkruar është shumë i rëndësishëm për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Slloveni është modern, një ndër institucionet më profesionale në Evropë. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e

Llogarive e Sllovenise do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në çertifikimin e deklaratave financiare. Ata po ashtu do të eksplorojnë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet e KLSH në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.

13. Më 8 maj 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Financave nënshkruan një Marrëveshje

Kryetari i KLSH Dr.Bujar Leskaj gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrin e Financave, Dr. Ridvan Bode

Bashkëpunimi, në bazë të legjislacionit vendas në fuqi dhe të standardeve ndërkombëtare të auditimit të jashtëm suprem të organizatës INTOSAI.Ministria e Financave dhe
Kontrolli i Lartë i Shtetit janë institucione kyçe në mirëmenaxhimin e financave të shtetit. E para i menaxhon këto financa, e dyta e auditon këtë menaxhim, mbi bazën e parimeve të ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçiencës së përdorimit të burimeve. Interesi i përbashkët është mirëmenaxhimi i parave të taksapaguesve shqiptarë.
Marrëveshja lidhet mbi bazën e Nenit 26 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm, i cili kërkon që strukturat e përgjithshme të këtij auditimi të bashkëpunojnë me Kontrollin Lartë të Shtetit në shkëmbimin e çdo informacioni të vlefshëm, që lidhet me sistemin e auditimit, në dërgimin e programeve vjetore të punës, për të shmangur mbivendosjet në procesin e auditimit, etj., mbi bazën e nenit 70 të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, si dhe bazuar në Standardin 9150 të INTOSAI:"Koordinimi dhe Bashkëpunimi mes Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik".
Ministri i Financave Bode theksoi gjatë nënshkrimit se me këtë bashkëpunim mund të ulet kosto e auditimeve dhe të rritet efiçienca e tyre. Kryetari i KLSH Leskaj nënvizoi kërkesat e standardeve ndërkombëtare të fushës për këtë bashkëpunim mes auditimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe u shpreh se pavarësia e institucionit të tij kushtetues me këtë ndërveprim nuk cënohet, përkundrazi, rritet, pse rritet edhe presioni i përbashkët kundër akteve të mashtrimit financiar dhe korrupsionit.
Kjo marrëvëshje bashkëpunimi parashikon komunikimin e ndërsjelltë të planeve dhe strategjive të auditimit të të dyja institucioneve, dokumentimin e proceseve operacionale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit; si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion.

14 Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj zhvilloi më dt. 17 maj 2012 një takim me znj. Ina Rama, Prokurore e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme.

Foto nga takimi i Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar Leskaj me Prokuroren e Përgjithshme znj. Ina Rama.

Gjatë takimit u vlerësua puna e përbashkët në luftën kundër abuzimit dhe korrupsionit dhe u diskutua rreth rritjes së bashkëpunimit të mëtejshëm midis dy institucioneve. Gjithashtu u trajtuan problematika të ndryshme për çështje të veçanta, si përcaktimi më i detajuar i shkeljeve që përbëjnë vepër penale, i rasteve të sjella tej afateve të parashkrimit, etj.

U ra dakort nga ana e KLSH dhe Prokurorisë se Përgjithshme puna për zgjidhjen e këtyre problemeve, gjë e cila do të ndikojë në rritjen e efikasitetit të luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar me pronën publike.

Në takimin midis Prokurores së Përgjithshme, znj. Ina Rama dhe Kryetarit të KLSH, z. Bujar Leskaj, u diskutua gjithashtu edhe mbi referencat për nënshkrimin e një Marrëveshjeje të re Bashkëpunimi midis dy institucioneve, me synimin e forcimit së bashkërendimit të punës.

15. Në datën 23 maj, në Varshavë të Polonisë, z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Zyrës polake të Auditimit Suprem (NIK), z. Jacek Jazierski.

Foto nga takimi i z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Presidentin e Zyrës polake të Auditimit Suprem (NIK), z. Jacek Jazierski.

Marrëveshja u nënshkrua në prani të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Poloni, z. Florent Çeliku.

Marrëveshja prodhoi rivitalizim të marrëveshjes së mëparshme të viteve 2006-2009. Ajo u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (INTOSAI) si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem (EUROSAI).

Dokumenti i nënshkruar është me shumë vlera për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Poloni është modern, një ndër institucionet më të mëdha dhe profesionale në Evropë. Presidenti i tij z. Jazierski ka qenë deri në fund të vitit të kaluar President i EUROSAI dhe përfaqëson një nga figurat më të njohura në komunitetin e auditimit suprem.

Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Zyra e Auditimit Suprem e Polonisë do të shkëmbejnë eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese. Në fillim të korrikut 2012, një grup prej 10-15 audituesish nga KLSH do të trajnohen

për auditimin e performancës në Qendrën e Trajnimeve të NIK në Poloni, ndërsa në shtator ekspertë të metodologjisë anti-korrupsion në institucionin polak të auditimit priten të vijnë për një aktivitet të përbashkët në Tiranë.

Profil

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARË TË INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIT

INTOSAI

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI INTOSAI-N

INTOSAI është organizata profesionale e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për vendet që i përkasin Kombeve të Bashkuara (OKB) ose agjencive të saj të specializuara dhe njihet si organi ndërkombëtar që përfaqëson SAI-t. SAI-t luajnë një rol të rëndësishëm në auditimin e operacioneve dhe llogarive të qeverisë, si dhe në promovimin e menaxhimit të shëndoshë financiar të saj. INTOSAI ofron forume për audituesit qeveritarë nga e gjithë bota, për të diskutuar çështje me interes të përbashkët dhe për të qenë të informuar me zhvillimet më të fundit rreth auditimit, standardeve profesionale dhe praktikave më të mira. Në përputhje me këto objektiva, moto e INTOSAI-t është "nga eksperienca e përbashkët, fitojnë të gjithë."

E themeluar në vitin 1953, gjatë Kongresit të parë në Kubë të 34 SAI-ve, INTOSAI ka 189 anëtarë me të drejta të plota dhe 4 anëtarë të asociuar. Që atëherë, INTOSAI ka ofruar një kuadër të institucionalizuar, për të përmirësuar pozitën profesionale dhe kapacitetet e SAI-ve.

Në vitin 1977, INTOSAI miratoi Deklaratën e Limës, me udhëzime për rregullat e auditimit. Kjo deklaratë është një ndërthurje e qëndrimit filozofik dhe konceptual të INTOSAI-t me Deklaratën e Pavarësisë së Meksikë dhe thekson parimet e pavarësisë dhe vlerat demokratike. INTOSAI nxjerr standarde ndërkombëtare dhe udhëzime për auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të

performancës, si dhe ofron udhëzime për mirë qeverisjen.

INTOSAI ka pesë gjuhë zyrtare: Arabisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe spanjisht. Ai është një grup vullnetar, suksesi i të cilit varet nga mbështetja e vazhdueshme profesionale dhe financiare e anëtarëve të tij. INTOSAI pranon se pika e tij e fortë, qëndron në diversitetin kulturor, gjuhësor, dhe qeveritar të anëtarëve së tij dhe kërkon një përfaqësim të balancuar të rajoneve dhe sistemeve të auditimit.

INTOSAI operon nëpërmjet konsultimeve dhe konsensusit, pavarësisht nga madhësia gjeografike apo fuqitë ekonomike. Ai thekson respektin për sovranitetin kombëtar dhe për barazinë e anëtarëve të tij.
INCOSAI, kongresi i mbajtur çdo 3 vjet në vende të ndryshme, është organi më i lartë i INTOSAI-t, i cili përfshin të gjithë anëtarësinë. Çdo vend ka një votë, dhe asnjë prej tyre nuk ka të drejtën e vetos. Bordi Drejtues, i përbërë nga 18 SAI-anëtare, është përgjegjës për anëtarësinë.

INTOSAI ka partneritet edhe me organizata të tjera: Bashkimi Ndër Parlamentar (IPU), Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), Instituti i Auditueseve të Brendshëm (IIA), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), si dhe Banka Botërore dhe komunitete të tjerë donatorësh. Gjithashtu, INTOSAI bashkëpunon edhe me OKB-në, në promovimin e mirë qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit.

INTOSAI bën pjesë në një marrëveshje historike me 15 organizata, duke përfshirë institucionet ndërkombëtare të donatorëve dhe agjencitë e zhvillimit të vendit, për të rritur kapacitetin e zhvillimit të SAI-ve rreth botës. Ky Memorandum Mirëkuptimi, i nënshkruar në Tetor të vitit 2009, përbën themelet për forcimin e kapaciteteve të Sai-ve, për të rritur efektivitetin e tyre si instrumente të llogaridhënies, transparencës, mirë qeverisjes dhe anti-korrupsionit, në vendet e tyre. Sipas Statutit të INTOSAI-t, Sekretari i Përgjithshëm i tij është Audituesi i Përgjithshëm i Austrisë dhe selia e tij është në Vjenë. Drejtori i Planifikimit Strategjik (DSP) i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm dhe në konsultim me të, siguron arritjen e objektivave strategjike. Detyrat kryesore të Sekretariatit të Përgjithshëm janë, të veprojë si një urë lidhëse, si brenda INTOSAI-t, ashtu dhe me partnerët e jashtëm, për të vënë në dukje punën dhe cilësinë e INTOSAI-t dhe anëtarëve të tij. Gjithashtu, Sekretariati i Përgjithshëm, punon për të rritur rolin e INTOSAI-t dhe anëtarëve të tij, si institucione auditimi të pavarur, kompetent dhe efektiv, duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe besueshmërinë për të mirën e të gjithëve. Në vitin 2001, SAI Norvegjez, ndërmori nismën "Iniciativa për Zhvillim" e INTOSAI-t, ndërsa Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA, publikon Gazetën Ndërkombëtare të Auditimit të Qeverisë.

Detyra kryesore e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), është që të

shqyrtojnë nëse fondet publike janë shpenzuar në mënyrë ekonomike dhe efikase, në përputhje me rregullat ekzistuese. SAI-t duhet të jenë të pavarur nga subjektet që ata auditojnë dhe duhet të jenë të mbrojtur nga çdo formë ndikimi nga jashtë. Është gjithashtu e rëndësishme, që metodat e tyre të auditimit, të bazohen në njohuritë aktuale shkencore dhe teknike dhe që audituesit të kenë kualifikimet e duhura profesionale, si dhe integritetin moral. Vetëm një auditim i jashtëm, i pavarur, në bashkëpunim me metodologjitë dhe stafin profesional, mund të garantojë një raportim të paanshëm, të besueshëm, objektiv dhe rezultativ. INTOSAI ofron mbështetje të ndërsjellë për SAI-t dhe nxit shkëmbimin e ideve, njohurive dhe përvojës mes tyre. Ai gjithashtu, siguron që SAI-t të dëgjohen brenda bashkësisë ndërkombëtare dhe promovon përmirësim e vazhdueshëm mes anëtarëve të tyre.

Gjatë periudhës së planifikimit strategjik 2005-2010, vëllimi i madh i aktiviteteve të INTOSAI-t, ndihmoi në plotësimin e nevojave profesionale dhe kërkesave të SAI-ve. Ndër të tjera, këtu përfshihen miratimi i Deklaratës së Meksikës, mbi pavarësinë e SAI-ve, si dhe miratimi i Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (Issai).
Udhëzime për Mirë Qeverisje (INTOSAI GOV). Komiteti për Standarde Profesionale dhe Komiteti për Shkëmbimin e Njohurive, kanë zhvilluar një numër të konsiderueshëm standardesh, udhëzimesh dhe praktikash më të mira për komunitetin INTOSAI. Prioriteti kryesor strategjik për periudhën e ardhshme, do të jetë ndihma ndaj SAI-ve, në zbatimin e kuadrit Issai, në mënyrë sa më të suksesshme. Veç kësaj, krijimi i një Komiteti Drejtues të Shkëmbimit të Njohurive, do të rriste efikasitetin e procesit të shkëmbimit të njohurive. Komiteti për krijimin e Kapaciteteve, ka zhvilluar edhe një sërë udhëzuesish dhe materialesh, të tilla si Ndërtimi i Kapaciteteve në SAI, projekte të cilat financohen nga donatorët. Këto materiale, të cilat janë ndihmë e madhe për INTOSAI-n, anëtarët e tij dhe partnerët e tyre, kanë për qëllim të ndihmojnë, të udhëzojnë dhe të monitorojnë projektet e krijimit të kapaciteteve. Për më tepër, Strategjia e Komunikimit të INTOSAI-t, ka përmirësuar dhe forcuar ndjeshëm komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) mes INTOSAI dhe Komunitetit të Donatorëve, theksoi fokusin strategjik të INTOSAI-t në krijimin e kapaciteteve. Ky Memorandum, vendos një bashkëpunim për të forcuar kapacitetin e SAI-ve, për të rritur efektivitetin e tyre si instrumente të përgjegjshmërisë, transparencës, mirë qeverisjes dhe anti-korrupsionit në vendet e tyre. Si pjesë e financimit të donatorëve, zhvillimi i planeve strategjike dhe zhvillimi në të gjithë organizatën, do të jetë gjithashtu me prioritet të lartë në axhendën e INTOSAI-t për planin e ri strategjik.
Mbështetja e ndërtimit të kapaciteteve institucionale mes SAI-ve, për të lehtësuar punën e tyre, do të jetë një nga prioritetet strategjike të periudhës së ardhshme. Dokumenti shoqërues i

këtij plani strategjik, është Raporti i INTOSAI-t mbi Planin Strategjik 2005-2010, i cili përshkruan rezultatet pas zbatimit të planit të parë strategjik dhe paraqet arritjet, si dhe një strukturë organizative më të detajuar.

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), vepron si një organizatë mbrojtëse për komunitetin e auditimit të jashtëm të qeverisë. Për më shumë se 50 vjet, ajo ka ofruar një kornizë të institucionalizuar mbi institucionet supreme të auditimit, për të nxitur zhvillimin dhe shkëmbimin e njohurive, për të përmirësuar auditimin e qeverisë dhe rritjen e kapaciteteve profesionale në mbarë botën, si dhe për të forcuar ndikimin e SAI-ve anëtare në vendet e tyre përkatëse. Në përputhje me moton e INTOSAI-i, 'Experientia mutua omnibus prodest', shkëmbimi i përvojës mes anëtarëve të INTOSAI-t, si dhe gjetjet nga auditimi, janë një garanci se auditimi i qeverisë vazhdimisht përparon me zhvillime të reja.

INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur dhe jo-politike. Ajo është një organizatë jo-qeveritare, me status special konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të Kombeve të Bashkuara. INTOSAI u themelua në vitin 1953 me iniciativë të Emilio Fernandez Camus, atëherë kryetar i SAI-t të Kubës. Në atë kohë, 34 SAI-t u takuan për Kongresin e parë të INTOSAI-t, në Kubë. Aktualisht, INTOSAI ka 190 anëtarë me të drejta të plotë dhe 4 anëtarë të asocuar.

Organizimi

INTOSAI realizon misionin e saj përmes një shumëllojshmërie të organeve, programeve dhe aktiviteteve.

Organet kryesore janë:

- Kongresi,
- Bordi Drejtues,
- Sekretariati i Përgjithshëm dhe
- Grupet rajonale të punës.

Komisioni i Administrimit dhe Financave, përgatit vendimet të cilat miratohen nga Bordi Drejtues.

Drejtori i Planifikimit Strategjik, siguron koordinim efektiv dhe zbatimin e Planit Strategjik.

Bordi drejtues

Bordi Drejtues i INTOSAI-t përbëhet nga 18 anëtarë. Si rregull, ai mblidhet çdo vit, mes Kongreseve. Për të siguruar përfaqësim të balancuar të të gjitha vendeve anëtare, çdo grup pune rajonal i INTOSAI-t dhe llojet kryesore të sistemeve të tyre të auditimit publik, janë të përfaqësuar në Bord.

Nisma për Zhvillimin e INTOSAI-t dhe Gazeta Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë, gjithashtu janë të përfaqësuara në Bordin Drejtues.

Kryetari i Bordit është kreu i SAI-t që organizon kongresin e fundit.

Komiteti i Administrimit dhe Financave (FAC)

Komiteti i Administrimit dhe Financave (FAC) këshillon Bordin Drejtues të INTOSAI-t.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Të bashkëpunojë me Sekretariatin e Përgjithshëm në planifikimin financiar;
- Mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e buxhetit;
- I rekomandon Bordit Drejtues, për miratim, detyrimet fillestare për anëtarët e asociuar;

• Rekomandon rregullat e detyrimet e anëtarëve të plotë;
• I raporton Bordit Drejtues dhe Kongresit nëse kërkohet.

Anëtarët e FAC

Bordi drejtues formon Komitetin e Administrimit dhe Financave, të përbërë nga pesë prej anëtarëve të tij me fuqi vote;

SAI-t anëtar me të drejtë vote:

• Arabia Saudite (Kryetar)
• Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Zv-Kryetar)
• Kina
• Ekuadori
• Norvegjia

SAI-t anëtare ex-officio:

• Austria (INTOSAI Sekretariati i Përgjithshëm)
• Meksika

Sekretariati i Përgjithshëm

Që nga viti 1968 (me rezolutën e Kongresit të 6-të të INTOSAI-t në Tokio), Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, është i vendosur në Vjenë, Austri, në Gjykatën e Auditimit të Republikës së Austrisë. Ai siguron mbështetje administrative qendrore për INTOSAI-n, menaxhon buxhetin e tij, ndihmon Bordin dhe Kongreset, lehtëson komunikimin midis anëtarëve, si dhe organizon seminare dhe studime të veçanta.
Kryetari i Gjykatës së Auditimit të Republikës së Austrisë, është Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Grupet Rajonale të Punës

Grupet Rajonale të Punës, nxisin qëllimet e INTOSAI-t në rajon, duke u siguruar anëtarëve, mundësitë e bashkëpunimit profesional dhe teknik, mbi baza rajonale.
Bordi Drejtues i INTOSAI-t, ka njohur këto shtatë grupe rajonale të punës:

OLACEFS	Organizata e Institucioneve të Larta të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve	themeluar më 1965
AFROSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Afrikës	themeluar më 1976
ARABOSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve Arabe	themeluar më 1976
ASOSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve Aziatike	themeluar më 1978
PASAI	Shoqata e Institucioneve të Larta të Auditimit të Paqësorit	themeluar më 1987
CAROSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Karaibeve	themeluar më 1988
EUROSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Europës	themeluar më 1990

Kongreset

Kongresi është organi suprem i INTOSAI-t, është i përbërë nga të gjithë anëtarët.
Një herë në tre vjet, ai mban takime të rregullta, të cilat kryesohen nga SAI organizator. Ai i ofron të gjithë anëtarëve, mundësinë për të ndarë përvojat, diskutuar çështje, për të kaluar rezoluta dhe rekomandime, të cilat çojnë në përmirësimin e përgjegjshmërisë së qeverisë në mbarë botën.
Pjesëmarrësit përfshijnë delegacione të SAI-ve anëtare, si dhe përfaqësuesit e Kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe profesionale.

Statutet
Nëntor 2007
Statuti i INTOSAI-t u miratua në Kongresin e XIV të INTOSAI-t, i cili u mbajt në Tetor 1992 në Uashington, DC, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ai zëvendësoi Urdhrin e Përhershëm të INTOSAI-t, i cili kishte qenë në fuqi që nga viti 1968 dhe ndryshuar në vitin 1977. Kongresi XVII i INTOSAI-t, i cili u mbajt në Tetor të vitit 2001 në Seul, Republika e Koresë, vendosi të rrisë numrin e anëtarëve që shërbejnë në Bordin Drejtues nga 16 në 18. Kongresi i XVIII i INTOSAI-t, i cili u mbajt në Tetor të vitit 2004 në Budapest, miratoi disa ndryshime në statutin e INTOSAI-t, në lidhje me zbatimin e Planit Strategjik të INTOSAI-t për vitet 2005-2010. Kongresi XIX i INTOSAI-t, i cili u mbajt në Nëntor të vitit 2007 në Mexico City, miratoi një amendament të statutit në lidhje me anëtarët e asociuar.

EUROSAI

Informacion i përgjithshëm

EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) është një nga grupet rajonale, pjesë e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI).
Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të 190 vendeve anëtare të plota dhe katër vendeve anëtare të asociuara të INTOSAI-t, listohen si një organizatë mbështetëse e Kombeve të Bashkuara.
Gupet e tjera rajonale të INTOSAI-t janë OLACEFS, AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, PASAI dhe CAROSAI.

Edhe pse EUROSAI është institucioni më i ri nga shtatë grupet rajonale të INTOSAI-t, ideja e një organizate evropiane të SAI-ve daton që nga themelimi i INTOSAI në vitin 1953. Hapat e para aktive në drejtim të krijimit të EUROSAI-t u zhvilluan në vitin 1974 gjatë Kongresit të VIII të INTOSAI-t në Madrid (1974). Ndërmjet viteve 1975 dhe 1989, SAI-t e Italisë dhe Spanjës me mbështetjen e Komiteti të Kontaktit të Kryetarëve të SAI-ve të vendeve të Komunitetit Ekonomik Evropian hapën rrugën për krijimin e EUROSAI-t, duke përgatitur projektet fillestare për statutin e EUROSAI-t. Në qershor të 1989, në Kongresin e XIII-të të INTOSAI-t, mbajtur në Berlin, u miratua

"Deklarata e Berlinit" për krijimin e Organizatës Evropiane të SAI-ve.
Në nëntor të vitit 1990, në Madrid u zhvillua Konferenca Themeluese dhe Kongresi i EUROSAI-t. Në këtë Kuvend u zgjodh për herë të parë Kryetari dhe Bordi Drejtues i EUROSAI-t. Statutet ishin diskutuar dhe miratuar, si dhe selia e përhershme dhe Sekretariati i Përgjithshëm u vendosën në zyrat e Gjykatës Spanjolle të Auditimit.
EUROSAI u themelua nga 30 anëtarë (SAI-t e 29 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve). Tani numri i vendeve të anëtarësuara është 50 (SAI-t e 49 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve).

Objektivat e organizatës, të përcaktuara në nenin 1 të statutit të saj, kanë të bëjnë me nxitjen e bashkëpunimit profesional midis vendeve anëtare të EUROSAI-t, për të inkurajuar shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit. Kjo gjë çoi në zhvillimin e auditimit të sektorit publik dhe stimuloi krijimin e një partneriteti me akademikët e universiteteve në lidhje me këtë temë, për të punuar në drejtim të harmonizimit të terminologjisë në fushën e auditimit publik.

Roli i ekipeve të EUROSAI-t

Kongresi i EUROSAI-t është autoriteti suprem i organizatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e tij. Roli i tij më i rëndësishëm është që të diskutojë dhe të miratojë rekomandimet për çështjet me interes të përbashkët profesional dhe teknik. Një herë në çdo tre vjet, EUROSAI organizon takime të rregullta, secili prej të cilëve kryesohet dhe thirret nga kreu i SAI-t anëtar që organizon Kongresin.
Ndërmjet kongreseve, Bordi Drejtues i EUROSAI-t ndërmerr të gjitha hapat që i konsideron të nevojshme për të arritur qëllimet e EUROSAI-t, duke përfshirë edhe kryerjen e detyrave të caktuara nga Kongresi për Bordin Drejtues.
Sekretariati mban kontakte me anëtarët, mbështet Bordin Drejtues dhe organet në misionin e tyre.
Organet e tjera të EUROSAI-t janë të rëndësishme në avancimin e punës së EUROSAI-t ndërmjet Kongreseve. Pjesa më e madhe e punës së tyre lind nga shqyrtimi i çështjeve në kongrese. Që nga krijimi i Ekipeve të Orientuara në Kongresin e tetë të EUROSAI-t dhe në bazë të nenit 9.5 të statutit të EUROSAI-t, organet e EUROSAI-t ekzistojnë në forma të ndryshme:

- Katër Ekipet janë krijuar për të çuar përpara punën e EUROSAI-t drejt arritjes së qëllimeve strategjike të tij, duke kontribuar edhe në zbatimin e strategjisë së INTOSAI-t në Evropë. Ekipet veprojnë në nivel të punës, në një mjedis bashkëpunues dhe gjithëpërfshirës, duke iu nënshtruar rishikimit të Planit Strategjik të EUROSAI-t. Ekipet janë një pjesë e përhershme e strukturës së EUROSAI-t.
- Grupet e punës janë ngritur nga Kongresi, që të merren me një sërë çështjesh, që janë me interes të ndërsjellë për SAI-t anëtare, si dhe me çështjet profesionale, të cilat lidhen me një praktikë më të gjerë të auditimit. Mandatet e grupeve të punës mund të zgjaten, por nuk duhet të konsiderohen si të përhershme.
- Task Forcat janë ngritur nga Kongresi ose Bordi Drejtues, për një periudhë të kufizuar kohore, për t'u

marrë me detyra të veçanta, të një natyre teknike ose organizative.

- Projekti dhe Grupet e Studimit mund të themelohen nga një ekip, grup pune ose task forca për një periudhë të kufizuar, për të lehtësuar punën e këtij organi.

1.1 **ROLI I EKIPEVE**

Janë katër ekipe të krijuara nga Kongresi për të arritur qëllimet strategjike të EUROSAI-t:
Ekipi 1: Ndërtimi i kapaciteteve.
Ekipi 2: Standardet profesionale.
Ekipi 3: Shkëmbimin e njohurive.
Ekipi 4: Qeverisja dhe komunikimi.

Qëllimi i Ekipeve është të arrijnë qëllimet strategjike brenda periudhës së vlefshmërisë së planit strategjik të EUROSAI-t. Ata janë ekipe të ngritura, ku detyrat e secilit përcaktohen në planin strategjik.
Ndërsa Ekipet 1-3 janë përgjegjës për zbatimin e zonave të veçanta të planit strategjik, Ekipi 4 duhet të sigurohet që çështjet e ndërprera, përfshirë bilancin, koherencën dhe pajtueshmërinë me planin strategjik, janë trajtuar në mënyrën e duhur.

Grupet e punës / Task Forca

Në përputhje me nenet 9.5 të statutit të EUROSAI-t dhe 13 te Procedurat Standarde, Kongresi i EUROSAI-t është kompetent për krijimin e komisioneve teknike, grupeve studimore dhe për përcaktimin e funksioneve të tyre.
Këto organe janë krijuar për të mbështetur Kongresin në nivel teknik, në veprat dhe iniciativat konkrete, duke i besuar mandate të veçanta. Këto organe mund të krijohen nën një bazë të përhershme ose me afat konkret për zhvillimin e detyrës "ad hoc". Themelimi, dhënia e mandateve të reja dhe shpërbërja e këtyre organeve janë nën përgjegjësinë e Kongresit.
Gjithashtu Bordi Drejtues i EUROSAI-t mund të ngrejë grupe pune, komitete dhe projekte / grupe studimi për ta mbështetur atë në zbatimin e veprimeve të kompetencës së tij.
Anëtarët e EUROSAI-t mund të marrin pjesë në këto organe vullnetarisht. Çdo grup pune, task force ose komitet teknik duhet të zgjedhë kryetarin e vet. Të gjithë anëtarët, që marrin pjesë në komitetet teknike ose grupet e studimit duhet të përfaqësohen nga delegatët apo përfaqësuesit e tyre, të cilët mund të ndihmohen nga ekspertë ose këshilltarë.

Grupet e punës, Task Forcat dhe Komisionet, që aktualisht janë duke operuar në kuadër të EUROSAI-t:

- **Grupi i punës për Auditimin e Mjedisit** (themeluar në vitin 1999 - Kongresi IV). Drejtuar nga SAI i Norvegjisë.
- **Grupi i punës për Teknologjinë e Informacionit** (themeluar në vitin 2002 - Kongresi V). Drejtuar nga SAI i Zvicrës.
- **Task Force për Auditimin e Fondeve të Caktuara për Katastrofat dhe Fatkeqësitë** (themeluar në vitin 2008 - Kongresi VII). Drejtuar nga SAI i Ukrainës.
- **Komiteti i Monitorimit për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave elektronike për praktikat, në cilësinë e auditimit** (themeluar në vitin 2001- Kongresi VIII, për zhvillimin dhe mbajtjen e përditësuar të punës së bërë nga ana e Grupit të Punës së EUROSAI-t për hartimin e një Udhëzuesi mbi Praktikat më të mira në

cilësinë e auditimit, krijuar në vitin 2008). Drejtuar nga SAI i Hungarisë.

- **Task Forca e Auditimit dhe Etikës** (themeluar në vitin 2011- Bordi Drejtues). Drejtuar nga SAI i Portugalisë.

Komisioni i Trajnimit të EUROSAI-t

Krijimi i një Komisioni të Trajnimit të EUROSAI-t (KTE) u miratua nga Bordi Drejtues në mbledhjen e XXI-të, të mbajtur në Madrid (Spanjë) në vitin 2000, pas një takimi të jashtëzakonshëm (XIX) në Paris, në nëntor të vitit 1999 dhe një takimi përgatitor në Frankfurt në fillim të vitit 2000.

KTE-ja ishte e përbërë nga tetë vende anëtarë: SAI i Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Polonisë, Portugalisë, Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar. SAI i Francës dhe i Spanjës bashkëkryesojnë Komitetin.

Në takimin e XXXI të Bordit Drejtues të EUROSAI-t (Reikjavik, 11 shtator 2006) u ra dakord që të përfshiheshin në Komsionin e Trajnimit si anëtarë të rinj, SAI i Lituanisë dhe Hungarisë, që kishin qenë vëzhgues respektivisht në Komsionin e vitit 2002 dhe 2005. Në takimin e XXXII të Bordit Drejtues (Bernë, 13 shtator 2007), SAI i Federatës Ruse u bë anëtar i Komitetit të Trajnimit të EUROSAI-t, pasi kishte marrë pjesë në këtë Komitet si vëzhgues.

Disa subjekte të tjera kanë marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e KTE-së: Gjykata Europiane e Audituesve, Komiteti për Ngritjen e Kapaciteteve të INTOSAI-t, Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI-t dhe SIGMA.

KTE-ja, nën autoritetin e Bordit Drejtues, ishte në krye të çështjeve që lidheshin me trajnimin brenda rajonit të EUROSAI-t.

Misioni i EUROSAI-t në lidhje me trajnimet është:

"Të rrisë zhvillimin profesional dhe institucional të anëtarëve të EUROSAI-t".

Misioni përcakton qëllimin kryesor të aktiviteteve trajnuese të EUROSAI-t. Ai gjithashtu pasqyron supozimin zhvillues të EUROSAI-t, që kapaciteti profesional i individit të jetë i ndërvaruar me zhvillimin institucional të SAI-t. Për këtë arsye, këto dy nivele duhet të jenë njëkohësisht në qendër të vëmendjes për aktivitetet e trajnimit të EUROSAI-t. EUROSAI i kushton vëmendje të veçantë SAI-ve më në nevojë për ngritjen e kapaciteteve.

Vizioni i EUROSAI-t në lidhje me trajnimet është:

"EUROSAI kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit të sektorit publik të rajonit".

Vizioni shpreh qëllimin e EUROSAI-t në lidhje me trajnimin. Duke respektuar dhe vlerësuar diversitetin e rajonit, supozimi i tij kryesor është se ka gjithmonë hapësirë për zhvillim dhe përmirësim. Duke lehtësuar shkëmbimin e përvojës dhe mundësitë për të mësuar nga njëri-tjetri, si dhe ekspertët e jashtëm, EUROSAI duhet të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit të sektorit publik të kryer në rajon.

Kongresi i EUROSAI-t

Kongresi i EUROSAI-t është organi më i lartë i Organizatës. Sipas neneve 5-9 të Statutit, Kongresi është i përbërë nga

të gjithë anëtarët e Organizatës. Ai organizon seanca të zakonshëm çdo tre vjet.

Kongresi Kushtetues i EUROSAI-t u mbajt në Madrid (Spanjë) në vitin 1990. Kongreset në vijim u zhvillua në:

• 1993, Stokholm (Suedi);
• 1996, Pragë (Republika Çeke);
• 1999, Paris (Francë);
• 2002, Moskë (Rusi);
• 2005, Bon (Gjermani);
• 2008, Krakov (Poloni);
• 2011, Lisbonë (Portugali).

Kongresi ka detyrat dhe detyrimet e mëposhtme:

- Të krijojë udhëzimet e nevojshme për të arritur objektivat e EUROSAI-t.
- Të miratojë raportet e organeve të tjera kushtetuese të EUROSAI-t mbi aktivitetet e tyre përkatëse.
- Të miratojë propozimet e paraqitura nga një ose më shumë anëtarë të saj ose nga Bordi Drejtues.
- Të miratojë:
  - Buxhetin për periudhën midis dy Kongreseve të zakonshëm.
  - Kontributet financiare të anëtarëve.
  - Llogaritë e EUROSAI-t.
- Të krijojë komisione teknike dhe grupe pune për të përcaktuar funksionet e tyre.
- Të zgjedhë katër anëtarë të Bordit Drejtues.
- Të zgjedhë vendin ku do të mbahet takimi tjetër i Kongresit.
- Të ndryshojë Statutin e EUROSAI-t, me propozimin e Bordit drejtues ose me një të tretën e anëtarëve të EUROSAI-t, duke e miratuar rezolutën e Kongresit me një shumicë prej dy të tretave të të pranishmëve. Në këtë rast ndryshimi i propozuar duhet t'u dërgohet anëtarëve të EUROSAI-t 30 ditë përpara.
- Të hartojë rregullat dhe rregulloret e veta.
- Të caktojë audituesit e EUROSAI-t.

Që nga Kongresi i tetë (Lisbonë), Kryesia e EUROSAI-t është mbajtur nga Presidenti i SAI-t të Portugalisë. Kongresi i nëntë do të zhvillohet në Holandë në vitin 2014.

Sekretariati i EUROSAI-t

Sipas neneve 13-14 të Statutit të EUROSAI-t, Sekretariati i Organizatës është mbajtur përherë nga Gjykata e Llogarive e Spanjës, e cila është edhe selia e EUROSAI-t. *Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAI-t është kryetari i Gjykatës Spanjolle të Auditimit.*

Sekretariati i mban vendet anëtare të EUROSAI-t në kontakt dhe promovon marrëdhëniet mes tyre gjatë intervalit midis Kongreseve. Sekretariati është gjithashtu përgjegjës për hartimin e një plani të propozimeve të paraqitura në organet qeverisëse, me kërkesë të anëtarëve. Sekretariati publikon revistën vjetore "Revista EUROSAI" dhe një buletin tremujor "Buletini i EUROSAI-t", të cilat gjenden në faqen e internetit të EUROSAI-t.

Sekretariati gëzon *përgjegjësitë* e mëposhtme:

- Të përgatisë mbledhjet e Bordit Drejtues.
- Të zbatojë vendimet e Kongresit dhe të Bordit Drejtues.
- Të përgatisë projekt-buxhetin e EUROSAI-t dhe ta paraqesë atë në Bordin Drejtues.
- Të paraqesë pasqyrat financiare, përveç një raporti financiar vjetor të Bordit Drejtues.

- Të realizojë buxhetin dhe të mirëmbajë llogaritë dhe regjistrimet e EUROSAI-t.
- Të kryejë detyrat e caktuara nga Kongresi ose nga Bordi Drejtues.

Bashkëpunime me Institucione dhe Organizata të tjera

EUROSAI gjithashtu zhvillon aktivitetin e tij në bashkëpunim me organizata të tjera dhe institucione ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me organizatat e tjera ndërkombëtare të institucioneve të Auditimit.

EUROSAI mban rregullisht Konferenca bashkërisht me OLACEFS. Deri më sot janë zhvilluar gjashtë Konferenca (Spanjë, Kolumbi, Mbretëria e Bashkuar, Peru, Portugali dhe Venezuelë). Konferenca e shtatë e përbashkët e EUROSAI dhe OLACEFS u zhvillua në Gjeorgji në vitin 2012, ku mori pjesë edhe KLSH. Në përfundim të këtij takimi, u formulua dhe Deklarata e Tbilisit, e cila inkurajon SAI-t të kontribuojnë ndjeshëm për arritjen e një qeverisje të mire, në ruajtjen dhe mbajtjen e funksionit efikas të auditimeve të zhvilluara, që të lëshojnë rekomandime për qëllim përforcimin e menaxhimit publik, si dhe të bëjë transparent informacionin mbi këto çështje për shoqërinë.

Bashkëpunimi midis EUROSAI-t dhe ASOSAI-t ka nisur në vitin 2011. Konferenca e parë u organizua nga Bordet Drejtuese të dy organizatave, në Stamboll, më 22 – 24 Shtator 2011.

EUROSAI ka mbajtur kontakte të rregullta edhe me Organizatën Evropiane të Institucioneve Rajonale të Auditimit (EURORAI). Deri më tani janë organizuar dy konferenca, në Portugali në vitin 2001 dhe në Danimarkë në vitin 2003.

Bashkëpunimi me Konfederatën Evropiane të Institucioneve të Auditimit të Brendshëm (ECIIA)

Më 7 mars 2011, EUROSAI dhe ECIIA nënshkruan në Romë një Marrëveshje Bashkëpunimi. Kjo Marrëveshje ka për qëllim krijimin e një procesi bashkëpunimi që do t'u mundësojë dy organizatave përfitime reciproke dhe shkëmbim njohurish. ECIIA ndihmon dhe përfaqëson profesionin e auditimit të brendshëm në të dy sektorët privat dhe publik në të gjithë Evropën, duke ndjekur objektivin global të sigurimit të udhëheqjes dinamike për profesionin e auditimit të brendshëm.

Marrëveshja EUROSAI-ECIIA u nënshkrua me një fokus të veçantë në zbatimin praktik të arritjeve të tyre në nivel evropian, në kuadër të kontekstit më të gjerë të ofruar nga bashkëpunimi mes Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t dhe Institutit të Audituesve të brendshme (IIA, nënshkruan në dhjetor 2010), një Memorandum Formal Mirëkuptimi (rinovimi i marrëveshjes së tyre origjinale në korrik 2007), duke mbështetur reciprokisht synimet dhe objektivat e njëri-tjetrit.

Qëllimi i procesit të bashkëpunimit mbulon lehtësimin e shkëmbimit të informatave, zhvillimin e të kuptuarit të përbashkët në lidhje me përgjegjshmërinë në sektorin publik dhe auditimin, ndarjen e përvojave në zbatimin e kuadrit të praktikave ekzistuese dhe standardeve profesionale, si dhe konsultime të përbashkëta për çështjet me interes për të dy palët. Për të nxitur dhe vënë në praktikë bashkëpunimin, EUROSAI dhe ECIIA ranë dakord për të zhvilluar një platformë të përbashkët.

Një marrëveshje të ngjashme ka nënshkruar edhe KLSH me Ministrinë e Financave. Marrëveshja u lidh mbi bazën e Nenit 26 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm, i cili kërkon që strukturat e përgjithshme të këtij auditimi të bashkëpunojnë me Kontrollin e Lartë të Shtetit në shkëmbimin e çdo informacioni të vlefshëm, që lidhet me sistemin e auditimit, në dërgimin e programeve vjetore të punës, për të shmangur mbivendosjet në procesin e auditimit, etj., mbi bazën e nenit 70 të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, si dhe bazuar në Standardin 9150 të INTOSAI: "Koordinimi dhe Bashkëpunimi mes Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik". Kjo marrëvëshje bashkëpunimi parashikon komunikimin e ndërsjelltë të planeve dhe strategjive të auditimit të të dyja institucioneve, dokumentimin e proceseve operacionale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit, si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion.

Bashkëpunimi me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI).

Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t është baza për promovimin e ndërtimit të kapaciteteve. Ajo është themeluar në vitin 1986 me misionin për të ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të auditimit të SAI-ve dhe për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet e reja të auditimit përmes trajnimit dhe ndarjes së informacionit.

IDI ka bashkëpunuar në mënyrë të përhershme me Komitetin e Trajnimit të EUROSAI-t gjatë viteve 2000 – 2011. EUROSAI bashkëpunon me IDI-n në zhvillimin e Programit të Trajnimit Afatgjatë Rajonal (LTRTP). LTRTP u realizua në dy faza, kryesisht nëpërmjet seminareve dhe aktiviteteve të tjera të trajnimit: Faza I u zhvillua mes viteve 2000 dhe 2002 dhe fokusohej në vendet kandidate të BE-së (EUROSAI siguroi burime njerëzore në këtë fazë). Faza II (2003-2005), përfshiu SAI nga Evropa Lindore, Ballkani dhe Republikat e Azisë Qendrore dhe u mbajt në dy gjuhë në rusisht dhe anglisht (EUROSAI kontribuoi në këtë fazë edhe me një mbështetje financiare që përfaqësonte 9.5% të shumës totale të projektit).

Në vitin 2006 EUROSAI ka bashkëpunuar me IDI-në për "Auditimin e borxhit publik". Ky Program është ekzekutuar në vendet e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (CIS) dhe në Mongoli. Ndërmjet viteve 2009 dhe 2011, EUROSAI ka ofruar mbështetje financiare për programin trans-rajonal të IDI-t "Ngritja e Kapaciteteve në Auditimin e Menaxhimit të Borxhit Publik".

Bashkëpunimet me SIGMA-n.

SIGMA është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Evropian (BE), për të siguruar mbështetje për vendet partnere në përpjekjet e tyre për të modernizuar sistemet publike të qeverisjes. Kjo përfshin: vlerësimin e përparimit të reformave dhe identifikimin e prioriteteve, duke ndihmuar në procesin e ndërtimit të institucioneve dhe ngritjen e kornizave ligjore, si dhe lehtësimin e ndihmës

nga BE-ja dhe donatorë të tjerë, duke ndihmuar në projekte dhe zbatimin e planeve të veprimit. Përfshirja e SIGMA-s në aktivitetet me SAI-t ka filluar që në vitin 1998. Që atëherë, SIGMA ka dhënë asistencë teknike, udhëzime dhe këshilla, duke ndihmuar në arritjen e reformave institucionale, miratimin e standardeve të njohura ndërkombëtare të auditimit, zbatimin e metodave të auditimit në përputhje me praktikat e BE-së, duke punuar ngushtë me ECA-n në implementimin e Strategjisë së saj për Zhvillim për SAI-t.
Bashkëpunimi me EUROSAI-n po vazhdon, duke përfshirë pjesëmarrjen në Kongresin 3 vjetor, në seminare teknike dhe takimet e Komitetit të Trajnimit të EUROSAI-t në vitet 2000 – 2011.

Bashkëpunime me Universitetet.
EUROSAI, në cilësinë e tij si Organizatë, nuk mban marrëdhënie të rregullta bashkëpunimi me universitetet, por merr këtë objektiv parasysh, jo si një qëllim në vetvete por si një qëllim të tërthortë që konsiderohet në zhvillimin e aktivitetit të trajnimit.
Shumica e anëtarëve të EUROSAI-t bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë. Disa nga format e bashkëpunimit janë:

- Organizimi i seminareve dhe konferencave të përbashkëta.
- Trajnimi i audituesëve nga profesorë universiteti.
- Promovimi i studentëve në Institucione të Auditimit.
- Zbatimi i leksioneve në universitet nga auditues publikë.
- Pjesëmarrja e audituesve të Institucioneve të Auditimit në projekte kërkimore të universiteteve.
- Organizimi i përbashkët i diplomave master dhe studimeve pasuniversitare për çështjet të lidhura me administratën.
- Auditimi i fondeve publike.

Në bazë të Strategjisë së Trajnimeve 2008 – 2011, për të forcuar bashkëpunimet me universitetet, Komiteti i Trajnimit të EUROSAI-t hartoi një raport në vitin 2010 në lidhje me zonat ku kjo linjë e bashkëpunimit ka nevojë t'i jepet një shtysë.

Profil

Institucione supreme të auditit

GJYKATA E AUDITIMIT E REPUBLIKËS SË SLLOVENISË

Në prill 2012 KLSH nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, një ndër institucionet supreme të auditimit më moderne dhe me ekspertizë të plotë në Evropë
Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e Llogarive e Sllovenisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në certifikimin e deklaratave financiare. Ata po ashtu do të eksplorojnë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet e KLSH në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.

Gjykata Sllovene e Auditimit. Informacion i përgjithshëm mbi Gjykatën Slloveve të Auditimit.

Kushtetuta e Sllovenisë citon se Gjykata e Auditimit të Republikës Sllovene është organi më i lartë për mbikëqyrjen e llogarive shtetërore, të buxhetit të shtetit dhe të të gjitha shpenzimeve publike në Slloveni. Kushtetuta më tej parashikon që Gjykata e Auditimit është e pavarur në kryerjen e detyrave të saj dhe organizimi dhe kompetencat e Gjykatës së Auditimit janë të përcaktuara me ligj. Gjithashtu kjo Gjykatë parashikon që aktet me të cilat ajo ushtron kompetencat e saj të auditimit nuk mund të ndryshohen apo të hidhen poshtë nga gjykatat apo organe të tjera shtetërore. Misioni i Gjykatës së Auditimit është të informojë publikun mbi rezultatet e auditimit të organeve shtetërore dhe përdoruesve të tjerë të fondeve publike. Përveç kësaj, për shkak të përvojës dhe ekspertizës së saj në praktikat më të mira, Gjykata e Auditimit jep këshilla për organet shtetërore dhe përdorues të tjerë të fondeve publike, për të përmirësuar operacionet e tyre financiare.

Duke zbuluar parregullsi dhe joefikasitet, Gjykata e auditimit vë me përgjegjësi organet shtetërore dhe bartës të funksioneve publike, duke kontribuar në mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Sllovenisë dhe Bashkimit Evropian.

Veprimtaria e Gjykatës së Auditimit.

Audituesit e Gjykatës së Auditimit mbledhin prova për çështjet e mëposhtme: nëse të ardhurat e buxhetit të shtetit janë mbledhur si duhet, nëse shpenzimet e buxhetit të shtetit ishin në përputhje me rregullat dhe nëse operacionet financiare të përdoruesve të fondeve publike ishin të përshtatshme, dmth në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit. Auditorët gjithashtu vlerësojnë nëse fondet publike janë përdorur në përputhje me qëllimet e përcaktuara. Gjatë procedurës së auditimit, audituesit japin këshilla për përdoruesit e fondeve publike për shmangien dhe eliminimin e gabimeve, parregullsive dhe joefikasitetit në operacionet e tyre financiare. Gjykata e Auditimit gjithashtu boton opinione detyruese mbi çështjet e financave publike.

Kë mund të auditojë Gjykata e Auditimit

Gjykata e Auditimit mund të kontrollojë veprimet e çdo përdoruesi të fondeve publike. Një përdorues i fondeve publike është një entitet ligjor publik, apo njësi e tij, një subjekt privat ligjor ose një person fizik që ka marrë ndihma nga buxheti i Bashkimit Evropian, buxheti i shtetit ose buxheti i një autoriteti lokal, apo që kryen një shërbimi publik ose siguron të mira publike mbi bazën e një koncesioni. Një subjekt ligjor privat mund të auditohet nga Gjykata e Auditimit në qoftë se ai është një kompani, bankë apo kompani sigurimesh në të cilat shteti apo një autoritet lokal ka shumicën e aksioneve. Opinionet e Gjykatës së Auditimit mbi këto operacione duhet të konsiderohen nga çdo organ shtetëror, organi i autoriteteve lokale dhe përdoruesit e fondeve publike ndaj të cilit kryhet auditimi. Në bazë të kompetencave të saj, Gjykata e Auditimit gjithashtu ka disa detyrime që përcaktojnë qëllimin vjetor të punës së saj. Sipas nenit 1, Gjykata e Auditimit duhet të kryejë auditime vjetore mbi rregullsinë e zbatimit të buxhetit të shtetit (rregullsinë e veprimeve të shtetit), rregullsinë e veprimeve të institutit publik të sigurimeve shëndetësore dhe rregullsinë e operacioneve të institutit të sigurimeve të pensioneve publike. Çdo vit, Gjykata e Auditimit duhet të rishikojë rregullsinë e operacioneve për një numër adekuat të qyteteve, komunave si dhe ofruesish komercial dhe jo-komercial të shërbimeve publike - numri i tyre duhet të përcaktohet në programin vjetor të punës.

Si i zbaton Gjykata e Auditimit detyrat e saj?

Detyra themelore e Gjykatës së Auditimit është të shqyrtojë dhe të kontrollojë veprimet e përdoruesve të fondeve publike. Nga auditimi i këtyre operacioneve, ajo merr të dhënat e duhura dhe të mjaftueshme për të shprehur një opinion mbi përdorimin e tyre:

• Në auditimin e pasqyrave financiare, ajo vlerëson integritetin dhe saktësinë e pasqyrave;

• Në auditimin e rregullsisë së operacioneve, shpreh një opinion mbi

përputhshmërinë e veprimeve me rregullat dhe udhëzimet që përdoruesit e fondeve publike duhet të ndjekin;
• Në auditimin e përformancës, shpreh një mendim për ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve të përdoruesëve të buxhetit.
Të gjitha raportet e lëshuara nga Gjykata e Auditimit paraqiten në Asamblenë Kombëtare dhe në njësinë e audituar. Gjykata e Auditimit, çdo vit, duhet ti dorëzojë Asamblesë Kombëtare një raport vjetor për punën dhe gjetjet e saj më të rëndësishme.

Si e vendos Gjykata cilat auditime do të ndërmarrë.

Gjykata e Auditimit i ushtron kompetencat e saj krejtësisht e pavarur dhe është përgjegjëse për miratimin e programit të saj të punës. Në hartimin e programit vjetor të punës, Gjykata e Auditimit konsideron përgjegjësitë ligjore, si dhe propozimet direkte dhe indirekte nga deputetët, Kuvendi, qeveria, ministrat, autoritetet vendore, shoqëria civile, mediat dhe qytetarët individualë, duke përfshirë dhe prioritetet dhe strategjitë e saj. Në përzgjedhjen e auditimeve për t'u përfshirë në programin vjetor të punës, Gjykata e Auditimit përpiqet t'u përgjigjet pritjeve të publikut sa më me efikasitet të jetë e mundur; megjithatë ajo duhet të mbetet e pavarur në përcaktimin dhe identifikimin e punës së saj në mënyrë që të jetë në gjendje të japë gjykime objektive, e cila vlen edhe për informimin publik.

Organizimi i Gjykatës së Auditimit.

Gjykata e Auditimit të Republikës së Sllovenisë ka tre anëtarë: një president dhe dy zëvendës presidentë. Ata propozohen nga Presidenti i Republikës dhe emërohen nga Kuvendi Popullor për një afat prej nëntë vjetësh, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve në një votim të fshehtë. Kryetari dhe dy nënkryetarët formojnë Senatin e Gjykatës së Auditimit. Përveç anëtarëve, Gjykata e Auditimit gjithashtu ka deri në gjashtë auditues shtetërorë të lartë, të cilëve kreu i departamenteve të auditimit u ka dhënë statusin e zyrtarëve publikë. Ata emërohen nga kryetari i Gjykatës së Auditimit për një afat prej nëntë vjetësh. Gjykata e Auditimit ka edhe shërbime përkrahëse përveç shërbimeve të saj të auditimit. Ajo mund ti zgjedhë të gjithë punonjësit e saj në mënyrë të pavarur. Në vitin 2004 Gjykata e Auditimit krijoi një njësi në Maribor, që zbaton kontrollin mbi përdorimin e fondeve publike në Sllovenine verilindore. Arsimimi i pjesës më të madhe të punonjësve, është ekonomi dhe legjislacion, por ka edhe auditues nga sfonde të tjera akademike. Gjykata mund të ftojë edhe ekspertë nga jashtë apo grupe ekspertësh të huaj, për të marrë pjesë në auditimet e tyre.

Ndikimi i punës së Gjykatës së Auditimit.

Gjykata e Auditimit lëshon një raport mbi auditimet e ndërmarra për përdoruesit e fondeve publike. Raporti i dorëzohet Asamblesë Kombëtare dhe subjektit të audituar si dhe publikohet në faqen e internetit të Gjykatës. Në këtë mënyrë, publiku informohet vazhdimisht për punën e Gjykatës. Në raportet e saj, Gjykata e Auditimit gjithashtu ofron edhe këshilla dhe rekomandime për përdoruesit e fondeve publike me qëllim rritjen e përmirësimeve në operacionet

financiare. Nëse gjatë auditimit janë evidentuar shkelje apo parregullsi, subjekti i audituar duhet të paraqesë një dëshmi mbi masat e ndërmarra për përmirësimin e parregullsive dhe operacioneve të tyre. Objektivi i Gjykatës së Auditimit është të ndihmojë institucionet të përmirësojnë operacionet e tyre duke kryer kontrolle dhe konsultime. Në këtë mënyrë, operacionet e administratës publike janë përmirësuar dhe janë dhënë garanci që paratë për funksionimin e organeve shtetërore, institucioneve publike dhe qeverisjes vendore, të cilat janë mbledhur nga qytetarët në formën e taksave ose të kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj, janë përdorur si duhet, në përputhje me qëllimet e përcaktuara dhe me efikasitet. Gjykata e Auditimit shqyrton përdorimin e fondeve publike dhe vazhdimisht i raporton konstatimet e saj për publikun.

Në prill 2012, në Ljubjanë të Sllovenisë, KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Gjykatën e Llogarive të Sllovenisë. Marrëveshja synon bashkëpunim të ndërsjelltë dhe trajnime për stafin e KLSH.

Profil

Institucione supreme të auditit

ZYRA E LARTË E AUDITIMIT NË POLONI, NIK

Zyra e Lartë e Auditimit e Polonisë, NIK
Zyra e Lartë e Auditimit ose NIK (emri i mëparshëm ka qenë Dhoma e Lartë e Kontrollit) është organi më i lartë i pavarur i auditimit, misioni i të cilit është të mbrojë shpenzimet publike. Për më shumë se 90 vjet, NIK ka vlerësuar funksionimin e shtetit polak dhe menaxhimin e fondeve publike.

Misioni dhe Vizioni
Misioni i Zyrës së Lartë të Auditimit është të promovojë efiçencën ekonomike dhe efikasitetin në shërbimin publik në dobi të Republikës së Polonisë.
Vizioni i Zyrës së Lartë të Auditimit është të jetë një institucion i lartë auditimi, raportet e të cilit duhet të jenë një burim i pritur dhe i kërkuar informacioni për organet e shtetit dhe publikut në përgjithësi.

Tradita e auditimit të shtetit në Poloni
Si pasojë e evolucionit të monarkisë në Evropë gjatë dekadës së parë të viteve 1500, thesari mbretëror dhe thesari publik u ndanë, kështu që u bë e nevojshme për të kontrolluar rrjedhën e parave në mes tyre. Për këtë arsye, elitat politike në atë kohë u përpoqën të krijojnë një sistem të tillë të llogarive që do të jetë efektiv dhe njëkohësisht nuk do të dëmtonte prestigjin e monarkut. Nevoja për të kontrolluar shpenzimin e fondeve publike dhe politikat fiskale të monarkut, formuan bazën për sistemin auditues. Pra, tradita e auditimit të buxhetit të shtetit në këtë vend, ka lindur shekuj më parë. Për shkak të rolit të tij në ligjbërje, Parlamenti e ka zhvilluar mandatin e tij në auditimin e shtetit.

Zyra e Kontrollit të Lartë të Shtetit
Polonia më në fund fitoi përsëri pavarësinë në vitin 1918 pas Luftës së Parë Botërore. Në shkurt 1919, Kryetari i Shtetit, Jozef Piłsudski, nënshkroi një dekret per Zyrën e Lartë të Kontrollit të Shtetit (Najwyższa Izba Kontroli

Państwowej). Ky ishte një organ i pavarur, në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Shtetit, dhe përgjegjësia e tij ishte auditimi i të ardhurave shtetërore, shpenzimeve dhe menaxhimi i aseteve publike. Ai gjithashtu, monitoron punën e institucioneve dhe menaxhimin e fondeve dhe njësive të vetë-qeverisura, duke nxjerrë raporte mbi buxhetin e shtetit. Kështu u sigurua kontrolli i plotë mbi financat publike.

Zyra e Lartë e Kontrollit në Republikën e Dytë të Polonisë (1918-1939)

Kushtetuta e miratuar në mars të vitit 1921, mundësoi që Zyra e Lartë e Kontrollit të Shtetit, bazuar në parimin e përgjegjësisë kolegjiale, të ishte e autorizuar për auditimin e gjithë administratës shtetërore, sa i përket financave të saj dhe llogarisë. Çdo vit, NIK ishte i detyruar të paraqesë opinionin e tij për votën e miratimit për qeverinë, në dhomën e ulët të Parlamentit (polonisht: Sejmi). Presidenti i Nik ishte përgjegjës direkt për performancen e Nik dhe për punonjësit e saj. Më 3 qershor 1921, Akti mbi Auditimin e Shtetit u miratua dhe ishte në fuqi deri në përfundim të Republikës së Dytë të Polonisë në vitin 1939. Kjo mundësoi që NIK të ishte një organ i pavarur në bashkëpunim me Parlamentin.

Zyra e Lartë e Auditimit në Republikën Popullore të Polonisë (1945-1989)

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, pushteti më i lartë në vend ka qenë Këshilli Kombëtarë (polonisht: Krajowa Rada Narodowa, Shkurtimi: KRN.), i cili ka themeluar Zyrën e Auditimit (BIURO Kontroli) që është menaxhuar në fakt nga Presidiumi i KRN-së. Në këtë mënyrë, auditimi i shtetit është dashur të jetë zyrtarisht i pavarur ndaj administratës. Në vitin 1949, Parlamenti krijoi Zyren e Kontrollit te Lartë (Najwyższa Izba Kontroli, Shkurt. NIK).

U përshtat gjithashtu dhe akti mbi NIK në mënyrë që Presidenti i NIK të emërohej nga SEJM dhe të ishte përgjegjës ndaj tij. Akti gjithashtu siguroi që NIK të përbëhej nga nëntë departamente, tri zyra dhe degët rajonale. Presidenti i NIK ishte anëtar i Këshillit të Shtetit. Kjo pavarësi relative e auditimit të shtetit përfundoi në vitin 1952, kur NIK u zëvendësua me Ministrinë e Kontrollit të Shtetit. Në këtë mënyrë, parimi i pavarësisë së NIK u shkel: NIK, i cili ishte një institucion suprem i auditimit, funksiononte si një nga ministritë dhe pjesë e qeverisë, veprimtaria e të cilit monitorohej. Si rezultat i ndryshimeve në politikën e brendshme polake, që u zhvilluan pas mesit të 1956, NIK u rivendos në vitin 1957 sërish në varësi të Sejm. Sejmi gjithashtu, emëronte dhe shkarkontë Presidentin e NIK. Në vitin 1976, Akti mbi NIK u ndryshua dhe NIK u shndërrua sërish në një organ qeveritar, të mbikëqyrur nga ana e Kryeministrit edhe pse emri i saj mbeti i pandryshuar. Së fundi, pavarësia e Zyrës Supreme të Auditimit u rivendos në vitin 1980 dhe auditimi i shtetit ishte përsëri në duart e Sejm-it. Në këtë mënyrë, funksioni kontrollues i Sejm-it u rrit ndjeshem.

Zyra e Lartë e Auditimit në Poloni pas vitit 1989

Në vitin 1989 morën fund regjimet komuniste dhe Republika Popullore e Polonisë u shndërrua përsëri në Republikën e Polonisë. Edhe pse në një farë mënyre pavarësia e saj ishte e

kufizuar gjatë periudhës së komunizmit, NIK mbijetoi si një strukturë e veçantë organizative. Kështu, Polonia demokratike, kishte një institucion të gatshëm që të fillonte menjëherë aktivitetin e tij të auditimit. Megjithatë, për shkak të kushteve të reja shoqërore dhe politike, pas vitit 1989 lindi nevoja për krijimin e një ligji të ri për Zyrën e Lartë të Auditimit. Ai u miratua përfundimisht nga Sejmi më 23 dhjetor 1994 dhe modernizoi auditimin shtetëror në Poloni.

Baza ligjore për të vepruar

Detyra themelore e NIK-ut është të kontrollojë veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore, Bankën Kombëtare të Polonisë (NBP), personat juridikë shtetërorë dhe subjektet e tjera shtetërore organizative. NIK mund të kontrollojë gjithashtu aktivitetet e organeve të qeverisjes vendore, për sa i përket ligjshmërisë së tyre, menaxhimit të shëndoshë, efikasitetit dhe integritetit. NIK ndërmerr auditime të urdhëruar nga Sejmi (Dhoma e Ulët e Parlamentit polak) ose nga organet e tij, me kërkesë të Presidentit, të Kryeministrit ose me iniciativën e vet.

Funksionimi dhe organizimi i NIK-ut është parashikuar në Kapitullin 9 të Kushtetutës së Republikës së Polonisë dhe në Ligjin për NIK-un, më 23 dhjetor 1994 (me amendimet e paraqitura nga Ligji i 22 janarit 2010).

Struktura e Organizimit të NIK

Statusi i ri i Zyrës së Lartë të Auditimit u miratua nga Parlamenti, më 26 gusht 2011 dhe brenda 3 muajve, Presidenti i ri rregulloi organizimin e brendshëm institucional. Gjatë kësaj kohe, u transformuan departamentet më të rëndësishme dhe u krijuan njësi të reja organizative. Sipas ndryshimeve, Zyra e Lartë e Auditimit përbëhet nga 14 departamente auditimi në fusha të ndryshme të veprimtarive shtetërore si dhe nga 4 departamente administrative, të cilat ofrojnë shërbime të brendshme për NIK. Këto njësi janë vendosur në zyrat qendrore të NIK në Varshavë. Veç kësaj, NIK ka edhe 16 njësi rajonale në çdo rajon administrativ të Polonisë, të cilat përfshihen në auditime direkte.

Këshilli i NIK

Këshilli i Zyrës së Lartë të Auditimit është organi që zbaton parimin e kolegjialitetit të NIK-ut, si është parashikuar nga Kushtetuta polake dhe dispozitat statutore. Këto organe kanë kompetenca të gjera, p.sh. miratimin dhe kalimin e rezolutave më të rëndësishme të NIK-ut, dokumente të cilta është i detyruar t'ia paraqesë Sejm-it. Këshilli i NIK-ut përfshin: Presidentin si Kryetar, Zëvendës-presidentin, Drejtorin e Përgjithshëm dhe 14 anëtarë.

Përbërja dhe mënyra e punës së Këshillit të NIK-ut

Shtatë ekspertë të ligjit ose të ekonomisë dhe shtatë drejtorë të njësive të auditivit. Këshilltarët e Presidentit të NIK-ut emërohen nga anëtarët e Këshillit të NIK-ut dhe nga Marshalli i Sejm-it, me kërkesë të Presidentit të NIK-ut pas marrjes së mendimit nga Komiteti i Sejm-it. Mandati i anëtarit të Këshillit të NIK-ut është 3 vjet.

Personat, duke qenë pjesë e këshillit, janë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre dhe mund të kenë mendime kundërshtuese mbi rezolutat

që votohen. Garancia e pavarësisë së anëtarit, kur ata janë të emëruar në mënyrë të veçantë nga ana e NIK, është votimi i fshehtë, si dhe fakti se përfundimi i kontratës së punës në lidhje me punonjësit, duke u emëruar anëtar i Këshillit kërkon pëlqimin e Këshillit të NIK-ut.

Presidenti i NIK-ut mund të ftojë persona të tjerë përveç anëtarëve të Këshillit në mbledhjet e tij.

Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari i NIK-ut me iniciativën e vet ose me kërkesën e të paktën 1/3 së anëtarëve të Këshillit. Mbledhjet kryesohen nga kryetari i NIK-ut ose një zëvendës-president i emëruar nga kryetari. Në vitin 2010, janë mbajtur 15 Mbledhje të Këshillit, nga të cilat njëra kishte natyrën e seminarit. Takimet në formë seminari janë vendi i debatit për çështje të rëndësishme të funksionimit të shtetit dhe roli i NIK-ut për ndërtimin e shtetit nën sundimin e ligjit.

Kompetencat e Këshillit

Këshilli i NIK-ut ka kompetenca të gjera. Ky organ miraton rezolutat, duke iu referuar planit vjetor të punës së Zyrës së Lartë të Auditimit, si dhe projekt-buxhetin e saj. Çdo vit Këshilli miraton dokumentet që NIK është i detyruar të paraqesë para Sejm-it, që do të thotë analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit, supozimet e politikës monetare dhe raportin e NIK-ut mbi aktivitetin për vitin e kaluar. Përveç kësaj, Këshilli i kalon për shqyrtim Sejm-it, opinione mbi miratimet e Këshillit të Ministrave dhe propozimet për probleme të veçanta, në lidhje me veprimtarinë e autoriteteve publike.

Këshilli i NIK-ut mund të ofrojë këshilla për programin e auditimit, si dhe informacion për rezultatet e auditimeve veçanërisht të rëndësishme, drejtuar nga presidenti i NIK-ut. Çdo çështje tjetër drejtuar nga presidenti i NIK-ut apo paraqitur nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit është subjekt për këshilla. Këshilli i NIK-ut rishikon pasqyrat, që i referohen nenit 54, fraksion 3 të Ligjit për Zyrën e Lartë të Auditimit.

Detyrat e këshillit përfshin shqyrtimin e vlerësimeve, komentet dhe gjetjet e përfshira në pasqyrat e post-auditimit të paraqitura nga Presidenti ose nënkryetari i NIK-ut.

Në vitin 2010, Këshilli shqyrtoi rezerva për 52 pasqyra post-auditimi, nga të cilat gjashtë ishin të përfshira në total, 30 pjesërisht dhe 16 në tërësinë e tyre.

Bashkëpunimi me Parlamentin

NIK është organi më i lartë i auditimit të shtetit dhe i raporton Sejm-it (dhoma e ulët e Parlamentit). NIK i paraqet Sejm-it mbi 150 deklarata auditimesh, duke përmbushur në këtë mënyrë misionin e tij për të informuar Kuvendin mbi gjendjen e shtetit dhe të financave publike.

Në seancat plenare të Sejm-it, NIK paraqet dokumentat më të rëndësishme dhe opinionin e tij mbi çështjet më të rëndësishme që lidhen me kontrollet që kryen. Përfaqësuesit e NIK marrin pjesë edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe të nën-komiteteve.

NIK i paraqet Sejm-it dokumentet e mëposhtme:

- Analiza e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare.
- Opinione mbi miratimet e qeverisë.
- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të urdhëruar nga Sejmi dhe organet e tij.

- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të kryera me kërkesë të Presidentit dhe Kryeministrit si dhe rezultatet e auditimeve të rëndësishme.
- Mocionet në Sejm për shqyrtimin e problemeve të caktuara në lidhje me organet që kryejnë detyra publike.
- Prononcimet mbi kundërshtimet për sa i përket veprimtarisë së Ministrave, Krerëve të Zyrave Qendrore ose Presidentit të Bankës Kombëtare që vijnë nga auditimet e kryera nga NIK.
- Raport mbi aktivitetin e vitit të shkuar.
- Informacion se si janë përdorur gjetjet e auditimit në lidhje me ligjvënien dhe aplikimin e tij.

Gjithashtu, NIK është i detyruar të paraqesë tek Sejm edhe një plan periodik pune. Rezultatet e auditimit nuk duhet të bëhen publike pa u dorëzuar më parë tek Sejm-i. Presidenti i NIK merr pjesë në seancat plenare të Sejm dhe çdo vit i paraqet Sejm-it "Analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet mbi politikën monetare".

Çdo vit, përfaqësues të NIK marrin pjesë në qindra mbledhje parlamentare (në 2006 - 916 mbledhje, në 2007 - 720, në 2008 - 966, në 2009 - 932, në 2010 - 719). Ata paraqesin dhe japin shpjegime mbi rezultatet e auditimeve, si dhe japin opinione mbi nismat ligjore të deputetëve. NIK bashkëpunon rregullisht me Komitetin Shtetëror të Auditimit, i cili është përgjegjës për të dhënë mendim mbi planin e punës të NIK, raportet vjetore të aktivitetit të tij, mbi buxhetin dhe raportin e ekzekutimit të tij etj. Komisioni kryen vlerësimin periodik të aktivitetit të Nik, duke përfshirë edhe analiza e deklarata mbi rezultatet e auditimit dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Komiteti gjithashtu merret me veprimtaritë ndërkombëtare të Nik, bashkëpunimet me organe të tjera të auditimit në Poloni dhe me analizimin e ankesave dhe sugjerimeve drejtuar Nik.

Politika Mjedisore e NIK

NIK angazhohet për të kufizuar efektet e dëmshme që aktivitetet e saj mund të kenë në mjedisin natyror. Kjo është arritur përmes konsumit racional të energjisë elektrike dhe të burimeve natyrore (kryesisht letër) si dhe përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave. NIK gjithashtu synon të promovojë qëndrimet pro-mjedisore mes punonjësve të saj dhe të përmirësojë vazhdimisht përpjekjet e saj për sa i përket kujdesit ndaj mjedisit.

Politika mjedisore e NIK po zbatohet në kuadër të sistemit të menaxhimit të mjedisit të quajtur Zyra e Gjelbër, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Punonjësit e NIK dhe personat e tjerë që punojnë për NIK ose në emër të tij, janë bërë të vetëdijshëm për nismën e Zyrës Gjelbër.

Presidenti i NIK, Jezierski Jacek, është përfshirë në zbatimin e politikave mjedisore duke ofruar resurset e nevojshme. Në Korrik 2011 Shoqëria Gjermane Lloyd Polen, konfirmoi se sistemi i menaxhimit të mjedisit i përdorur nga NIK, i përmbush kërkesat e standardeve ndërkombëtare. Për këtë arsye, NIK u pajis me certifikatën mjedisore përkatëse, e vlefshme deri më 17 Korrik 2014.

Veprimtaria

Zyra e Lartë e Auditimit i dorëzon Sejmit, analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare, të opinioneve në votimin e miratimit të qeverisë, konstatimeve për

rezultatet e kontrolleve dhe raportet vjetore mbi veprimtarinë e saj.

Auditimet e NIK

Në vitin 2010, nga auditimet e NIK, rezultoi se dëmi nga parregullsitë financiare ishte rreth 4 miliardë dollarë. Çdo shtetas që paguan taksat për shtetin, kërkon të jetë i sigurt që këto para shpenzohen në mënyrë të përshtatshme. NIK, si monitorues i fondeve publike, kujdeset për shpenzimet efikase dhe të besueshme të këtyre fondeve. Veç zbulimit të parregullsive, NIK propozon edhe zgjidhjet e mundshme që synojnë shpenzime më efikase në të ardhmen. Auditimet e NIK zbulojnë se në cilat fusha shteti funksionon mirë dhe në cilat duhet të bëhen përmirësime. Disa përmirësime bëhen gjatë kontrolleve, ndërsa të tjera në përfundim të tyre. Nëse parregullsitë rrjedhin nga vakume në rregullore apo nga dispozita ligjore të paqarta, NIK propozon ndryshime në ligj.

Shpenzimet publike që kërkojnë auditimin e NIK

Zyra e Lartë e Auditimit heton çdo fushë ku përfshihen shpenzimet publike dhe përdorimi i pasurive shtetërore. NIK gjithashtu kontrollon nëse institucionet publike bëjnë punën e tyre në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomikisht. Çdo vit, NIK auditon mijëra subjekte, duke paraqitur kështu pamjen e përgjithshme të funksionimit të shtetit.

Deklarimet mbi rezultatet e auditimit i paraqiten Sejm-it (Dhoma e ulët e Parlamentit polak) dhe institucioneve përgjegjëse për funksionimin e duhur të subjekteve të audituara.

Buxheti i shtetit në mikroskop

Auditimi më i rëndësishëm që kryen NIK, është ekzekutimi i buxhetit të shtetit. Çdo vit, NIK-u auditon rreth 400 subjekte në kuadër të kontrollit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit. Ky auditim është detyra kryesore në planin vjetor të punës së NIK-ut. Në një seancë plenare të Parlamentit, Presidenti i NIK-ut paraqet çdo vit rezultatet e auditimit mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit. Ato përshkruhen në dokumentin e titulluar "Analiza e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzime mbi politikën monetare".

Planifikimi vjetor

Plani i auditimeve për vitin e dhënë, zhvillohet në bazë të drejtimeve prioritare të auditimit, të vendosura çdo 3 vjet nga Kolegji i NIK-ut. Në vitet 2009 – 2011, NIK ka vlerësuar nëse shteti ka funksionuar normalisht, nëse burimet publike janë menaxhuar në mënyrë efektive dhe se si ka qenë ecuria e Polonisë në BE. Auditimet e planifikuara për vitin 2011 ishin të përqendruara kryesisht në buxhetin e shtetit, gjendjen e financave publike, ekonominë, sigurinë e shtetit dhe qytetarëve, mbrojtjen shëndetësore, ekologjinë, arsimin, problemet sociale dhe aktivitete që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Polonisë në Bashkimin Evropian.

Standardet e auditimit të NIK

Standardet e auditimit të NIK-ut kanë lejuar ruajtjen e nivelit profesional të auditimeve të kryera. Ato ofrojnë një platformë për planifikimin, punën dhe vlerësimet e rezultateve të auditimit. Gjithashtu, ato pasqyrojnë arritjet e NIK-ut dhe janë modifikuar në bazë të zgjidhjeve metodologjike të auditimit.

Standardet e auditimit përbëhen nga 17 grupe çështjesh që mbulojnë fazat dhe procedurat më të rëndësishme të auditimit. Ato janë zhvilluar në bazë të ligjeve polake, standardeve të auditimit të INTOSAI-t, udhëzimeve evropiane zbatuese të INTOSAI-t, standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe përvojës së gjatë të NIK-ut. Standardet e auditimit të NIK-ut së bashku me udhëzimet metodologjike përbëjnë Manualin e auditimit.

Bashkëpunimet Ndërkombëtare

NIK është i përfshirë aktivisht në veprimtaritë në arenën ndërkombëtare duke bashkëpunuar me Institucionet e Larta të Auditimit në Evropë dhe në botë, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e auditimit të vendeve të tjera. Bashkëpunimi me SAI-t e tjerë, lejon që NIK të rrisë njohuritë e tij mbi praktikat më të mira të standardeve të auditimit dhe të përhapë përvojën e tij në arenën ndërkombëtare. Në këtë kuadër mund të përmendim edhe bashkëpunimin e NIK me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Më datën 23 maj, 2012 në Varshavë të Polonisë, z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e NIK, z. Jacek Jazierski.

Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Zyra e Auditimit Suprem e Polonisë do të shkëmbejnë eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese. Në fillim të korrikut 2012, një grup prej 10-15 audituesish nga KLSH morën pjesë në trajnimin për auditimin e performancës në Qendrën e Trajnimeve të NIK në Poloni.

NIK si anëtare e INTOSAI-t

INTOSAI ka 189 anëtarë auditimi nga e gjithë bota, duke përfshirë NIK-un (që nga viti 1959)..

INTOSAI publikon udhëzime ndërkombëtare dhe zhvillon metodologjinë e aktiviteteve të auditimit, si dhe ofron trajnime dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave midis anëtarëve të saj. NIK është përfshirë në mënyrë aktive në veprimtaritë e INTOSAI-t, po ashtu edhe përfaqësues të NIK-ut janë të pranishëm në strukturat e INTOSAI-t dhe marrin pjesë në nën-komitete, grupet e punës dhe kongrese.

NIK-u luan edhe rolin e audituesit të Organizatës Evropiane për Kërkimet Bërthamore.

Zyra e Lartë e Auditimit polak u caktua si auditues i jashtëm i Organizatës Evropiane për Kërkimet Bërthamore (CERN). NIK duhet ta kryejë këtë funksion nga viti 2013 deri në 2015.

Ky është një dallim i Zyrës së Lartë të Auditimit polak dhe gjithashtu hera e parë kur funksioni i audituesit të jashtëm i është dhënë një SAI "të ri" anëtar (që u bashkua me CERN pas vitit 1989).

CERN (Organizata Evropiane për Kërkime Bërthamore) u themeluar në vitin 1954. Selia e saj është vendosur në Gjenevë. Aktualisht, janë 20 vende organizatore . Buxheti i tij i tejkalon 1 miliard CHF. Afërsisht tre mijë ekspertë dhe teknologë punojnë në baza të rregullta, por numri i njerëzve që bashkëpunojnë me CERN arrin në 8 mijë.

Profili i Presidentit të NIK, Jacek Jezierski



(Jacek Jezierski)

Jacek Jezierski lindi më datë 11 Prill 1958, në Gdansk. Ai u diplomua në Fakultetin e Biologjisë dhe të Shkencave të Tokës, në Universitetin e Gdansk-ut. Në vitin 1988 Jezhierski mori pjesë një ekspeditë shkencore njëvjetore të qendrës kërkimore të Akademisë Polake të Shkencave (APSH) në Arqipelagun e ishujve Spitsbergen, në Arktik.

